REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË OPŠTINA VUČITRN
01 Nr./Br. 38/23
Nr. i fq./Br. st. -1-
Data/Datum 10.02.2023

**REPUBLIKA E KOSOVËS** **KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI**

---

Në bazë të nenit 43.1 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 28.1 të Statutit 01.Nr-209/22 të Komunës së Vushtrrisë dhe nenit 6.3 të Rregullores për Punën e Kuvendit të Komunës dhe Organeve të Tij, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë:

**Ju fton**

Të merrni pjesë në mbledhjen e Kuvendit të Komunës, e cila do të mbahet më datë **23 shkurt 2023 (e enjte) me fillim në ora 10:00.** Mbledhja do të mbahet në sallën e Kuvendit të Komunës në Vushtrri.

Për këtë mbledhje propozohet ky:

**R E N D D I T E**

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 31 janar 2023;
2. Shqyrtimi i Informatës për gjendjen e sigurisë në Komunën e Vushtrrisë për vitin 2022;
3. Shqyrtimi dhe aprovimi i Draft – Rregullores për Përcaktimin e Kritereve të Ndarjes së Mjeteve Financiare nga Fondi për Transfere dhe Subvencione Personave Juridikë – OJQ dhe Personave Fizikë dhe Bashkëfinancim;
4. Shqyrtimi dhe aprovimi i Draft – Rregullores për Ndarjen e Bursave për Nxënës/Studentë dhe Shpërblimeve për Nxënës/Studentë të Komunës së Vushtrrisë;
5. Shqyrtimi dhe aprovimi i Draft – Rregullores për Fillimin dhe Mbarimin e Orarit të Punës së Veprimtarive Afariste – Bizneseve në Komunën e Vushtrrisë;
6. Shqyrtimi i Raportit periodik për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit
7. Shqyrtimi i Informatës për shërbimet shëndetësore për vitin 2022 në Komunën e Vushtrrisë;
8. Shqyrtimi dhe aprovimi i Raportit vjetor të Komitetit për Komunitete për vitin 2022;
9. Shqyrtimi i Informatës për punën e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2022;
10. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për emërim të komisionit për përzgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve në Komunën e Vushtrrisë;
11. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim – vendimit për lirim nga pagesa e taksës për shfrytëzimin e hapësirave publike si dhe kiosqeve nga druri për më pak se një vit;
12. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim – vendimit për ndryshim dhe plotësim të vendimit lidhur me themelimin e Këshillit për Siguri në Bashkësi;
13. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim – vendimit për caktim të kahjeve të lëvizjes në disa rrugë të qytetit;
14. Të ndryshme.

**Melihate Basholli-Latifi**

---

**Kryesuese e Kuvendit të Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA VUSHTRRI
OPŠTINA VUČITRN

01 Nr./Br. 37/23
Nr. i fq./Br. st. -2-
Data/Datum: 10. 02. 2023

| | |
|---|---|
| **PËR:** | **Kuvendin e komunës** |
| **NGA:** | **Melihate Basholli Latifi**<br>**Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë** |
| **TEMA:** | **Rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa, nga mbledhja e datës 10.2.2023** |

Në mbështetje të nenit 52, paragrafit 2 të Ligjit nr.03/L-40 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 37, paragrafit 4 të Statutit të Komunës, Komiteti për Politikë dhe Financa në mbledhjen e mbajtur më **10 shkurt 2023** ka shqyrtuar këto materiale dhe nxori këto rekomandime:

1. Shqyrtimi i Draft – Rregullores për Përcaktimin e Kritereve të Ndarjes së Mjeteve Financiare nga Fondi për Transfere dhe Subvencione Personave Juridikë – OJQ dhe Personave Fizikë dhe Bashkëfinancim.
   *Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:*
   *Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*

2. Shqyrtimi i Draft – Rregullores për Ndarjen e Bursave për Nxënës/Studentë dhe Shpërblimeve për Nxënës/Studentë të Komunës së Vushtrrisë.
   *Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:*
   *Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*

3. Shqyrtimi i Draft – Rregullores për Fillimin dhe Mbarimin e Orarit të Punës së Veprimtarive Afariste – Bizneseve në Komunën e Vushtrrisë.
   *Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:*
   *Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*

4. Shqyrtimi i Raportit periodik për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit.
   *Për këtë pikë të rendit të ditës:*
   *Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*

5. Shqyrtimi i Informatës për shërbimet shëndetësore për vitin 2022 në Komunën e Vushtrrisë.
   *Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:*
   *Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*

6. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Komitetit për Komunitete për vitin 2022.
*Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:*
*Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*

7. Shqyrtimi i Informatës për punën e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2022.
*Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:*
*Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*

8. Shqyrtimi i Informatës për gjendjen e sigurisë në Komunën e Vushtrrisë për vitin 2022.
*Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:*
*Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*

9. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për emërim të komisionit për përzgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve në Komunën e Vushtrrisë.
*Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:*
*Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*

10. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për lirim nga pagesa e taksës për shfrytëzimin e hapësirave publike si dhe kiosqeve nga druri për më pak se një vit.
*Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:*
*Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*

11. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për ndryshim dhe plotësim të vendimit.
*Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:*
*Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*

12. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për caktim të kahjeve të lëvizjes në disa rrugë të qytetit.
*Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:*
*Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*

*Me respekt!*

**REPUBLIKA E KOSOVËS** **KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI**

# P R O C E S V E R B A L
# NGA MBLEDHJA E -I- E RREGULLT E KUVENDIT TË KOMUNËS SË VUSHTRRISË, MBAJTUR MË 31 JANAR 2023

*Mbledhja është mbajtur në sallën e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, duke filluar në orën* ***10:15.***
Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë:
Adnan Lahu, Agim Bregaj, Agron Përçuku, Alban Bajrami, Ali Januzi, Arlind Gogolli, Behar Duraku, Bekim Zabërgja, Blerina Shala, Bujar Pllana, Edona Gashi, Fakete Dushi, Fatmire Cecelia, Faton Hyseni, Galip Audiu, Gresa Muli, Gentiana Rama, Ilmi Azemi, Kushtrim Hyseni, Leonora Gërguri, Lorik Maxhuni, Mek Selaci, Melihate Basholli-Latifi, Mensur Kasumi, Mensur Kastrati, Mentor Hasani, Nasuf Aliu, Nurie Halili, Nurten Çerkezi-Gjyshinca, Refik Maloku, Shkelzen Xhaferi, Spasoje Stefanoviq, Sylejman Meholli, Ymer Haradinaj dhe Zojë Hajrizi.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Melihate Basholli-Latifi, – kryesuese e kuvendit, e cila konstatoi se në sallë janë prezent 35 anëtarë të kuvendit, kuorum ky i mjaftueshëm për zhvillimin e punimeve të mbledhjes plenare dhe për marrje të vendimeve të plotfuqishme, andaj procedoi me rendin e ditës.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe Kryetari i komunës, z. Ferit Idrizi, nënkryetari i komunës z. Shpëtim Zhegrova, përfaqësuesi i KFOR-it, përfaqësuesi i OSBE-së, përfaqësues të mediave të shkruara dhe elektronike, përfaqësues të shoqërisë civile.

**Faton Hyseni, anëtar i kuvendit-**fillimisht uroj për një fillim vit të mbarë, dhe shtoj se në rrethanat aktuale ku po ballafaqohemi me krizë të lartë financiare me inflacion dhe gjende të renduar sociale, vjen lajmi për ngritjen e normave tatimore nga Qeveria e Kosovës, kjo politikë është e papranueshme dhe në emër të asamblistëve të AAK-së në Kuvendin e Komunës së Vushtrrisë kërkojnë: që faturat e tatimit në pronë për vitin 2023 të jenë të njëjtat si në vitin e kaluar. Kërkoj që kjo kërkesë të mbështet unanimisht nga anëtaret e kuvendit. Më pas ai parashtroj temën se përse Sekretaria e Kuvendit nuk i përmbahet rregullores së punës për pajisjen e anëtarëve të kuvendit me kartela e identifikimit të anëtarëve të kuvendit, që duhet të pajisen më së largu 30 ditë pas marrjes së mandatit të tyre. Më tej pyeti se në dy seancat e fundit ka pasur lëshim të mbledhjes nga disa anëtarët e kuvendit dhe pagesa e mëditjes iu është bërë ndërsa kur ai kishte munguar mëditja i ishte ndalur, andaj kjo në çfarë baze është bërë. Po ashtu pyetje parashtroj edhe për kryetarin e komunës i cili vlerësoj se skenari për përurimin e pllakës përkujtimore për dëshmorët Sadri Mala e Sadik Maksuti ka qenë i organizuar në mënyrë tejet të dobët. Lidhur me këtë pyeti se këtë skenar a e ka përgatitur kryetari i komunës nëse ai e ka bërë kjo nuk është në rregull sepse në këto manifestime nuk është në rregull të flasin përfaqësues të partive politike me qëllim të politizimit të dëshmorëve. Ai vlerësoi dhe apeloj tek kryetari i komunës që të ketë kujdes në këso

lloj rastesh, sepse bashkësia lokale e Stanocit ka 4 asamblistë dhe ndarjet mes tyre nuk i shërbejnë askujt.

**Bekim Zabërgja, anëtar i kuvendit-**pasi i përshëndeti të pranishmit tha se siç jeni të informuar, po bëhet plot 1 vit në këtë kuvend që kur është ngritur çështja në lidhje me pretendimet se gjatë procesit të dhënies në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës së Vushrrrisë, përkatësisht vendosjen e bizneseve private në Parkun Industrial - Lumadh, ka pasur parregullsi si dhe shkelje esenciale të legjislacionit në fuqi. Po ashtu, siç jemi të njoftuar gjatë kësaj periudhe kohore në këtë kuvend në vazhdimësi nga disa anëtarë të kuvendit është ngritur ky shqetësim dhe falë senzibilizimit të kësaj çështje, Kuvendi i Komunës në datën 28.04.2022 me nr. të Protokollit 01-101/2022 ka marrë vendim për formimin e Komisionit për Verifikimin e Procesit të Dhënies në Shfrytëzim të Pronës Komunale në mënyrë që të vjen deri te një verdikt përfundimtar për konstatimin e gjendjes faktike. Pas verifikimit të gjithë procesit të dhënies së pronës së paluajtshme në shfrytëzim, përkatësisht në vendosjen e bizneseve në Parkun Industrial-Lumadh, Komisioni ka gjetur se gjatë këtij procesi Komisioni Vlerësues për Vendosjen e Bizneseve në Parkun Industrial-Lumadh ka vepruar në kundërshtim me Legjislacionin në fuqi, të janë të evidentuar në Raportin Përfundimtar të Komisionit, të datës 14.09.2022, me nr. të Protokollit 013-2018/2022. Të gjeturat e bazuara të raportit përfundimtar të Komisionit me rekomandime, i cili i është paraqitur Kuvendit në 13 faqe, mbështeten në mënyrë të plotë nga:

1. Opinioni i Agjencise Kundër Korrupsionit, në lidhje me trajtimin e konfliktit të interesit, i datës 25.03.2022, me nr. të referencës 06-02/1326/22.
2. Opinioni ligjor i zyrës ligjore të komunës së Vushtrrisë me nr. 71340/21 i datës 23.12.2021.
3. Opinioni Ligjor i udhëheqësit të zyrës ligjore të komunës së Vushtrrisë, nr. 21013/22, i datës 26.04.2022.
4. Interpretimi ligjor i MAPL-së

Andaj duke u bazuar në faktet e sipërpërmendura, e nderuara kryesuese e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, bazuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale nr. 03/L-040,
Nenin 47, paragrafi 47.2
Si dhe bazuar në Rregulloren e Kuvendit 7113 të datës 4 prill 2013,
Nenit 18, paragrafi 18.3 dhe Nenit 20, paragrafi 20.1.4,
Bazuar në Vendimin nr. 101/2022, të datës 28.04.2022 në cilësinë e anëtari të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë i propozoj:

1. Të shtohet pika shtesë e Rendit të Ditës Raporti Përfundimtar i Komisionit Kuvendar për Verifikimin e Procesit të Dhënies në Shfrytëzim të Pronës Komunale me Rekomandime, siç janë:
1. Shfuqizimi i vendimit të kuvendit komunal me numër 81/21 të datës 16.04.2021 për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës komunale në Parkun e Biznesit në Lumadh,
2. Anulimin dhe shfuqizimin e të gjitha kontratave dhe nënkontratave të lidhura në mes të komunës së Vushtrrisë dhe operatorëve ekonomikë në Parkun Industrial-Lumadh,
3. Shpalljen e konkursit publik për vendosjen e bizneseve në Parkun Industrial Lumadh, në periudhë sa më të shkurtër kohore.
4. Obligohet Kryetari i Komunës, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, si dhe drejtoritë tjera përkatëse, për zbatimin e këtij vendimi.

**Sylejman Meholli, anëtar i kuvendit-**shprehu shqetësimin e tij se ka disa muaj që mbledhjet e kuvendit, nuk po zhvillohen në frymën e ligjit, dhe atë duke marr për bazë që në mbledhjen e fundit të kuvendit, ishte kërkuar të hedhet në votim një propozim e që kjo ishte refuzuar në mënyrë abuzive nga kryesuesja e kuvendit. Më tej në mbledhjen e fundit të KPF-së është votuar një pikë e rendit të ditës që të procedohet për këtë seancë dhe ngjashëm kryesuesja e kuvendit duke

keqpërdorur pozitën zyrtare, ka mbivendosur vullnetin e saj duke e bllokuar këtë pikë të rendit të ditës, dhe kështu kjo pikë nuk është proceduar në material elektronik dhe atë fizik deri sot kur po mbahet kjo mbledhje. Kjo pikë është ardhur në kuvend vetëm pas ankesës në MAPL e cila ka konfirmuar se është vepruar në kundërshtim me ligjin. Më tej duke lexuar nenin 47 të LVL-së: anëtarët e kuvendit munde që gjatë seancës të propozojnë një pikë të rendit të ditës në qoftë se ajo është në interes publik. Pra bazuar në dispozitat e ligjit kryesuesja e kuvend nuk ka pasur asnjë të drejt juridike që të refuzoj hedhjen në votim të propozimit që është bërë në mbledhjen e kaluar për shkarkimin e kryesueses. Andaj pyeti zyrën ligjore se në qoftë se një çështje rregullohet nga dy dokumente juridike dhe ka interpretim të ndryshme epërsia i takon ligjit, sepse ligjit në hierarki i mbizotëron udhëzimet, statutin dhe rregulloret. Në rastin konkret është vepruar në kundërshtim me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale. Situata afërsisht është e njëjte edhe në rastin e rekomandimin e KPF-së në lidhje me raportin e Drejtorisë së Urbanizimit. Andaj mbivendosja e vullnetit të kryesueses së kuvendit mbi anëtarët e KPF-së është shkelje flagrante e ligjit dhe keqpërdorim i detyrës zyrtare nga kryesuesja e kuvendit.
**Melihate Basholli-Latifi, Kryesuese e Kuvendit-**tha se është e vërtet se në mbledhjen e KPF-së është votuar një rekomandim për Drejtorinë e Urbanizmit, dhe sqaroj se është e vërtet që anëtarët e kuvendit i janë drejtuar MAPL-së por edhe Policisë së Kosovës, për të marr përgjigje në këtë çështje dhe MAPL ka dhënë përgjigjen në mënyrë shumë të qartë, ku thuhet se rendin e ditës e përgatitë kryesuesja e kuvendit në bashkëpunim me kryetarin e komunës, duke i marr për bazë edhe rekomandimet e KPF-së. Kjo çështje është e pastër si loti pa ngjyrime politike, sepse pas mbledhjes së KPF-së zyrtarisht i është drejtuar Drejtorisë së Urbanizmit dhe Drejtorisë së Shëndetësisë për t’i kërkuar pikat që janë rekomanduar nga KPF-ja, por materialin nga Drejtoria e Urbanizimit nuk e kishte pranuar andaj rrjedhimisht një çështje e tillë nuk ishte hi në rend dite. Drejtoresha e Urbanizimit nuk kishte pasur mundësi që ta përgatisë një material të tillë dhe si kryesuese e kuvendit kishte pritur ditën e fundit të afatit ligjor për ta përfshirë këtë pikë në rendin e ditës. Raporti nga DUMM-ja ka ardhur sot në Sekretarinë e Kuvendi dhe i njëjti është proceduar. Sa i përket pikës nga seanca e kaluar për shkarkimin e kryesueses së kuvendit ajo ka respektuar statutin e komunës dhe qëndron prapa këtij qëndrimi edhe sot. Kërkoj nga të gjithë të punojnë në frymën e ligjit dhe të bashkëpunimit pa dallime politike e partiake.
**Ismet Gashi, Udhëheqës i Zyrës Ligjore-**sqaroi se kur flitet për hierarkinë e akteve juridike, atëherë është shumë e vërtet se ligji ka epërsi në krahasim me aktet nënligjore, por duhet ditur dhe pasur për bazë se statuti i komunës ka marr konfirmimin e ligjshmërisë nga MAPL i njëjti është në fuqi dhe kemi detyrime ti përmbahemi, dhe nëse dikush ka ankesa për mos marrje të vendimit atëherë mund t’i drejtohet MAPL-së, edhe pse kjo e fundit ka aprovuar një statut që në disa aspekte bie në kundërshtim me ligjin.
**Adnan Lahu, anëtar i kuvendit-**pasi i përshëndeti të pranishmit deklaroi: të gjithë ne gjatë fushatës zgjedhore e kemi dëgjuar Kryetarin Idrizi duke thënë se vjen nga fusha e Arsimit dhe se prioritet kryesor gjatë mandatit të tij do ta ketë pikërisht Arsimin. Sot pas një viti të kësaj qeverisje mund të themi se më të vërtet Kryetari e paska qëllim Arsimin, mirëpo qëllimi dhe prioriteti paskan qenë shkatërrimi dhe degradimi i Arsimit në komunën tonë. Për më shumë se tre muaj shumë nxënës të komunës sonë kanë mbet pa profesor të Kimisë, arsyet për këtë i di kryetari. Çdo konkurs i shpallur në drejtori të arsimit është anuluar pas ankesave të shumta ku nuk u respektuan procedurat e rekrutimit për këto konkurse. Pikërisht për këto arsye komuna jonë tash e dy muaj është pa drejtor të Arsimit, edhe më keq që askush nuk po pranon ta marr këtë pozitë për shkak të presionit nga kjo qeverisje.

Edhe pse nuk e kishte prioritet Shëndetësinë, gjendje më e mirë nuk është as në sektorin e shëndetësisë. Nga më shumë se 18 analiza të cilat duhet të kryhen në komunën tonë, fatkeqësisht janë duke u kryer vetëm dy prej tyre. Rëntgenin në komunën tonë është jashtë funksioni, Qendrën Kryesore të Mjekësisë familjare e kemi lënë pothuajse të gatshme, dhe edhe sot, pas një viti kryetari nuk po arrin ta funksionalizoj. Kryetari po krenohet me largimin e kabllove nga sheshi i Vushtrrisë. Më të vërtet largimi i kabllove është një punë e mirë, por këtë kontratë për largimin e kabllove Kryetari Idrizi e gjeti të nënshkruar nga Qeverisja e LDK-së dhe s'ka asgjë të keqe, sepse punët duhet të vazhdojnë pavarësisht ndërrimit të qeverisjeve komunale. Por pyetja ime dhe e gjithë qytetarëve të Vushtrrisë është se pse nuk u larguan këto kabllo nga sheshi kur për këtë komuna jonë kishte kontratë mbi 1.5 milion euro të nënshkruar në kohën kur PDK ishte në qeverisje. Gjithashtu Kryetari po krenohet me ndërtimin e një mini tregu për prodhuesit vendor, ku ne të gjithë e kujtojmë që për këtë treg u ndërruan disa lokacione për ta vendosur atë përfundimisht në stadiumin e qytetit. Krejt këto lëvizje të lokacionit u bënë me pretekstin e Kryetarit se aty ku ishte i paraparë tregu nga qeverisja e kaluar nuk bënë të ndërtohet sepse prona nuk ishte e komunës por e AKP-së. Edhe këtu kryetari bie në kundërshtim me vetveten, sepse ne po e shohim se shtëpia për të moshuar është duke u ndërtuar pikërisht në një pronë tjetër të AKP-së. Ne e dimë që komuna jonë ka probleme të shumta, ka edhe përfaqësuesit e saj ligjor të cilët e mbrojnë komunën, por edhe këtu kryetari Idrizi zgjodhi që të angazhoj Ekspert të jashtëm për përfaqësim të komunës, ku çuditërisht ky ekspert del të jetë ish sekretari i PDK-së dega në Vushtrri. Çudia nuk përfundon këtu, për një vit angazhim ky Ekspert i zgjedhur në mënyrë të dyshimtë përmes procedurës së negocimit nga zyra e prokurimit i ka kushtuar komunës së Vushtrrisë mbi 18.000 Euro, dhe a e dini se sa raste i kemi të fituara ne si komunë në këto përfaqësime, Zero raste. Për një vit qeverisje, kuvendi komunal fatkeqësisht ka shumë vendime të kthyera si të kundërligjshme nga ana e MAPL-së, të njëjta me këto dy vendime të cilat i kemi edhe sot para vetës për ti anuluar për shkak se janë marr në kundërshtim me ligjin. Të gjitha këto situata po krijohen për shkak të ndërhyrjeve të vazhdueshme që po ju bëhen kryesueses së kuvendit komunal për procedim të vendimeve në kundërshtim me ligjin. Të dashur qytetarë kjo ishte vetëm një rezyme e shkurtër e punës një vjeçare të Kryetarit Idrizi.

**Ferit Idrizi, kryetar i komunës-**tha se shumë shpejt të bëhet emërimi i Drejtorit të DKA-së, pas dorëheqjes së drejtoreshës, dhe shtoj se janë munduar të mbulojnë zbrazsirat me zyrtarët të punojnë në DKA. Lidhur me humbjet e orëve për mësimdhënësin e lëndës së kimisë pajtohet se nuk është në rregull të humben orët si rezultat i mos rekrutimit të këtij mësimdhënësi, por këtu duhet pasur për bazë se rekrutimi i një mësimdhënësi përmes procedurave të rregullta nevojiten afër dy muaj ditë. Lidhur me konkurset shprehu se ai nuk është duke lejuar të bëhen shkelje ligjore dhe ceku se disa individ në LDK në mandatin e kaluar kishin pranuar në mënyrë të kundërligjshme 154 punonjës me kontratë mbi vepër. Më tej njoftoi se komisioni për pranimin e punëtorëve në shkolla është tërësisht i pandikuar dhe kanë anuluar konkursin pasi kanë vërejtur se ka parregullsi, sepse nuk janë thirrur në udhëzimin administrativ që është në fuqi. Vendoja e lokacionit të tregut është bërë në kuvend në bashkëpunim me qeverinë komunale, dhe potencoi se ai është njëri që i'u njeh meritat të tjerëve dhe fare nuk e ka problem, p.sh themelimi i NPL Përparimi është një e arritur dhe këtu ia njeh meriten ish kryetarit të komunës z.Xhafer Tahiri. Por vendosja e shtëpisë së pleqëve në pronën e AKP-së, nga ish-pushteti është në kundërshtim me ligjin dhe ka sjell shumë probleme për qeverinë aktuale. Lidhur me çështjen e ekspertit juridik të kontraktuar nga ana e komunës, njoftoj se ky avokat ka fituar një kontest të një fature të fshehur nga qeveria dhe kryetari i kaluar në vlerë financiare prej 45,000.00 € për objektin-skelet të depos së patates në fashitin Nadakoc projekt i cili kurrë nuk ka përfunduar. Kabllot e sheshit "Adem Jashari" janë hequr në

mënyrë shumë të mirë dhe këtë e ka ndihmuar edhe Ambasada Turke në Kosovë, e veçanta e kësaj pune të mirë është se kabllot janë hequr me parat e operatorëve ekonomik, kjo ka qenë premtim qysh në vitin 2017 dhe deri tani nuk u realizua. Sa i përket cilësisë në arsim tha se janë organizuar garat, dhe janë shpërblyer nxënësit dhe mësimdhënësit dhe në këtë formë do të vazhdohet edhe në të ardhmen për ta rritur cilësinë në arsim. Lidhur me organizmin e skenarit për dëshmoret Sadri Mala e Sadik Maksuti tha se ka qenë një lëshim dhe ai është vu në lajthitej por u zotua se një gjë e tillë më nuk do të përsëritet

**Adnan Lahu, anëtar i kuvendit-**tha se kjo qeveri po krenohet me projektet nga qeveria e Xhafer Tahirit, por kjo qeveri duhet të tregoj se çfarë është duke bërë për qytetaret asgjë, nëse ka pasur keqpërdorime atëherë ato le të dërgohen në institucionet e drejtësisë dhe le ta merr përgjegjësin çdo kush çfarë ka vepruar.

**Ferit Idrizi, kryetar i komunës-**tha se nuk dëshiron të merret me qeverinë e kaluar dhe se as në paraqitjet e tij publike nuk e ka përmendur askënd, por lëshime dhe keqpërdorime në qeverinë e kaluar ka pasur mjaft shumë dhe një ndër to është zona ekonomike në Lumadh ku prona është dhënë në shfrytëzim me drejt të shitjes gjë e cila është në kundërshtim të plotë me ligjet në Republikën e Kosovës, dhe këto është konsumuar vepra penale keqpërdorim i detyrës zyrtare.

**Nexhmendin Rashica, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë-**sqaroi se Qendra e re e Mjekësisë Familjare tani i është bërë pranimi teknik, por në bodrum ka ujë dhe dy katet pikojnë, kështu që aparatura e nxemjes është në bodrum dhe rrezikohen mira euro për shkak të ndërtimit jo sipas standardeve. Sa i përket rëntgenit prej se ka marrë detyrën si drejtor vetëm një javë nuk ka punuar rëntgeni, për faktin se ka pasur defekt ku është djegur një pjesë dhe në atë kohë nuk ka pasur kompani kontraktuese për sërvisim sepse kontrata ka përfunduar në vitin 2021. Po ashtu analizat janë duke u bërë në formë të rregullt gjithësejt 21 analiza.

**Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit-**deklaroi se kemi një situatë shumë të rënd lidhur me zbatimin e obligimeve ligjore në përgjithësi në komunë dhe në Drejtorin e Urbanizmit në veçanti aty ku mbizotëron një anarki e paparë deri me tani në historinë e Komunës së Vushtrrisë. Anarkia nënkupton gjendjen e çrregullt, kur nuk ka organizim a nuk veprojnë e aplikohen ligjet; pështjellim e rrëmujë, ngaqë mungon udhëheqja, drejtimi e organizimi. Secili që ka nevoja dhe drejton një kërkesë, projekt apo çfarëdo qoftë në arkivin e komunës rrugëtimi për të arritur deri te drejtoria zgjatë a e dini sa të nderuar deputet e qytetar të Vushtrrisë, zgjat aq ditë sa drejtoresha e nderuar znj. Fortuna nuk është në vendin e punës apo nuk e ka disponimin me pranu lëndën ky është një standard i ri i vendosur nga drejtoresha me siguri e mbështetur nga kryetari e nënkryetari arsyet po besoj po kuptohen. Korrupsioni, konflikti i interesit, fshehja e lëndëve, mbajtja në kohë të gjatë e lëndve nga vete drejtoresha qëllimisht, keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar, mbajtja e evidencës pa emërtim të plotë por vetë me iniciale në libra protokolli, mos respektimi i orarit të punës, mungesa me ditë të tëra në punë kinse jam e sëmur, kemi ditëlindje, dasma, kanaxheqe e shumë justifikime tjera, dallimet në shqyrtimin e projekteve me kushte të barabarta – në kundërshtim me ligjin për parimin e barazisë dhe mos diskriminimit, shantazhi me i krye projektet investive te ose përmes drejtoreshës janë karakteristika që e kanë determinu këtë drejtori si kancer të investimeve sidomos në industrinë ndërtimore. Kryesuese çka do të veproni ju në këtë rast kur do keni në dijeni saktë konfliktin e drejtpërdrejtë të interesit të drejtoreshës z. Fortuna e cila së paku në dy raste ka leshu e nënshkrua kushte ndërtimore dhe leje ndërtimore duke e ditur se trajtimi i këtyre lëndëve dhe nënshkrimi i tyre nga ana e saj, përbën shkelje ligjore dhe paraqet konflikt të drejtpërdrejt interesi.

Kryetar dhe nënkryetar ju si do të veproni në këtë rast a do e përgatitni shkresën dhe mej than kryesueses dërgo në Agjencinë Kundër Korrupsion, ministri, krime, prokurori si në rastin e Parkut

Industrial Lummadh kur na keni dërgua mu dhe ish deputetin z. Fitim Halili madje i keni dërgua edhe 22 biznese vetëm mbi bazën e apetiteve personale dhe pa pasur fakte kurse ky rast është i faktun dhe me rastin e pengesës së investimit në Parkun Industrial. Ju keni varfnu dhe stagnu zhvillimin ekonomik, keni pengu investimin me te madh në historinë e Vushtrrisë 23 milion investime kryetar, minimum 1000 vende të reja të punë. Kryetar, nënkryetar e ju drejtoresh e nderuar a mundeni me na tregu pse dhe qysh është e mundur që aplikimet për kushte ndërtimore dhe leje ndërtimore trajtohen sipas stilit fontan dëshirash kur ligji ka përcaktuar qartë e saktë afatet kohore për aprovimin apo refuzimin e kërkesave po edhe mënyrën e afatin e plotësimit eventual të lëndës. Si është e mundur që dikush fillon ndërtimin e objektit afaristë-banesor pa u pajis bile as me kushte ndërtimore dhe aplikon gjatë ndërtimit diku kur veç ka përfundua katin e 3 apo 4 dhe me automatizëm pajiset me kushte dhe leje ndërtimore kurse të tjerët presin 9 e 12 muaj në procedura dhe nuk munden ta gëzojnë një të drejt ligjore që ju takon pa e godit cakun e gjetë vendin ku duhet me shkua mu kryqëzua, kjo është e pafalshme. Mos pajisja me kushte ndërtimore dhe leje ndërtimore përkundër faktit se investitorët kanë aplikuar dhe plotësojnë kriteret për tu pajisur me leje ndërtimore ka pengu zhvillimin ekonomik dhe ka varfnu qytetin sipas para llogarisë së paku 25 milion euro dhe ka lan pa punë shumë të punësuar dhe rrjetin furnizues e ka dëmtuar së tepërmi. Legalizimet e objekteve i cili po vazhdon edhe në vitin 2023 është duke u krye në komunën tonë me shumë shkelje ligjore, shkelje këto që përveç tjerash kanë rezultuar edhe me dëmtimi të buxhetit të komunës për vlerën më se 200.000.00 Euro. Drejtoresha me veprimet e veta të kundërligjshme dhe me vetëdije ka trajtua dhe vazhdon të trajtoj lëndë të cilat nuk janë dhe nuk mund të jenë pjesë e trajtimit ligjor pasi që kemi të bëjmë me ndërtime pas periudhës që ka parapa ligji me këtë rast duke e ditur ka kalkulu fitime për vete duke dëmtuar buxhetin komunal sepse neni 14 pika 3.4 e Ligjit nr. 06/L-024 për trajtimin e ndërtimeve pa leje regjistron pa kosto shtesë në kadastër me një shënim se është legalizuar objekti sipas këtij ligji kurse neni 20 i këtij ligji paraqet pagesat për kategorinë e parë dhe të dytë dhe çmimet janë 1 euro për m2 kategoria e parë dhe 2 euro për m2 kategoria e dytë dëmtimi i buxhetit këtu rezulton të jetë në diferencën e çmimit për kategorinë e dyte e që aktualisht është 5.60 euro për m2 për leje ndërtimore kurse 2 euro legalizimi diferenca 3.60 euro për m2 është dëmtim i buxhetit real dhe faktik. Sipas njoftimeve që kam janë trajtua në formën e kundërligjshme më se 27 objekte afariste-banesore por unë kam nxjerr koeficientin e dëmtimit të buxhetit komunal dhe sipas metodologjisë krahasimore del se minimum buxheti komunal është dëmtua 200.000,00 Euro në inkasim të të hyrave por sipas metodës kërkime dinamike në proces del se dëmtimi i buxhetit është më se 300.000,00 Euro. Si konkluzion i kësaj që e potencova qyteti i Vushtrrisë vetëm për një vit është varfërua për së paku 50 milion euro investime, a është mirë a keq mendoni vetë e nëse mendoni qe është e arritur postoje në fb se po mendoni se fb i kryen punët dhe mirë vazhdoni. Përveç shkeljeve të cekura dhe dëmtimit të buxhetit komuna jonë asnjëherë dhe në asnjë rast nuk ka respektuar nenin 10 të Udhëzimit Administrativ i Ministrisë të Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor nr.06/2019.( Procedura e aplikimit për leje të legalizimit për përfundim të ndërtimit).
Ligji për trajtimin e ndërtimeve pa leje i vazhduar edhe për një vit deri me dt.04 shtator 2022, ka paraparë dhe është i aplikueshëm për të gjitha ndërtimet pa leje që janë ndërtuar ose kanë filluar të ndërtohen deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji që i bie që ky afat ka pushu së vlejturi bashkë me të edhe Ligji për trajtimin e ndërtimeve pa leje. Krejt në fund kërkoj nga kryetari i komunë që menjëherë të obligoj auditorët e brendshëm për të konstatuar dëmtimin e buxhetit dhe njëkohësisht të ndërmerr veprime ligjore duke njoftua rastin në prokurori të shtetit.
**Furtuna Krasniqi, drejtoreshë e DUMM-së-**paraqiti sqarime të përgjithshme lidhur me raportin e prezantuar nga DUMM-ja e po ashtu i’ u përgjigj edhe pyetjeve dhe akuzave të bëra nga

parafolësi i saj. Ajo deklaroi se të gjitha kërkesat janë shqyrtuar sipas ligjit dhe ftoj që bëhet auditim Drejtorisë së Urbanizimit për shkeljet e pretenduara nga Ilmi Azemi anëtarë i kuvendit.

**Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit-**pyeti drejtoreshën e DUMM-së se si e arsyeton shantazhin që është duke i'u bërë investitorëve, për faktin se duhet të shkohet tek Drejtoresha e Urbanizimit për ta bërë projektin në zyrën saj, dhe atyre iu trajtohet lënda me prioritet dhe shpejt pajisen me leje ndërtimore. Më tej shtoi se janë të paktën dy raste kur drejtoresha iu ka bërë projektin investorëve dhe më pas edhe iu ka lëshuar lejen ndërtimore duke keqpërdorur pozitën zyrtare. Kjo është shantazh dhe nuk ka të drejt drejtoresha të veproj në kësi forme

**Zojë Hajrizi, anëtare e kuvendit-**në emër të grupi kuvendar të PDK-së kërkoj të futet në rend të ditës propozimi për pezullimin e vendimit të Ministrisë së Financave Punës dhe Transfereve, për rivlerësimin e pronës rezidenciale, ashtu që tarifat e tatimit në pronë, faturimi të mbetet ashtu siç ka qenë në vitin 2022. Këtë e arsyetoj me faktin e gjendjes së rënd ekonomike që po mbretëron në vendin tonë, dhe kësisoj kërkoj nga të gjithë anëtarët e kuvendit pa dallim partie të mbështesin këtë propozim. Propozimi ka të bëj me pezullimin e vendimit të ministrisë, sepse dihet fakti se falja e tatimit në pronën e paluajtshme për qytetaret shkon përtej kompetencave të komunës. Për të vendos ndryshe duhet të bëhen ndryshimet e nevojshme ligjore.

**Leonora Gërguri, anëtare e kuvendit-**kërkoj nga kryesuesja e kuvendit të ketë një informatë se sa është numri i vendimeve që janë kontestuar nga MAPL-ja.

**Sylejman Meholli, anëtar i kuvendit-**në emër të grupit kuvendar të LVV-së, duke u bazuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, propozoj të futet në rendin e ditës pika me emërtimin rekomandim-deklaratë për Ministrinë e Financave Punës dhe Trasferve, për faljen e tatimit në pronë deri në 100 euro për të gjithë tatimpaguesit e Komunës së Vushtrrisë për vitin 2023. Si komunë dhe si kuvend nuk kemi mundësi të ndryshojmë gjendjen, por mund të nxjerrim një deklaratë dhe ftoj të përkrahet nga të gjitha subjektet politike.

**Shpëtim Zhegrova, nënkryetar i komunës-**kërkoj që në emër të kuvendit të nxjerrët një deklaratë nga të gjitha grupet kuvendare lidhur me tarifat e tatimit në pronë e paluajtshme, e cila do ti adresohet Ministrisë së Financave. Këto propozime të fuzionohen në një pikë të rendit të ditës.

**Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit-**pyeti kryesuesin e kuvendit se përse nuk po respektohet plani i punës së kuvendit sa i përket pikave që duhet të shqyrtohen sepse në muajin janar është dashur të shqyrtohet raporti i punës i Komitetit për Komunitete. Më tej shtoi se ka gati dy muaj që DKA është pa drejtor, dhe pyeti se cila është arsyeja e shkarkimit apo dorëheqjes së drejtoreshës, mosbashkëpunimi, mungesa e performancës, apo shkelje e ligjit. Në këtë kontekst pyeti se cila është përvoja e ushtruesit të detyrës së Drejtorit të DKA-së z. Isuf Jashari, dhe cilat janë rezultate e tij në udhëheqjen e këtaj drejtorie për gjatë kësaj periudhe. Pastaj cilët janë hapat që ka ndërmarr kryetari i komunës për arsimin pasi ka qenë prioritet i tij gjatë fushatës zgjedhore, dhe a ka ndërmarr ndonjë veprim për realizimin e të drejtave që burojnë nga kontrata kolektive për punëtoret arsimor. Punëtorët arsimor janë të detyruar të kërkojnë të drejtat e tyre përmes padive gjyqësore dhe kësisoj po shkaktojnë edhe shpenzime për veten dhe për komunën. Për me keq komuna ka emërua drejtor të një shkolle kryetarin e sindikatës z.Visar Sadriun, dhe kjo do të thotë se e ka mbyllur zërin e sindikalistëve arsimor, e po ashtu ky drejtor ka konflikt interesi sepse ose duhet të jetë drejtor shkolle ose kryetar i sindikatës. Në fund tha se gjendja në arsim nuk është mirë dhe këtë e tregon edhe raporti i performancës, por ka pak shpresë që kjo gjendje të ndryshoj, sepse shumë shkolla janë ballafaquar me mungesë të aparateve fotokopjuese dhe mungesë të letrës.

**Faton Hyseni, anëtar i kuvendit-**tha se nisma për faljen e tatimit në pronë është antiligjore, sepse vetëm Qeveria e Kosovës ka të drejtë të falë borxhet, por kjo nuk ka ndodhur rastësisht sepse LVV-

ja ka pësuar një debakël në zgjedhjet e fundit lokale duke udhëhequr vetëm 4 komuna, dhe kësisoj do të dëmtohen vetëm komunat. Ai kërkoj të dilet me një rekomandim të përbashkët.
**Refik Maloku, anëtar i kuvendit-**tha se është shqetësues diskutimit i kryetarit të komunës, në ballafaqim me anëtarin e kuvendit z.Adnan Lahun, i cili i drejtohet se nëse me tërheq nga gjuha ti qes krejt, kjo i bie se kryetari i komunës ka shumë informacione për shkelje që kanë ndodhur në mandatin e kaluar por ato i ruan për momente të caktuara. Mandej anulimi i konkurseve është bërë vetëm pas reagimit të bërë nga LVV-ja. Mandej shtoj se fushën e arsimit e kanë karakterizuar shumë shkelje për gjatë vitit të kaluar, ka drejtor shkolle që marrin vulat e shkollës në kafe dhe tallen me institucionin.
**Ferit Idrizi, kryetar i komunës-**tha se opozita ka rol për të kritikuar, por duhet të ketë për bazë, duhet njehen edhe meritat, p.sh pastrimi i lumenjve ka rezultuar me shmangen e pasojave nga vërshimet dhe kjo duhet të njihet si meritë e kësaj qeverie. Duhet të ketë adresim të parregullsive në organet e drejtësisë, por jo për çështje banale siç ishte ajo për një pikë të rendit të ditës. Më tej shtoj se do ti drejtohet me shkresë zyrtare për të kërkuar ndryshimin e ligjit që të kemi fleksibilitet në zhvillimin e politikave të arsimit. Ai potencoi se ende nuk po mundet me nënshkruar kontratën për marrjen në menaxhim të rrjetit të ujësjellësit, sepse nga qeveria e kaluar janë vendosur ortë matëse me 5 barë ndërsa është dashur të jenë me 10 barë e si rezultat i kësaj po kemi shpërthim të gypave.
**Kushtrim Hyseni, anëtar i kuvendit-**propozoi të futet në rendin e ditës kërkesa e zjarrfikëseve të Komunës së Vushtrrisë për pagesën e shujtës, ku kostoja vjetore e këtij vendimi është 20,000.00€.
**Sylejman Meholli, anëtar i kuvendit-**pyeti se përse nuk është futur në rendin e ditës kërkesa e një grupi të asamblistëve për mocionin e shkarkimit të kryesuese së kuvendit edhe pse kjo kërkesë ishte proceduar sipas afatit, kërkoj që kjo pikë të futet në rendin e ditës.
**Faton Hyseni, anëtar i kuvendit-**tha se për ta proceduar në rend të ditës kërkesën për shkarkimin e kryesueses së kuvendit, nevojiten shumica e anëtarëve të zgjedhur të votojnë për këtë kërkesë dhe më tej shkohet në votim të fshehët, sipas nenit 26 të statutit të komunës.
**Adnan Lahu, anëtar i kuvendit-**tha se pika e rendin të ditës shkarkimi i kryesueses së kuvendit, është kërkuar edhe në mbledhjen e kaluar dhe ishte refuzuar, tani ajo është proceduar dhe e njëjta duhet të votohet për rend dite me votim të thjesht.
**Sylejman Meholli, anëtar i kuvendit-**tha se nëse nuk ka koherencë mes ligjit dhe statutit atëherë epërsi ka ligji dhe kjo është rregull juridik. Në mbledhjen e kaluar ka pasur shkelje ligjore kur u refuzua të qitet në votim propozimi për shkarkimin e kryesueses së kuvendit. Lidhe me këtë ata do ti adresohen MAPL-së. Kërkoj të del në votim për futej në rendin e ditës kërkesa për shkarkimin e kryesues së kuvendit.
**Bekim Zabërgja, anëtar i kuvendit-**tha se bazuar në statutin e Komunës së Vushtrrisë , kërkesa për procedimin për shkarkimin e kryesueses së kuvendit bëhet dhjetë ditë para mbajtjes së mbledhjes së kuvendit, andaj sot kjo pikë duhet të votohet dhe nëse i merr vota e duhura aprovohet në rend dite.
**Shpëtim Zhegrova, nënkryetar i komunës-**duke ju referuar nenit 47 paragrafi 4 i Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, ku thuhet se sa i përket rendit të ditës ceket se rregullorja e punës e në rastin konkret statutit i komunës si akt më i lartë parash dispozita tjera për hartimin e rendit të ditës. Në rastin konkret janë paraparë me statut rregullimi i çështjes së shkarkimit të kryesueses së kuvendit ku nevojit shumica e anëtarëve të zgjedhur të kuvendit d.m.th *18 vota për.*
**Alban Bajrami, anëtar i kuvendit-**tha se kjo situatë politike e krijuar nga të dy palët si nga qeveria ashtu edhe nga opozita ngre shumë pyetje se sa përgjigje, se cila është alternativa tjetër,

andaj si grup prej 3 asamblistëve Agron Përçuk, Behar Duraku dhe Alban Bajrmai nuk do të marrin fare pjesë në votimi për shkarkimin e kryesueses së kuvendit.

Në vazhdim, kuvendi pas votimit me 13 vota “për”, 17 vota “kundër” të tjerët nuk morën pjesë në votim, nuk e aprovoj për rend të ditës kërkesën për shkarkimin e kryesueses së kuvendit.

Pas votimit kuvendit me 29 vota “për” aprovoj për futej në rendin e ditës propozim-vendimin për shfuqizimin e vendimit me nr. 265/22 i datës 27.10.2022.

Pas votimit kuvendit me 31 vota “për” aprovoj për futej në rendin e ditës propozim-vendimin për shfuqizimin e vendimit me nr. 294/22 i datës 24.11.2022.

Pas votimit kuvendit me 24 vota “për” aprovoj për futej në rendin e ditës Raportin e punës të Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit.

Pas votimit kuvendit me 24 vota “për” aprovoj për futej në rendin e ditës propozim-vendimin për shfuqizimin e vendimit të kuvendit të komunës me numër të protokollit 81/21 datës 16.04.2021, për dhënien e pronës në shfrytëzim në Parkun Industrial në Lumadh;

**Ismet Gashi, udhëheqës i Zyrës Ligjore-**sqaroi se futja në rendin e ditës të propozimit për rishqyrtimin e vendimit me numër të protokollit 81/21 datës 16.04.2021, për dhënien e pronës në shfrytëzim në Parkun Industrial në Lumadh, duhet të bëhet sipas instruksioneve të dhënia nga Agjencia Kundër Korrupsionit, që ka rekomanduar të rishqyrtohet, për rastin e konflikti të interesit. Ndërsa ata që kanë konflikt interesi në këtë pikë duhet të deklarohen dhe të mos jenë pjesë e votimit për këtë çështje.
**Shpëtim Zhegrova, nënkryetar i komunës-**tha se kjo çështje është e ndjeshme dhe normalisht që duhet të shqyrtohet me kujdes. Në rastin konkret rishqyrtimi duhet të bëhet sipas rekomandimit të Agjencisë Kundër Korrupsionit, në votim do të jetë propozimi i ish-komisionit dhe nëse propozimi i tyre kalon atëherë mbete në fuqi por nëse nuk ka kalon ky vendim kthehet në pikën zero.
**Adnan Lahu, anëtar i kuvendit-**tha se Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, ka kërkuar që të bëhet rishqyrtimit i vendimit me numër të protokollit 81/21 datës 16.04.2021, për dhënien e pronës në shfrytëzim në Parkun Industrial në Lumadh, ndërsa mbetet në vullnetin e anëtarëve të kuvendit se si do të votojnë.
**Faton Hyseni, anëtar i kuvendit-**sqaroi sipas fjalorit shqip-shqip kuptimin e termit revokoj, i cili dha edhe përkufizimin, që revokimi nënkupton edhe shfuqizimin.
**Shpëtim Zhegrova, nënkryetar i komunës-**tha se pasi që u votua kjo pikë e rendit të ditës si shfuqizim, atëherë le të mbetet kështu, sepse gjatë shqyrtimit dhe nxjerrjes së një përfundim brenda konteksti ajo pikë mund të pësoj ndryshimet të cila shfaqen si të nevojshme
**Ferit Idrizi, kryetar i komunës-**pyeti juristet si cilat veprim ligjore vinë në radhë pas rishqyrtimit të një çështje. Dhe shtoj se rishqyrtimi është faza e parë që vlerësojmë se a ka pasur shkelje apo jo edhe pse nuk paragjykon domozdoshmërishtë shkelje ligjore. Nëse konstatohet se ka pasur shkelje atëherë veprim i radhës i anëtarëve të kuvendit është shfuqizimi i asaj pike, apo vendimi.
**Bekim Zabërgja, anëtar i kuvendit-**tha se opinoni i dhënë nga Agjencia Kundër Korrupsionit, kërkon nga kuvendi i komunës, rishqyrtimi, revokimin apo shfuqizimin e me numër të protokollit

81/21 datës 16.04.2021, për dhënien e pronës në shfrytëzim në Parkun Industrial në Lumadh. Andaj në këtë rast duhet të veprohet me pikën e rendit të ditës për shfuqizimin e këtij vendimi.
**Sylejman Meholli, anëtar i kuvendit-**tha se para disa seancave, kjo pikë e rendit të ditës ishte shqyrtuar, dhe ishte marr edhe një vendimi, ku lënda do të dërgohet në organet e drejtësisë, dhe kjo ka qenë obligim i kryesueses së kuvendit, por ai nuk beson se janë ndërmarr veprimet e duhura nga kryesuesja e kuvende sepse nuk kemi asnjë veprim apo njoftim zyrtarë, lidhur me këtë çështje. Mandej dy vendim për lapidarin në fshatin Pasomë janë marr në formë të kundërligjshme, dhe kjo si rezultat i udhëheqjes së dobët nga kryesuesja e kuvendit, dhe tani atij i vjen keq që deputet me voton e tyre mbrojnë diçka që është e padrejtë.
**Melihate Basholli-Latifi, Kryesuese e Kuvendit-**sqaroi se ashtu siç edhe është vendosur në kuvend për çështje që është objekt shqyrtimi ashtu edhe lënda është deleguar në organet e drejtësisë.
**Ismet Gashi, udhëheqës i Zyrës Ligjore-**kërkoj nga kryesuesja e kuvendit që futet në rend të ditës ky rishqyrtimi i vendimit 81/21 sipas instruksioneve dhe rekomandimit të AKK-së, dhe ceku se duhet pasur për bazë edhe vendimin e më hershëm që ka marr ky kuvend për pezullimin e aktiviteteve në Parkun Industrial në Lumadh.
**Sylejman Meholli, anëtar i kuvendit-**kërkoj të futet në rendin e ditës propozimi i grupit kuvendar të LVV-së deklaratë-rekomandim për Ministrinë e Financave për faljen e tatimit në pronë deri në 100 € për të gjithë tatimpaguesit e Komunës së Vushtrrisë.

Në vazhdim, kuvendi pas votimit me 23 vota "për", 1 votë "abstenim" aprovoj për futej në rendin e ditës Kërkesën për pezullimin e vendimit për vlerësimin e përgjithshëm të pronave rezidenciale, drejtuar Ministrisë së Financave.

**Ferit Idrizi, kryetar i komunës-**kërkoj nga të gjitha subjektet politike të përfaqura në kuvend të dalin me një qëndrim të përbashkët sa i përket rivlerësimit të vlerës së pronës dhe tatimit në pronë dhe të adresojnë një kërkesë të përbashkët në Ministrisë së Financave për pezullimin e vendimit për tatimin në pronë.

Pas votimit kuvendit me 12 vota "për" 8 vota "kundër" 1 votë "abstenim" aprovoj për futej në rendin e ditës Rekomandimin-Deklaratë, adresuar Ministrisë së Financave për faljen e tatimit në pronë në vlerën deri në 100 euro për të gjithë tatimpaguesit e Komunës së Vushtrrisë për vitin 2023.

Pas votimit kuvendit me vota "unanime" aprovoj për futej në rendin e ditës kërkesën-propozimin për pagesën e shujtës për Brigadën e Zjarrëfikjes dhe Shpëtimit të Komunës së Vushtrrisë.

**Në fund të debatit jashtë rendit të ditës dhe për rendin e ditës, Kuvendi pas votimit me 33 vota "për" 1 votë "kundër" aprovoi këtë:**

**R E N D D I T E**

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 29 dhjetor 2022;
2. Shqyrtimi i Raportit për të hyrat dhe shpenzimet për periudhën janar – dhjetor 2022;
3. Shqyrtimi i Draft-Rregullores për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës të veprimtarive afariste-bizneseve në Komunën e Vushtrrisë;

4. Shqyrtimi i propozim-vendimit për shfuqizimin e vendimit të kuvendit të komunës me numër të protokollit 265/22 i datës 27.10.2022, për caktimin e lokacionit për ndërtimin e lapidarit për heroin "Adem Voca";
5. Shqyrtimi i propozim-vendimit për shfuqizimin e vendimit të kuvendit të komunës me numër të protokollit 294/22 i datës 24.11.2022, për caktimin e lokacionit për ndërtimin e lapidarit për heroin "Adem Voca";
6. Shqyrtimi i Raportit të punën të Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit;
7. Shqyrtimi i propozim-vendimit për shfuqizimin e vendimit të kuvendit të komunës me numër të protokollit 81/21 datës 16.04.2021, për dhënien e pronës në shfrytëzim në Parkun Industrial në Lumadh;
8. Shqyrtimi i Kërkesës për pezullimin e vendimit për vlerësimin e përgjithshëm të pronave rezidenciale, drejtuar Ministrisë së Financave;
9. Shqyrtimi i Rekomandimit-Deklaratës, adresuar Ministrisë së Financave për faljen e tatimit në pronë në vlerën deri në 100 euro për të gjithë tatimpaguesit e Komunës së Vushtrrisë për vitin 2023;
10. Shqyrtimi i kërkesës për pagesën e shujtës për Brigadën e Zjarrëfikjes dhe Shpëtimit të Komunës së Vushtrrisë;
11. Të ndryshme.

**1.** Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 29 dhjetor 2022;

**Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit-**kërkoj të jepen sqarime nga Sekretaria e Kuvendit, lidhur me procesverbalin e mbledhje të datës 29 dhjetor 2022, ku në procesverbal është konstatuar se mungojnë: Nasuf Aliu, Fatmire Cecelia, Gresa Muli dhe Mentor Hasani. Ndërsa më poshtë ceket e disa anëtarë të grupeve kuvendare të PDK-së, LDK-së dhe LVV-së, kanë lëshuar mbledhjen, ndërsa tani bëhet e ditur se nuk janë proceduar mëditje për këtë anëtarë të kuvendit.
**Agron Përçuku**, **anëtar i kuvendit-**kërkoj që opinioni i MAPL-së lidhur me çështjen e mëditjeve të iu dërgohet anëtarëve të kuvendit dhe mos të kërkon nënshkrimet nga sekretaria e kuvendit.
**Sylejman Meholli, anëtar i kuvendit-**tha nëse dikush mendon se duke ndal mëditjet e ndal zërin opozitar e ka gabim, dhe kjo tregon se në çfarë mase ka degraduar situata me kuvendin e komunës. Nëse shikohet procesverbali i mbledhjes del se shumica e diskutimeve janë zhvilluar para se anëtarët e kuvendit ta lëshojnë mbledhjen në mënyrë demonstrative për shkak të shkeljes së Ligjit për Vetëqeverisje Lokale duke refuzuar ta hedhë në votim një pikë të rendit të ditës. Lidhur me këtë çështje njoftoj se do ti adresohen MAPL-së dhe organeve tjera, për faktin se nuk mundet kjo çështje të mbetet në kompetencat e një individi. Lëshimi i mbledhjes është një mjetë demokratikë dhe që shmang gjendje jo të këndshme në kuvend si fryrjet, sharjet dhe situatat tjera. Kërkoj të sillen kompensimi i seancave për vitin 2022.
**Melihate Basholli-Latifi, Kryesuese e Kuvendit-**tha se duhet sqaruar se nuk janë ndal pagat, por janë pezulluar mëditjet e anëtarëve të kuvendit që kanë lëshuar mbledhjen, dhe për këtë ka kërkuar nga sekretaria e kuvendit që të kërkoj opinion në MAPL. Ajo shprehu nevojën që kjo çështje të rregullohet me rregulloren e punës të kuvendit, se deri në cilën stad të mbledhjes mund të kompensohen mëditjet. Ajo tha se më që e kemi përgjigjen e ministrisë do të kërkoj që mëditjet të kompensohen.
**Adnan Lahu, anëtar i kuvendit-**kërkoj të dihet se kush i ka ndalur mëditjet, dhe kush e ka autorizuar sekretarinë e kuvendit të kërkoj përgjigje në ministri.

**Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, Kuvendi me 21 vota "për" 4 vota "kundër" 1 votë "abstenim" aprovoi procesverbalin nga mbledhja rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 29 dhjetor 2022.**

**2.** Shqyrtimi i Raportit për të hyrat dhe shpenzimet për periudhën janar – dhjetor 2022;

**Gresa Muli ,anëtare e kuvendit-**tha se edhe në mandatin e kaluar kishte pasur kritika për siç tha për disa shpenzime të luksit që kishin ndodhur por gjendja nuk është më mirë as në qeverisjen aktuale, ku ka rritje të shpenzimeve të peti-keshit, udhëtimet brenda vendit, udhëtimet jashtë vendit, akomodimet brenda dhe jashtë vendit, shpenzimet për ushqim dhe pije, drekat zyrtare e të ngjashme. Në fund tha se e kupton se viti i parë i qeverisjes ka më tepër shpenzime të kësaj natyre, por ajo shprehu friken se janë duke u keqpërdorë parat e qytetarëve, andaj kërkoj sqarime nga Drejtoria e Financave se përse janë rritur këto shpenzime.
**Sylejman Meholli, anëtar i kuvendit-** të dashur qytetarë të Komunës së Vushtrrisë lidhur me raportin e të hyrat, shpenzimet dhe investimet kapitale për periudhën janar-dhjetor 2022 deklaroj: se edhe për kundër disa informatave jo te sakta dhe propaganduese me qellim te mbulimit të vërtetës Qeverisja e Ferit Idrizit ka dalur në vitin e parë të qeverisjes si qeverisja më e dobët në 22 vite. Miliona euro investime janë humbur nga paaftësia dhe joprofesionalizimi. Tendenca për të kamufluar me disa statistika nga kategoria e pagave dhe mëditjeve nuk mundet ti hedh pluhur syve opinionit publik për dështimin e madh qe ka ndodhur në shpenzimin e buxhetit për vitin 2022. Realiteti i shpenzimit të buxhetit për investime kapitale për vitin 2022 është sa janë shpenzuar vetëm 56 % e mjeteve dhe atë me shumë dyshime të cilat do t'i hulumtojmë për faktin se janë kryer pagesa për punët e papërfunduara. Është për keqardhje qe Komuna e Vushtrris ka humbur në investime kapitale hiq më pak se 2,686.309 € te cilat kanë shkuar në suficit Në rrethanat kur ndodhemi në gjendje të rënd kudo në glob, me inflacion të lart e me gjendje të vështirësuar financiare, andaj në këto koha kaq të rënda komuna jonë ka humbur mundësin që këto mjete ti investoj nw zhvillim ekonomik dhe rritjen e mirëqenies për qytetarët tanë. Në rrafshin tjetër ka humbur operatoret ekonomik që do të qarkullonin me këto mjete financiare, mandej ka humbur zhvillimi ekonomik dhe dëmtimi i interesit qytetar në zhvillimin e projekteve kapitale si : ndërtimi i shkollave, ambulancave, projektet e rrugëve, kanalizimeve e projekte të tjera që do ndikonin në përmirësimin e cilësisë së jetesës. Vetëm në shëndetësinë primare ka humbur në kohë pandemie 794,000.00 €, në fushën ku shpesh mungojnë edhe gjërat elementare të shkojnë në suficit mjetet vërtet është dëm i madh, në fushën e arsimit kanë shkuar në suficit dhe kanë humbur 767,406 €. Në Drejtorinë e Urbanizimit janë humbur 693,685 €. Në fushën e shërbimeve publike mbrojta civile dhe emergjencat 626,109.00 €. Në Bujqësi 570,280.00 €. Më tej shtoj se tabelat buxhetore alarmojnë të dhëna shqetësues në avokaturën publike nga 94 € shpenzime në vitin paraprak shpenzimet kanë shkuar në 18,201.00 € dhe në të njëjtën kohë kryetari i komunës ankohet në cilësinë e ekspertëve të jurisprudencës. Shërbimet kontraktuese nga 1,831,000.00 €, janë rritur për më tepër se 2 milion euro, furnizimet me zyre nga 93.000.00 € janë rritur në 132,000.00 €, furnizimi për ushqim dhe pije si dhe dreka zyrtare nga 29,895.00 € janë rritur në 149,124.00 €. Avancë për udhëtime zyrtare nga 2118 janë rritur në 30,162 € pra janë rritur shpenzimet e në ndërkohë është ulur përqindja e investimeve kapitale. Përqindja e realizimit të investimeve kapitale në Drejtorinë e Shëndetësisë është 33.40 % është përqindje që nuk ka ndodhur më herët në historinë e komunës tonë, përqindja e realizimit të investimeve kapitale në shërbimet sociale është

zero, 20.000.00 € të planifikuara 20.000.00 të mbetura realizimi = 0. Në bujqësi realizmi i buxhetit është në nivelin tepër të ulët me vetëm 20.88 %.
**Leonora Gërguri, anëtare e kuvendit-** tha se raporti vjetro i të hyrave dhe shpenzimeve, tregon më së miri paaftësinë e kësaj qeverie, kjo dëshmohet nga tabela e të hyrave ku për këtë vit kemi 100,1000.00 € më pak të hyra se sa në vitin e kaluar. Tek tablat e të hyrave sipas burimit të financimit shihet se kemi se nga 22.000.000 € të planifikuar janë shpenzuar 18.000.000 €, e mbetja e pashpenzuar është 4.000.000 € sipas fondeve, ku nga fondi 10 grani qeveritar, komunës i kanë shkuar në suficit 2,300.000 €. Ndërsa nga fondi 22 të hyrat e bartura komunës i kanë mbetur të pashpenzuara 1,46000.00 € nga viti paraprak dhe kjo tregon për paaftësinë e komunës në menaxhimin e financave publike. Tek tabela e shpenzimeve të larta sipas kategorive vërehet se tek investimet kapitale nga 6 milion euro mjete të planifikuar komuna ka shpenzuar vetë 3,35000.00€ apo shprehur në përqindje vetëm 56 % e buxhetit për këtë kategori, e që është përqindja më e vogël në historinë e komunës së Vushtrrisë në shpenzimin e buxhetit. Në vitet e mandatit të LDK-së në qeverinë e komunës shpenzimi i buxhetit ka qenë në shkallë shumë të larët në vitin 2018 shkalla e shpenzimit ka qenë 80 %, në vitin 2019 75 %, ndërsa në vitet 2020 dhe 2021 edhe pse vitet pandemike shpenzimi ka qenë 71% përkatësisht 68%. Performanca e komunës matet edhe me shpenzimin e buxhetit në investime kapitale edhe në këtë kontekst Komuna e Vushtrrisë është në nivel shumë të ulët. Sa i përket shpenzimit në nivel të drejtorive komunale vërehet se shpenzimi i buxhetit në disa drejtori është tepër i ulët si p.sh në Drejtorinë e Prokurimit edhe pse janë ndërruar drejtorë shpenzimi i buxhetit është në masën vetëm 57 % e që tregon se kjo drejtori ka një dështim total, sepse nga kjo drejtori varet edhe shpenzimi i buxhetit nga drejtoritë tjera komunale.
**Edona Gashi, anëtare e kuvendit-**tha se sa i përket raportit për të hyrat dhe shpenzimet për periudhën janar – dhjetor 2022, janë vërejtur shumë mangësi teknike në hartimin e tij, dhe shtoj se është shpenzuar më shumë aty ku nuk duhet se sa aty ku duhet. Pastaj tha se po filloj sipas tabelës për shpenzimet e kategorive të larta, dhe nuk e çudit fakti që Vushtrria prej vendit të pestë që ka qenë në vitin 2020 për sa i përket vlerësimit të perfomancës ka ra në vendin 19 tash në vitin 2022 me qeverisjen e PDK-së, sepse aty ku matet perfomanca e komunës e që është shpenzimi i mjeteve në kategorinë investime kapitale, komuna ka shpenzuar vetëm 56% të buxhetit, aty ku komuna ka mundur të kursej mjete në kategorinë mallra dhe shërbime gjë të cilën nuk e ka bërë dhe aty i ka shpenzuar 84%. Nëse merret për bazë kodi ekonomik shpenzime jashtë vendit dhe anvnse Komuna e Vushtrrisë për vitin 2022 i ka shpenzuar më tepër se 50.000.00 €, për kodin tjetër për sa i përket përfaqësimit të komunës e që kryetari i komunës po thotë se janë kthyer lëndë në favor të komunës e që janë paguar 18,000.00 €, atëherë duhet të publikohen këtë lëndë që komuna i ka fituar dhe të bëhen publike. Në vitin 2021 kemi pasur vetëm 95 € shpenzime të përfaqësimit sepse nuk është e arsyeshme të paguhen 18,000.00 dhe mos të fitohen lëndët. Mandej shpenzimet kontraktuese në vlerë prej 200,000.00 € ma shumë se në vitin 2021 duhet të arsyetohen. Furnizim për zyrë janë shpenzuar 38.800.00 € janë shpenzuar më shumë se sa në vitin 2021, furnizim me ushqim dhe pije janë shpenzuar 119,000.00 € kjo shifër marramendëse e cila është shpenzuar më shumë se sa në vitin 2021, furnizim pastrimi janë shpenzuar 14.900 € më shumë sa e sa në vitin 2021, edhe pse e kemi parasysh faktin se viti 2021 ka qenë vit me pandemi dhe ka pasur nevojë për furnizime të pastrimit, dreka zyrtare janë shpenzuar 8000 € më shumë se sa në vitin 2021. Në furnizime mjekësore janë shpenzuar 11,000.00 € më pa se sa në vitin 2021 dhe kjo është e dëmshme pasi që kemi nevoja elementare për shërbime shëndetësore. Pastaj mirëmbajtje e shkollave dhe objekteve shëndetësore është jashtë çdo niveli, edhe pse buxheti është shpenzuar në mënyrë jo të drejtë.

**Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit-**tha se në ballinë evidentohet një gabim teknik, që i referohet planin të punës për vitin 2022 e që duhet të jetë për vitin 2023. Në vazhdim duke analizuar raportin për të hyrat dhe shpenzimet u ndal tek shpenzimi i buxhetit për shkollat fillor të ulëta dhe ato të mesme, ku ceku se në raport thuhet ndërtimi i rrethojave për shkollat e që nuk specifikohet se në cilat shkolla është planifikuar të bëhet rrethimi i oborreve të shkollave shuma e mjeteve të planifikuara 2878 €, kurse janë realizuar 0. Investim në inventar në shkollën A.Z ”Çajupi” 22,000.00 € realizimi zero, fusha sportive dhe rrethoj në SH.M.U. në Lumadh shuma e planifikuar 29.000.00 € ndërsa janë realizuar vetëm 18,300 €, cila është arseja dhe përse nuk janë kryer punët pse nuk është shpenzuar i tërë buxheti. Ndërtimi i tualeteve në shkollën e M.U. "Emnin Duraku" në Novolan të planifikuar 44,319.00 € të realizuara zero dhe për më keq ka informacione se ato tualete janë ndërtuar dhe kompania e cila i ka kryer punët ka bërë devijim nga projekti, prandaj në këtë rast kërkoj hetim sepse në këtë rast nuk është paguar asnjë cent ndërsa realitet është se ato banjo dhe ato tualete në shkollën e përmendur më latë janë ndërtua dhe në këtë rast ka shkelje të shumta ligjore andaj është mirë ti tregohet kuvendit se cila është e vërteta lidhu me këtë projekt. Fusha sportive në SH.M.U "Enver Hadri" shuma e mjeteve të planifikuara 7000 € të realizuara zero, investim në SH.M.U "Lumni Surdulli" në fshatin Samdrexhë shuma e planifikuar 10,000.00 € realizimi zero. Ndërtimi i rrethojës së shkollës SH.M.U. "Mustaf Shyti" shuma e planifikuar 3500 € të realizuara zero, ndërtimi rrethojave në SH.M.U. në Vilancë të planifikuara 3000 € të realizuara zero, ndërtimi i shkollës në Gllavotin të planifikuara 136, 987.00 € të realizuara zero. Pajisje për praktikë në shkollën e mesme të lartë profesionalë "Bahri Haxha " shuma e mjeteve të planifikuara 55.000.00 € të realizuara zero. Kalda për nxehje në SH.M.L "Lutfi Musiqi" dhe në SH.M.U.2 shuma e planifikuar 20,000.00 € të realizuara zero, pajisje laboratorike në shkollën e mesme të lartë profesionalë "Bahri Haxha " shuma e planifikuara 10,000.00 € të realizuara zero renovimi i ngrohjes qendrore në shkollën "Bahri Haxha" të planifikuara 20,000.00 € të realizuara zero.

**Isuf Jashari, drejtor i DBF-së-**paraqiti sqarime lidhur me raportin për të hyrat dhe shpenzimet për periudhën janar – dhjetor 2022, duke u përgjigjur në temat e ngritura nga anëtarët e kuvendit. Ai më tej në mënyrë të specifikuar paraqiti të dhënën për shpenzimin e mjeteve financiare sipas kategorive ekonomike.

**Adnan Lahu, anëtar i kuvendit-**tha se për ta sqaruar opinion publik dhe anëtarët e kuvendit buxheti i komunës për vitin 2022 është aprovuar në muajin janar dhe nuk ka pasur vonesa në aprovim si kuvend i komunës dhe opozita e ka përkrahur këtë buxhet ashtu që komuna të mos ngecë sa i përket buxheti dhe shpenzimit të tij. Mirëpo për shkak të paaftësisë të kësaj qeverie tabelat financiare janë kthyer tri herë nga ministria dhe nuk duhet të manipulohet me shifra sepse buxheti për investime kapitale është shpenzuar 56 % dhe kështu duhet të thuhet e jo të propagandohet se është shpenzuar 80% buxheti.

**Sylejman Meholli, anëtar i kuvendit-**tha se nëse dikush vlerëson se shuma prej 56% e shpenzimit të buxhetit është e kënaqeshe atëherë kjo nuk flet për zhvillim ekonomik të komunës kur dihet se shumë kode ekonomik me zero shpenzime janë të prezantuara në raport. Nëse dikush mendon se vjen në kuvend dhe tenton të hedhë hi syve para anëtarëve të kuvendit ai gabohet. Sepse lexim i disa kodeve ekonomik dhe normave ligjore nuk e ndryshon buxheti në vazhdim ai në mënyrë përsëritur lexoj shumat e mbetura në suficit nga kategoria e investimeve kapitale që ato mjete financiare janë mjete të humbura për komunën tonë.

**Isuf Jashari, drejtor i DBF-së-**tha se raporti i të hyrave dhe shpenzimeve është raport me të dhëna zyrtare, dhe askush nuk po tenton të hedh hi syve, por e vërtet është buxheti shikohet si total dhe totali i shpenzimit të buxhetit për vitin 2022 është 81% kjo është e pa kontestuar.

**Refik Maloku, anëtar i kuvendit-**tha se drejtori i Drejtorisë së Financave e di fare mirë përgjigjen se sa është shpenzuar në realitet buxhetit dhe ai me një fjalor abstrakt tenton të mbulon dështimin që ka ndodhur në qeverisje sa i përket realizmit të buxhetit. Për dështimet nuk duhet fajësuar vetëm Drejtorin e Financave, sepse puna e shpenzimit të buxhetit është zingjirore sepse varet nga drejtoritë tjera komunale sa bëjnë kërkesa për zbatim të projekteve, dhe se Drejtoria e Financave është vetëm ekzekutuese e buxhetit. Dhe krejt çka po bënë Drejtori  i Financave përmes disa mjeteve mediave oborrtare të qeveris po propagandon për punë dhe mbulim të dështimit.
**Faton Hyseni, anëtar i kuvendit-**tha se projektit për ndërtimin e rrethojës për shkollën fillore në Lumadh është në përfundim e sipër, po ashtu edhe rregullim i fushës sportive është duke kryer andaj dëshiron të sqaroj opinion publik se kjo pikë është e kryer.
**Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit-**lidhur me projektin për ndërtimin e rrethojës së shkollës dhe fushës sportive në fshatin Lumadhe, ceku se ju referua raportit zyrtare ku thuhet se janë planifikuar 29.000.00 € ndërsa janë realizuar 18.000.00 € ose 63% dhe këto janë informata zyrtare, dhe atje ndoshta është duke u punuar por deri në fund të dhjetorit 2022 kjo ka qenë situata reale. Mandej mjetet për praktikë profesionale dhe pajisje laboratorike për shkollat e mesme janë mbi 65.000.00 € të cilat nuk kanë mundur të realizohen, dhe shkollat e mesme kanë dy ditë praktikë profesionale, andaj kërkoj nga kryetari i komunë që të gjej një zgjidhje për zhvillimin e praktikës profesionale në ndërmarrje, sepse nga tetori kur kemi filluar këtë vit shkollor nuk ka pasur mundësi me i dërguar nxënësit në praktikë profesionale në mungesë të një minibusi. Prandaj kishe me qenë mirë të planifikohen mjete për blerjen e një minibusi për SH.M.P "Bahri Haxha" për dërgimin e nxënësve në praktikë profesionale. Po ashtu pyeti nëse ka ndonjë planë për heqjen e disa autobusëve të vjetruar gati të deformuar në oborrin e shkollës së mesme teknike (shitjen e tyre dhe blerjen e një minibusi).
**Ferit Idrizi, kryetar i komunës-**tha se pa dashur ti përsërisë ato që veç u thanë më herët nga deputetët, deklaroi se dëshiron të bënë një rezyme të shkurtër lidhur me sfidat që e kanë karakterizuar vitin 2022, po kur flitet për shpenzimin e buxhetit komuna jonë del në pjesën e sipërme të tabelës në shpenzimin e buxhetit në krahasim me komunat tjera të Republikës së Kosovës. Kur flasim për të dhëna statistikore duhet të aplikojmë metodën e krahasimeve: shpenzimet për dreka zyrtare nuk mund të krahasosh një verës të shpenzuar atëherë kur ke ndryshim të çmimit të një produkti apo shërbimi dhe ndryshimi në këto vlera nga viti 2021 në vitin 2022 është tepër i madh. Por hajde të bëjmë një krahasim se sa kilometra rrugë ka bërë kryetari aktual në vitin 2022 në krahasim me vitin 2021 dhe nxjerrim edhe koston e shpenzimit të derivateve. Duke ju referuar investimeve kapitale, kemi pasur sfida, por secila qeveri insiston në shpenzimin e fondit 10 sepse ai fond kthehet në qeveri si suficit, dhe tek ky fond komuna ka arritur të shpenzoj 74% të mjeteve dhe këtë shifër nuk e lëkund askush. Ndërsa tek të hyrat e bartura dhe ato vetanke nuk është se ka ndonjë rrezik sepse ato mund të shfrytëzohen edhe në vitin vijues. Sa i përket shqetësimit për projektin e rregullimi të tualeteve që u kërkua hetim nga anëtari i kuvendit Haradinaj, vlerësoi se fakti se nuk është paguar asnjë cent tregon për udhëheqjen e mirë komunale në mos dëmtimin dhe ruajtjen e buxhetit të komunës. Lidhur me këtë projekt u zotua në formë solemne se do të dal bageri dhe do ta demoloj atë projekt sepse ka devijim të projektit. Mandej lidhur me tërheqjen e dy autobusëve në oborrin e shkollës së mesme teknike, ceku se pajtohet se ata autobus duhet të hiqen nga atje por, problemi qëndron se objekti që është ndërtuar tani pengon për zhvillimin e punimeve dhe kjo ka ndodhur në mandatin e kaluar, andaj ata autobus duhet të prehen dhe të njëjtit të dalin në ankand publik. Në tërësi nëse marrim shpenzimin e buxhetit nuk është se jemi të kënaqur por në këtë vit sfidues mund të thuhet se qeveria ka korrur sukses në këtë

pikë vështrim.  Andaj në fund potencoi se nëse bëjmë krahasim Komuna e Vushtrrisë e ka më mirë të realizuar buxhetin se sa 70% e komunave tjera të Republikës së Kosovës.
**Sylejman Meholli, anëtar i kuvendit-**tha se për të gjitha punët e mira që janë kryer nga komuna ata i gëzohen, por është e pa tolerueshme që nga shumë kode buxhetore shpenzimi i mjeteve është zero. shembull është mos shpenzimi i mjeteve për blerjen e veturës për administratën komunale e që ka shumë nevojë të bëhet posaçërisht  për Qendrën për Punë Sociale.

**Në fund të debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me 22 vota "për" 1 votë "kundër", 1 votë "abstenim" aprovoj raportin për të hyrat dhe shpenzimet për periudhën janar – dhjetor 2022.**

**3.** Shqyrtimi i Draft-Rregullores për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës të veprimtarive afariste-bizneseve në Komunën e Vushtrrisë;

**Gresa Muli, anëtare e kuvendit-**pyeti se cili është dallimi mes sallonit të ondulimit dhe frizerëve.
**Agron Përçuku, anëtar e kuvendit-**pyeti kryetarin e komunës se cili është organi komunal që ka të drejtë të pezulloj apo shfuqizoj një rregullore të kuvendit. Ndërsa kemi parë një njoftim të kryetarit të komunës, ku pezullohet pushimi në ditën e diele për shkak të festave të fund vitit.
**Ilmi Azemi, anëtar e kuvendit-**tha se qeveria e komunës është ngutur me procedimin e kësaj draft-rregullore për shkak se e njëjta nuk është analizuar si duhet. Mandej shtoi se edhe në kohet e kaluar është kërkuar që dita e diele të jetë ditë pushimi mirëpo më vonë është konstatuar se ka probleme dhe ankesa të shumta nga bizneset dhe qytetarët. Nga informata që ka bizneset në Vushtrri në kohen kur është aplikua kjo masë janë dëmtuar në gjiro në vlerë prej 400,000.00 €. Në fund tha se kjo çështje duhet të analizohet mirë sepse nëse veprohet vetëm në komunën tonë me të dielën ditë pushimi atëherë vërtetë do të dëmtohen bizneset, po ashtu një dukur tjetër që është vërejtur është tek stacionet e pumave të benzenit ku maketet e bashkangjitura  mund të punojnë 24 h në madhësi deri në $50m^2$ kjo është gabim sepse lokalet që janë më të mëdha duhet të bëjnë ndarje fizike të objektit.
**Shpëtim Zhegrova, nënkryetar i komunës-**tha se nëse shtyhet kjo pikë nuk do të parqet ndonjë problem, por komitetit duhet ta shqyrtoj dhe analizoj pak më ndryshe këtë çështje. Nga debatet publike që ka pasur me bizneset del se ka shumë divergjenca ku te markete ankesat për pushim i kemi kryesisht nga fuqia punëtore, ndera tek sallonet e ondulimit ka pasur dallim ku disa kanë kërkuar që e dilja të jetë ditë pushimi ndërsa të tjerat e kanë kërkuar të martën. Propozoi që lokalet ushqimore në fshatra deri në 100 metër katror tu lejohet të punojnë edhe ditëve të diela.
**Ferit Idrizi, kryetar i komunës-**tha me këtë rregullore duhet të bëhet balanci mes bizneseve dhe fuqisë punëtore, kjo për faktin se ka shumë kërkesa nga punëtoret që e diela të jetë ditë pushimi. Ideja më mirë do kishte me qenë që e diela të jetë ditë pushimi në nivel vendi.
**Bujar Pllana, drejtor i Drejtorisë së Inspektimeve-**paraqiti sqarime lidhur me draft-rregulloren për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës të veprimtarive afariste-bizneseve në Komunën e Vushtrrisë, duke u përgjigjur në pyetjet e anëtarëve të kuvendit.
**Sylejman Meholli, anëtar i kuvendit-**tha se në nivel parcial komuna e kanë të vështirë të gjejnë një zgjidhje sa i përket orarit sidomos pushimit për punëtoret dhe bizneset. Ideja e tij është e që mendon se do të funksiononte që në nivel të Asociacionit të Komunave të Kosovës të gjendet një zgjidhje duke hartuar një rregullore unike për të gjitha Komunat e Republikës së Kosovës.

**Agron Përçuku, anëtar e kuvendit-**insiston se ka vendim të kuvendit për pezullimin e zbatimit të rregullores për orarin e bizneseve i cili është marr nga kuvendi i komunës në mandatin e kaluar gjatë kohës së pandemisë.
**Bekim Zabërgja, anëtar i kuvendit-**tha se orari i punës për bizneset ushqimore gjatë stinës së verës duhet të jetë të paktën deri në ora 23:00 për faktin se gjatë kësaj kohe kemi vizita të shumta nga bashkatdhetarët tanë dhe zhvillimi i biznesit është i shumanshëm. Propozoi që kjo pikë të shtyhet për mbledhjen e ardhshme.

**Në fund të debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me vota "unanime" vendosi që Draft-Rregullorja për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës të veprimtarive afariste-bizneseve në Komunën e Vushtrrisë, të shtyhet për mbledhjen e radhës.**

**4.** Shqyrtimi i propozim-vendimit për shfuqizimin e vendimit të kuvendit të komunës me numër të protokollit 265/22 i datës 27.10.2022, për caktimin e lokacionit për ndërtimin e lapidarit për heroin "Adem Voca";

**Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës kuvendit pas votimit me 21 vota "për" të tjerët nuk morën pjesë në votim, kuvendi vendosi me sa vijon:**

**1.** Me këtë vendim shfuqizohet vendimi i Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë me numër të protokollit **nr. 265/22 i datës 27.10.2022, lidhur me caktimin e lokacionit** për ndërtimin e lapidarit në fshatin Pasomë, pjesë nga parcela kadastrale P-70202050-01296-0, në sipërfaqe prej 613 $m^2$, nga sipërfaqja e përgjithshme prej 89886 $m^2$, me kulturë kullosë e kl.4 ZK - Pasomë, e cila evidentohet si pronë e Komunës së Vushtrrisë.

**2.** Kryesuesja e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, duke marrë për bazë vlerësimin e ligjshmërisë të aktit në fjalë, të bërë nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, i propozon Kuvendit të komunës shfuqizimin e aktit të cekur në pikën 1 të këtij vendimi.

**3.** Për zbatimin e këtij vendimi obligohet: Kryesuesja e kuvendit, si dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.

**4.** Ky vendim hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**5.** Shqyrtimi i propozim-vendimit për shfuqizimin e vendimit të kuvendit të komunës me numër të protokollit 294/22 i datës 24.11.2022, për caktimin e lokacionit për ndërtimin e lapidarit për heroin "Adem Voca";

**Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës kuvendit pas votimit me 20 vota "për" 1 votë "kundër" të tjerët nuk morën pjesë në votim, kuvendi vendosi me sa vijon:**

**1.** Me këtë vendim shfuqizohet vendimi i Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë me numër të protokollit **nr. 294/22 i datës 24.11.2022, lidhur me caktimin e lokacionit** për ndërtimin e lapidarit në fshatin Pasomë, pjesë nga parcela kadastrale P-70202050-01296-0, në sipërfaqe prej

613 $m^2$, nga sipërfaqja e përgjithshme prej 89886 $m^2$, me kulturë kullosë e kl.4 ZK - Pasomë, e cila evidentohet si pronë e Komunës së Vushtrrisë.
**2.** Kryesuesja e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, duke marrë për bazë vlerësimin e ligjshmërisë të aktit në fjalë, të bërë nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, i propozon Kuvendit të komunës shfuqizimin e aktit të cekur në pikën 1 të këtij vendimi.
**3.** Për zbatimin e këtij vendimi obligohet: Kryesuesja e kuvendit, si dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.
**4.** Ky vendim hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**6.** Shqyrtimi i Raportit të punën të Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit;

**Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit-**adresoj një pyetje për Drejtoreshën e Urbanizmi, lidhur me tri prona të një personi, prona të cilat ndodhen në komasacion e që ka ndodhur bashkimi i tyre në një kod të vetëm sipërfaqja e pronës 1,16. 87 ha, pyetja ka të bëj se çka e lidhë drejtoreshën me këtë pronë dhe a është respektuar ligji, sepse për pronat në komasacion kompetencë ekskluzive ka qeveria e Kosovës, më tej pyet se si është bërë bashkimi i këtyre pronave ku pretendohet të bëhet ndërtim në këtë pronë. Pyetja tjetër ka të bëjë së është bërë ndërrimi i destinimit nga pronë bujqësore në pronë ndërtimore pa pëlqimin e ministrisë gjegjëse ku me ligj për rregullimin e tokave janë të përcaktuara saktë procedurat dhe kompetencat.
**Sylejman Meholli, anëtar i kuvendit-**lidhur me raportin analitik për Drejtorinë e Urbanizmi, i kërkuar nga Komitetit për Politikë dhe Financa, pyetja për drejtoreshën është pse ju nevojiten 16 ditë me u bind që duhet të sillet materiali i cili ka kaluar në KPF, që me mbet në situatën që anëtarët e kuvendit të mos kenë mundësi të lexojnë materialin. Kjo ndodhur derisa MAPL e detyroj komunën, përkatësisht drejtorinë që ta sjellë këtë material në kuvend. Mandej duke ju referua faqes 11 të raportit ku thuhet menaxhimi dhe mbikëqyrja e personave të ndryshëm në Drejtorinë e Urbanizmit, në një vend shkruan nderimi i oborrit të QKMF-së, dhe më poshtë shkruan mbikëqyrja e oborrit të QKMF-së dhe këto gjëra nuk kanë lidhje logjike. Në faqen 10 të raporti asfaltimi i rrugëve në 13 fshatra, projekt dy vjeçar vlera e kontratës 465.346.00 € të përfunduara 90% është për lëvdatë por nuk po shënon se ku janë ndërtuar këto rrugë që të informohet kuvendi dhe opinioni publik.
**Furtuna Krasniqi, drejtoreshë e DUMM-së-**paraqiti sqarime të përgjithshme lidhur me raportin në fjalë duke u përgjigjur në pyetjet e ngritura nga anëtarët e kuvendit.

**7.** Shqyrtimi i propozim-vendimit për shfuqizimin e vendimit të kuvendit të komunës me numër të protokollit 81/21 datës 16.04.2021, për dhënien e pronës në shfrytëzim në Parkun Industrial në Lumadh;

**Bekim Zabërgja, anëtar i kuvendit-**tha se pa dashur të lëshohet në të gjeturat e raportit të komisionit për verifikimin e pronës të cilin në formë fizike dhe elektronike e kanë pasur anëtarët e kuvendit, potencoi se rregullt për ngritjen e një zone ekonomike, komuna fillimisht i inicion procedurat dhe bënë kërkesën në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë kjo e fundit më tej i procedon në Qeveri e cila merr vendim ku ata janë bashkëpronar të pronës të pjesë të asaj zone ekonomike. Prej momentit të formimit të zonës ekonomike, Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë menaxhon në bazë të ligjit për zonat ekonomike dhe udhëzimeve administrative të MTI-së dhe rregullores së Qeverisë së Republikës së Kosovës. Megjithëse MTI si bartës i tërë këtij procesi e cila ka obligimin të siguroj mjetet për ndërtimin e zonës ekonomike me krejt infrastrukturën publike përcjellëse, kjo

e fundit prapëseprapë nuk ka pasur të drejtë të shpallë konkursi pa u bërë pranimin teknik i zonës ekonomike apo objektit. Ndërsa pranimi teknik i zonës ekonomike është bërë me datën 16.05.2022, dhe falë angazhimit të kryetarit të komunës z.Ferit Idrizi dhe falë angazhimit dhe besueshmërisë së MTI-së më datën 13 qershor 2022, kryetari i komunës ka arritur me MTI-në një aneks marrëveshje me të cilën citojmë: nga momenti i pranimit teknik të objektit Parku Industrial në Lumadh do të menaxhohet nga Komuna e Vushtrrisë si në aspekti e mirëmbajtjes, ruajtjes së investimeve dhe hapësirave, e që do të thotë vetëm pas datës 14 qershor 2022 janë krijuar të gjitha kushtet ligjore që komuna të shpall konkurs për vendosje e bizneseve në parkun industrial. Andaj duke marr për bazë shkeljet procedurale dhe shkeljet tjera që kanë karakterizuar këtë proces kërkoj dhe i propozoj anëtarëve të kuvendit që të votojnë pro për shfuqizimin e vendimit të kuvendit të komunës me numër të protokollit 81/21 datës 16.04.2021, për dhënien e pronës në shfrytëzim në Parkun Industrial në Lumadh.
**Ismet Gashi, udhëheqës i zyrës ligjore të komunës-**tha se duke marrë për bazë se Agjencia Kundër Korrupsion e ka kthyer këtë vendim në rishqyrtim, jo në shfuqizim siç e quajnë disa për shkak të konfliktit të interesit, e që në fakt z.Ilmi Azemi është konstatuar se ka pasur dhe ka konflikt interesi, konsideron se ai nuk duhet ta marr fjalën për të diskutuar dhe për të votuar.
**Melihate Basholli-Latifi, Kryesuese e Kuvendit-** në rikapitullimin e këtij pike të rendit të ditës, konstatoj me sa vijon: anëtarët e kuvendi që kanë konflikt të interesit duhet ta lirojnë sallën e kuvendit, ashtu që të shmangin konfliktin e interesit në vendimmarrjen e kuvendit lidhur me zonën ekonomike në Lumadh, konstatoj se në sallë janë të pranishëm 31 anëtarë të kuvendit kuorum i mjaftueshëm për të marr vendim meritor dhe të plotfuqishëm.

**Në fund të debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës kuvendit pas votimit me 23 vota "për" 6 vota "kundër" vendosi me sa vijon:**

**1.** Me këtë vendim shfuqizohet vendimi i Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë me numër të protokollit **nr. 81/21 i datës 16.04.2021, lidhur me dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës në Parkun Industrial në Lumadh** bizneseve private, nga parcelat e evidentuara në certifikatën e pronësisë P-70202011-00435-1 dhe P-70202011-00435-3, në sipërfaqen e tërësishme prej 14.86 ha, Zona Kadastrale Lumadh, pronë e Komunës së Vushtrrisë.

**2.** Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë, Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit.

**3.** Ky vendim hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**8.** Shqyrtimi i Kërkesës për pezullimin e vendimit për vlerësimin e përgjithshëm të pronave rezidenciale, drejtuar Ministrisë së Financave;

Në vazhdim kuvendi me 25 vota "për" aprovoj themelimin e komisionit për hartimin e tekstit të kërkesës për pezullimin e vendimit për vlerësimin e përgjithshëm të pronave rezidenciale, drejtuar Ministrisë së Financave në përbërjen si në vijim:

Zojë Hajrizi, PDK;
Shkelzen Xhaferi, LDK;
Faton Hyseni, AAK;

Bekim Zabërgja, Nisma Socialdemokrate;
Isuf Jashari, Drejtor i DBF-së PDK;

**Zojë Hajrizi, anëtare e kuvendit-** lexoj para kuvendit tekstin e kërkesës për pezullimin e vendimit për vlerësimin e përgjithshëm të pronave rezidenciale, drejtuar Ministrisë së Financave.

Pas votimit kuvendi me 26 vota "për" vendosi me sa vijon:

Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë, në mbledhjen e mbajtur më datë: **31 janar 2023,** pasi ka shqyrtuar ankesat e shumta të qytetarëve për obligimet pas rritjes së normave tatimore, dhe duke marrë për bazë gjendjen e rëndë ekonomike dhe sociale që po mbretëron në vendin tonë si rezultat i inflacionit të lartë, pas një analize të hollësishme parashtron këtë:

**<u>Kërkesë</u>**

Siç është e ditur kuvendet komunale nuk kanë të drejtë të falin tatimin në pronë, sepse janë obligime që rrjedhin nga Ligji Nr.06/L-005 i Tatimit në Pronë, i aprovuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Andaj Kuvendi i komunës kërkon:

1. Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve me vendim të pezullojë aplikimin e rivlerësimit të patundshmërive në vend;
2. Faturat e tatimit në pronë të llogariten të njëjta si në vitin e kaluar (2022);
3. Së pari të amendamentohet Ligji Nr.06/L-005 i Tatimit në Pronë, neni 9 (normat tatimore);
4. Kërkojmë që për shkak të gjendjes së rëndë sociale të falen obligimet deri në 100 euro për çdo tatimpagues.

**9.** Shqyrtimi i Rekomandimit-Deklaratës, adresuar Ministrisë së Financave për faljen e tatimit në pronë në vlerën deri në 100 euro për të gjithë tatimpaguesit e Komunës së Vushtrrisë për vitin 2023;

Pas votimit kuvendi me 26 vota "për" vendosi me sa vijon:

Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë, në mbledhjen e mbajtur më datë: **31 janar 2023**, duke marrë për bazë propozimin e grupit kuvendar të Lëvizjes Vetëvendosje të përfaqësuar në Kuvendin e Komunës së Vushtrrisë**,** pasi ka shqyrtuar ankesat e shumta të qytetarëve për obligimet pas rritjes së normave tatimore, duke marrë për bazë gjendjen e rëndë ekonomike dhe sociale që po mbretëron në vendin tonë si rezultat i inflacionit të lartë, pas një analize të hollësishme parashtron këtë:

**<u>Rekomandim-Deklaratë:</u>**

Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë kërkon nga Ministria e Financave Punës dhe Transfereve, faljen e tatimit në pronë në vlerën deri në 100 euro për të gjithë tatimpaguesit e Komunës së Vushtrrisë për vitin 2023.

**10.** Shqyrtimi i kërkesës për pagesën e shujtës për Brigadën e Zjarrëfikjes dhe Shpëtimit të Komunës së Vushtrrisë;

**Agron Përçuku, anëtar e kuvendit-**pyeti zyrën ligjore se a kemi të drejt të marrim një vendim të tillë lidhur me shujtat, pasi që zjarrëfikit janë në kuadër të ministrisë, që të mënjanohen shkeljet ligjore.
**Ferit Idrizi, kryetar i komunës-**tha se ideja është shumë e mirë që të iu paguhen shujtat zjarrfikësve por duhet të shikohet se a kemi të drejt juridikisht.
**Shpëtim Zhegrova, nënkryetar i komunës-**tha se është mirë që drejtoria, të bëj një kërkesë në Ministrinë e Financave që të marr mendim se a kemi të drejtë të paguajmë shujtën për zjarrfikësit dhe shërbyesit civil në Komunën e Vushtrrisë.
**Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit-**me qenë se bëhet fjalë për një kategori që kryen punë specifike, kostoja e vendimit ishte 20,000.00 €, propozoj që të merret vendimi por edhe të caktohet kodi dhe kategoria se ku do të merren mjetet financiare, kjo do të mund të bëhej nga kategoria e subvencione dhe pagesa do të mund të kryhej përnjëherë për tërë vitin, ndërsa këta zyrtar do të mund ti tërhiqeshin mjetet në mënyrë permanente, propozoi që mjetet të merren nga kategoria e subvencioneve, nëse merren nga pagat dhe mëditjet vendimi do të kthehet si i kundërligjshëm.
**Adnan Lahu, anëtar i kuvendit-**tha se është mirë që mos të ceket në vendim kodi se ku do të merren mjetet, por që vetëm obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa që t' i siguroj mjetet financiare dhe pas konfirmimit nga Ministria e Financave atëherë do të mundësohet të merren mjete aty ku ka mjete të lira.
**Sylejman Meholli, anëtar i kuvendit-**tha se si grup kuvendar e mbështesin këtë propozim-kërkesë për këto shujta, sepse ka nevojë që të përmirësohen kushtet, dhe ja përkujtoj kryetarit të komunës që kishte premtuar shujtë për punëtorët shëndetësor dhe kishte me qenë mirë që edhe ky premtim të realizohet.

**Në fund të debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës kuvendit pas votimit me vota "unanime" vendosi me sa vijon:**

**1.** Me këtë vendim bëhet pagesa e shujtës për punëtorët e Njësisë Profesionale për Zjarrëfikje dhe Shpëtim –Brigada e Zjarrëfikjes dhe Shpëtimit të Komunës së Vushtrrisë.

**2.** Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Buxhet dhe Financa, e cila do ti siguroj mjetet financiare nga buxheti i komunës në fondet ku ka mjete të lira në dispozicion.

**3.** Ky vendim hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**Mbledhja përfundoi në ora: 18:30.**

| | |
|---|---|
| **Bastri Duraku** | **Melihate Basholli-Latifi** |
| _______________ | _______________ |
| **Procesmbajtës** | **Kryesuese e Kuvendit** |

| | | |
|---|---|---|
| | **Republika e Kosovës**<br>Republika Kosova – Republic of Kosovo<br>Qeveria – Vlada – Government<br>Ministria e Punëve të Brendshme<br>Ministarstvo Unutrašnjih Poslova / Ministry of Internal Affairs<br>Policia e Kosovës / Policija Kosova / Kosovo Police | |
| | Drejtoria Rajonale e Policisë / Mitrovicë<br>Regionalna Policijska Direkcija / Regional Police Directorate<br>Stacioni Policor Vushtrri<br>Policijska Stanica Vučitern / Police Station Vushtrri | |

**MEMORANDUM ZYRTAR - SLUZBENI MEMORANDUM - OFFICIAL MEMORANDUM**

| | | | |
|---|---|---|---|
| **PËR:**<br>**ZA:**<br>**TO:** | Zonja Melihate Basholli<br>Kryesues i kuvendit komunal Vushtrri | **Data:**<br>**Datum:**<br>**Date:** | 08.02.2023 |
| **PËRMES:**<br>**PREKO:**<br>**THROUGH** | Drejtpërdrejtë | **Nr. i Referencës:**<br>**Br. Referencije:**<br>**Reference No:** | 04/1-02 VSH-K / 015/ 2023 |
| **PREJ:**<br>**OD:**<br>**FROM:** | Kapiten Reshat Kovaçi<br>Komandant i Stacionit<br>Stacioni Policor Vushtrri | | |
| **LËNDA:**<br>**PREDMET:**<br>**SUBJECT:** | Informatë mbi gjendjen e sigurisë në zonën e pëgjegjesisë së komunës së Vushtrrisë për vitiin 2022 | | |

E nderuara Kryesuese zonja Melihate BASHOLLI

Për gjatë vitit 2022 situata e sigurisë në zonën e përgjegjësisë së Stacionit Policor Vushtrri ka qenë e mirë , stabile dhe e qete . Puna dhe angazhimi i zyrtarëve policor ka qen i fokusuar në parandalimin e rasteve kriminale ,zbulimin dhe vënien e kryerësve te veprave penale para drejtësisë. Angazhimet e shtuara kanë që në periudhën e verës dhe fund vitit në kohen që mërgimtarë vinë me pushime në vendlindje. Angazhimet ynë me i madh është zhvilluar rreth lokaleve ku frekuentohen nga bashkatdhetarët dhe rrugët në qytet si bulevardi „Adem Jashari" si dhe në qendrat tregtare . Angazhime shtesë Stacioni ynë ka pas në asistimin e Drejtorisë rajonale rreth situatës në veri dhe në implementimin e vendimeve të qeverise ,ku një numër mjafte i madh i zyrtarëve nga stacioni Policor Vushtrri kanë qen në asistim te stacioneve policore ne veri te vendit. Gjatë vitit 2022 kemi pas një rritje të vogël të rasteve vepra penale ne në krahasim me vitin 2021 në 3.7% ku në vitin 2021 kemi pas 1126 raste ,kurse në vitin 2022 kemi pas 1168 raste . Te veprat penale nga ka pas një rritje nga 754 ne 853 vepra penale ne përqindje prej 8% .Incidentet ne vitin 2022 ka arritur ne 315 duke pas një rënie prej 7.89%.Nga to janë 251 aksident trafiku .



Adresa: Rr. „ Qamëria "27. 42000 Vushtrri, Kosovë
Stacioni Policor Vushtrri, Mitrovicë

- **Siguria Publike**

Zyrtarët policor për gjatë gjithë vitit kanë qen të angazhuar rreth ofrimit të sigurisë së përgjithshme. Angazhimet tona kanë qen në shtimin e patrullimeve në qytet edhe në fshatra sidomos në orët e vona të natës ,ku me asistimin edhe nga drejtoria rajonale kemi pas shtim të pikave të kontrollit me qëllim parandalimin e veprave kriminale dhe identifikimin e mundshëm të personave që janë në kërkim dhe potencial për veprimtarit kriminale ,ndjekjen dhe identifikimin e personave përdoruesve të narkotikëve në lokacione të ndryshme sidomos rreth stadiumit të lojërave me dorë dhe në rrugët ,, Pandeli Sotiri " dhe ,,Marin Barleti" si dhe shëtitores ,, Enver Zymberi ". Gjate muajve te verës është rritur dukshëm pakënaqësia qytetare ndaj ndotjes akustike nga lokale te ndryshme ne zona te ndryshme te qytetit. Policia e Kosovës gjegjësisht zyrtaret e stacionit policor kanë marre masa me sanksionim mandator ndaj kundërvajtësve te kësaj natyre. Është e rëndësishme te ceket se organet komunale ka drejtuar një shkresë tek stacioni policor për marrjen e masave ndaj kundërvajtësve qe krijojnë ndotje akustike ne lokale te ndryshme te qytetit duke pretenduar se kane mungesë legjislacioni për te marre masa si organe komunale ndaj kësaj dukurie. Gjatë vitit të kaluar kemi pranuar lajmërim rreth vendosjes së bombave në shkolla me minoritet serb ku fatmirësisht ka dal që janë lajmërime të rrejshme dhe kanë kaluar pa ndonjë problem . Angazhimet tona kanë qen edhe rreth detyrave që na vinë nga gjykata , sigurimin e manifestimeve sportive dhe kulturore ku janë përcjell dhe nuk ka pas ndonjë problem që vlen të ceket .Kemi pas angazhim rreth planeve operative sidomos në Planet Portative ,,Sezona verore dhe Dimërore " e shumë planeve operativë të tjera me qëllim ofrimin e sigurisë së qytetareve dhe në përkrahjen e institucioneve Komunale ashtu edhe qendrore dhe shumë agjencive të ndryshme .Gjendja në vendbanimet me minoritet serb ka qen e mirë e qet dhe stabile .

- **Veprat penale me serioze**

Dhuna ne familje ka qene një veprat penale qe ka shënuar rritje ne nivel vendi po ashtu edhe tek ne ka pas një rritje të dukshme të këtyre rasteve duke krahasuar me vitin e kaluar ku kemi pas 59 Raste në 2021 e në vitin 2022 kemi 108 raste apo thënë në përqindje një rritje pre 83.1%. Trajtimi dhe qasja e këtyre rasteve nga zyrtarët Policor të Stacionit ka qen prioritet dhe detyrë me përgjegjësi të lart në bazë të ligjeve në fuqi .

Tek veprat penale kundër trupit dhe jetës kemi një ngritje te rasteve e ne veçanti ne këtë kategori. Lëndimet të rënda trupore nga 11 raste 2021 në 5 raste në 2022 ,kurse te lëndimet e lehta trupore kemi 96 raste në 2021 e në vitin 2022 kemi 101. Kanosjet janë veprat qe kane shënuar rritje konsiderueshme ne këtë vite kane ndodhur 90 nga 56 qe kane ndodhur vitin e kaluar.

Te veprat penale kundër pasurisë është shënuar rënie e rasteve me te rëndësishmet ne këtë kategori: Vjedhje e rëndë 104 /93, Vjedhjet 148//106, 4 raste të grabitjes te cilat kane ndodhur pa përdorimin e armeve te zjarrit .

Si shqetësim mbetet, rastet e përdorimit të narkotikëve nga të rinjtë . Zyrtarët policor kanë pas patrullime të shpeshta në lokacionet ku dyshohet se rrinë përdoruesit e substancave narkotike , kemi zhvilluar plane operative ne luftimin e kësaj dukurie ku gjatë vitit 2022 kemi proceduar në prokurori



Adresa: Rr. ,, Qamëria "27. 42000 Vushtrri, Kosovë
Stacioni Policor Vushtrri, Mitrovicë

49 raste të posedimit apo blerjes së pa autorizuar të narkotikëve .Angazhimet tona në luftë me këtë dukuri do jenë në vazhdimësi .

Rastet e armëmbajtjeve pa leje dhe te rasteve të përdorimit të armeve vazhdon te jete i madh dhe shqetësues. Raste në rritje e Posedimit të armës si dhe rastet e përdorimit të armës 72/94 kanë pas një rritje në vitin 2022,ku janë konfiskuar 52 arme dhe 225 municione.

Raste tjera te cilat janë paraqitur ne numër me te madh këtë vit janë edhe falsifikimi i parave qe si dukuri është mjafte e përhapur edhe ne nivel vendi. Tek ne janë evidentuar gjithsej 34 raste nga 18 te vitit te kaluar.

- **Trafiku**

Situata e sigurisë në komunikacion është jo në gjendje të mirë edhe për kundër punës së zyrtarëve policor rreth parandalimit të aksidenteve ,kemi një përmirësim por jo në nivelin që dëshirojmë ,ketë vit me krahasuar me vitin e kaluar kemi një rënie prej -9.4 % (277/251 ) raste që duket të ketë përmirësime por ende jemi larg zvogëlimit të kënaqshëm të aksidenteve . Për fat te keq është shënuar një rast aksident trafiku me fatalitet me dy viktima. Patrullimet dhe pikat e kontrollit kanë pas qëllim në parandalimin e aksidenteve dhe vetëdijesimin e vozitësve në respektimin rregullave në trafik ,sidomos respektimin shenjave të komunikacionit. Gjatë pikave të kontrollit kemi përdor edhe radarin me qëllim identifikimit dhe gjobitjes se vozitësve të pa ndërgjegjshëm që nuk respektojnë shpejtësinë e kufizuar sidomos në zonat e banuara . Si problematik në zonë ton ka mbet ende rruga e papërfunduar Prishtinë – Mitrovicë ku kemi pas një numër të aksidenteve me lëndime ,kemi pas ngarkesa në rrugë ku ky segment i pa përfunduar gjatë sezonës verore krijon kolona të gjata . si pika të rrezikshme kanë mbet ende kyçjet me rrugët „2 Maji' , Fshati Begaj dhe rruga „ Shote Galica " ku ende nuk është vendos sinjalistika (Semaforët) . Në qytet kemi qene te angazhuar njësinë e biçikletave që janë marr me mbarëvajtjen e trafikut si dhe parkimet ilegale .

- **Siguria në shkolla**

Siguria në shkolla ka qen në nivel të mirë të sigurisë edhe vitin 2022 , kemi punuar në bazë të planit Operativ Siguria në shkolla ku zyrtarët e angazhuar rreth shkollave kanë bërë një punë të mirë në ofrimin e një ambienti sa me te sigurt për nxënësit dhe personelin e shkollave. Bashkëpunimi i mirë mes drejtoreve të shkollave dhe zyrtarëve kanë dhen rezultate në sigurinë e mirë që kemi në gjitha shkollat e qytetit. Puna e zyrtarëve të angazhuar ka pas në fokus parandalimin e incidenteve në shkolla dhe rreth tyre. Në kuadër të angazhimeve rreth shkollave kemi zbatuar edhe një plan kontrolli në shkolla në muajin maj qe ka pas për qëllim eliminimin e çdo dukurie negative tek nxënësit sidomos. , përdorimit të narkotikëve dhe bartjeve të armëve .Gjatë vitit kemi zhvilluar ligjërata vetëdijesimi në shumë shkolla për ndërgjegjësimin e tyre rreth dukurive negative në shoqëri . Besoj se bashkëpunimi i mirë me drejtorët dhe mësimdhënësit do vazhdojë dhe gjendja e sigurisë do jetë gjithnjë më e mirë .

- **Bashkëpunimi institucional dhe me qytetar**



Adresa: Rr. „ Qamëria "27. 42000 Vushtrri, Kosovë
Stacioni Policor Vushtrri, Mitrovicë

Ne si Stacioni Policor për gjatë gjithë vitit 2022 kemi pas një bashkëpunim të mirë me gjitha institucionet ,ku i kemi asistuar shumë institucioneve në kërkesat e tyre drejtuar Policisë ,si Komunës ,Gjykatave ,KEDS-it ,Përparimit ,Klubeve sportive dhe përmbaruesve dhe në gjithë aktivitetet që janë mbajte në Vushtrri etj. Gjatë këtij viti kemi pas takime me Këshillin Komunal për Siguri ne Bashkësi qe udhëhiqet nga Kryetari i Komunës se Vushtrrisë dhe qe ne këtë këshill është një numër i madh i anëtareve te cilët japin kontributin e tyre ne këshilla dhe ne identifikim te problemeve qe i preokupojnë qytetaret. Kemi pas takime edhe në nivel të KLSP-ve në Prilluzh dhe Banjsk që funksionojnë në zonën tone te përgjegjësisë.

- Policia e Kosovës, respektivisht Stacioni Policor Vushtrri edhe gjatë viti 2023 do të vazhdojë me përkushtimin të lartë të angazhohet në përmbushjen e objektivave Policore për të krijuar një ambient , sa më të sigurt dhe të qetë për të gjithë qytetarët.

Me respekt!



Adresa: Rr. „ Qamëria ”27. 42000 Vushtrri, Kosovë
Stacioni Policor Vushtrri, Mitrovicë

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Sheshi "Ahmet Krasniqi" nr. 10, Tel.038/200 42402, E-mail: ferit.idrizi@rks-gov.net

| | |
|---|---|
| PËR/ZA/TO: | KPF dhe Kuvendin e Komunës |
| CC | |
| NGA/OD/FROM: | Ferit Idrizi,<br>Kryetar i Komunës |
| TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT: | Draft Rregullore |

---

Të nderuar/a anëtar/e të KPF dhe kuvendit,

Të bashkëngjitur keni Draft Rregulloren për Përcaktimin e Kritereve për Ndarjen e Mjeteve Financiare nga Fondi për Transfere dhe Subvencione Personave Juridik – OJQ dhe Personave Fizik dhe Bashkëfinancim, në Komunën e Vushtrrisë.

Draft Rregullorja ju dërgohet për shqyrtim dhe miratim.

Me respekt,

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI
KUVENDI I KOMUNËS

DRAFT - RREGULLORE

# PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE TË NDARJES SË MJETEVE FINANCIARE NGA FONDI PËR TRANSFERE DHE SUBVENCIONE PERSONAVE JURIDIK – OJQ DHE PERSONAVE FIZIKË DHE BASHKFINANCIM

Vushtrri, Shkurt, 2023

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2 shkronja "c" lidhur me nenin 17 shkrpnjat "k", "r" dhe "s" të Ligjit Nr. 03/L-040 mbi Vetëqeverisjen Lokale si dhe Rregulloren e MF Nr. 04/2017 mbi Kriteret Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, nenit 19, paragrafi 1 pika 1.3 të Statutit të Komunës, Kuvendi I Komunës në mbledhjen e mbajtur më ____________ 2023 miraton këtë:

RREGULLORE
PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE TË NDARJES SË MJETEVE FINANCIARE NGA FONDI PËR TRANSFERE DHE SUBVENCIONE PERSONAVE JURIDIKË - OJQ DHE NDIHMË MOMENTALE PERSONAVE FIZIKË DHE BASHKFINANCIM

**Neni 1**
**Qëllimi**

Me këtë rregullore themelohet baza juridike për ndarjen e mjeteve të buxhetit të Komunës së Vushtrrisë - fondi për transfere dhe subvencione, për persona fizik dhe juridik-OJQ, ndihmë momentale për persona fizikë, si dhe baza juridike dhe mënyra e bashkëpunimit me persona juridik dhe fizik përmes bashkëfinancimit të projekteve.

**Neni 2**
**Fushëveprimi**

Kjo rregullore përcakton raportet juridike dhe kriteret e ndarjes së subvencioneve në mes të personave juridik- OJQ, personave fizik dhe komunës së Vushtrrisë, si dhe raportet juridike në mes të Komunës së Vushtrrisë me personat fizik dhe juridik në bashkëfinancim të projekteve me interes të përbashkët.

**Neni 3**
**Përkufizimet dhe shkurtesat**

Përkufizimet në këtë rregullore kanë këtë kuptim:

1. Subvencione - shuma e parave që komuna i jep pa kthim personave juridik-OJQ për mbështetje të aktiviteteve dhe projekteve të interesit publik, si dhe personave fizik nga fondi për transfere dhe subvencione.

2. Përfitues - janë personat fizikë dhe juridikë - OJQ që përfitojnë mjete financiare pa kthim nga kategoria e subvencioneve të planifikuar në Buxhetin e Komunës së Vushtrrisë dhe në pajtim me Ligjin për Buxhetin.

3. Bashkëfinancim- financim i përbashkët i një programi apo ndërhyrjeje nga dy apo më shumë mbajtës buxhetor që kanë objektiva të ndryshëm sektorial për të arritur së bashku objektivat e tyre të veçanta në mënyrë më efikase.

4. Banor rezident - personi që jeton dhe vepron prej pesë (5) viteve në Komunën e Vushtrrisë, si dhe posedon dokumentacion valid të Republikës së Kosovës.

5. Person i jashtëm fizik – personi i cili nuk është banorë rezident i Komunës së Vushtrrisë, i cili posedon dokumentacion valid të Republikës së Kosovës

6. LMFP- Ligji për Menaxhimin e Financave Publike.

7. OJQ- Organizata jo qeveritare.

8. DKRS- Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport

9. DSHMS-Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.

**Neni 4**
**Ndarja e subvencioneve**

1. Komuna e Vushtrrisë ndanë subvencione për personat fizik dhe juridik- OJQ pa thirrje publike sipas rastit, si dhe për personat juridik-OJQ përmes thirrjeve publike, bazuar në planifikimet vjetor të buxhetit komunal të miratuar dhe në Ligjin për Buxhetin vjetor, nga fondi për subvencione transfere.

2. Komuna e Vushtrrisë ndan subvencione në shumën mbi pesëqind (500) € përmes thirrjes publike për aplikim për persona juridikë - OJQ, dhe mbi bazën e kërkesave për personat fizikë dhe juridik- OJQ, konform dispozitave të kësaj rregulloreje.

3. Kryetari i komunës aprovon ndarjen e subvencioneve në këto shuma parashë:
    3.1.për persona juridikë - OJQ deri në pesëqind (500) €.
    3.2. për persona fizikë për ndihmë momentale, deri në dy mijë (2000) €

**Neni 5**
**Subvencionimi pa thirrjes publike**

1.Subvencione pa thirrjes publike mund të përfitojnë:
    1.1. personat juridikë - OJQ, deri në pesëqind (500) €;
    1.2. personat fizikë për ndihmë momentale për shërim, deri në dy mijë (2000) €;
    1.3. personat e jashtëm fizikë, deri në gjashtëqind (600) €;
    1.4. personat fizikë për ndihmë momentale për furnizim me gjëra ushqimore, strehim, rast vdekje dhe raste tjera nga fusha sociale, deri dyqind (200) €;
    1.5. personat fizik për ndihmë, në rast të fatkeqësive natyrore dhe raste të ngjashme deri njëmijë (1000) €.

## Neni 6
## Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim

1. Personi juridik - OJQ për të parashtruar kërkesë për subvencionim, duhet ta dorëzojnë këtë dokumentacion:
   1.1. kërkesën me shkrim;
   1.2. dorëzimin e raportit për vitin paraprak, në rast të subvencionimit të mëhershëm;
   1.3. certifikatën e regjistrimit;
   1.4. arsyetimin e kërkesës;
   1.5. dokumentin identifikues të përfaqësuesit ligjor të personit juridik;
   1.6. numrin e llogarisë bankare të personit juridik.

2. personi fizik duhet t'i plotësojë kriteret si në vijim:
   2.1. kërkesa e adresuar në emër të personit fizik përmes arkivës;
   2.2. dëshmi që arsyeton kërkesën, raport mjekësore specialistike që konstatojnë sëmundjen;
   2.3. dëshmi e shpenzimeve mjekësore apo shpenzimeve të terapisë;
   2.4. rekomandim nga komisioni i ekspertëve i drejtorisë përkatëse bashkë me raportet mjekësore dhe diagnozën e personit;
   2.5. dëshmi mbi gjendjen e rëndë sociale të personit fizik, i verifikuar nga komisioni i drejtorisë përkatëse;

## Neni 7
## Subvencionimi përmes thirrjeve publike

1. Në procedurë të thirrjes publike, Komuna e Vushtrrisë subvencion me mjete financiare mbi vlerën 500 € për personat juridik - OJQ që ofrojnë projekte të vlerësuara nga komisioni vlerësues.

2. Komuna e Vushtrrisë përmes drejtorisë përkatëse sipas planifikimit buxhetor, çdo vit fiskal shpall thirrje publike për ndarje të subvencioneve për presona juridik-OJQ për ndarje të subvencioneve, duke përcaktuar qartë fushat e subvencionimit, kriteret, dokumentet e nevojshme për aplikim dhe informata tjera me rëndësi sipas kësaj rregulloreje.

3. Parime të subvencionimit të personave juridikë-OJQ, janë:
   3.1. konkurrenca;
   3.2. barazia para ligjit;
   3.3. transparenca;
   3.4. mos-diskriminimi;
   3.5. e drejta e ankesës;
   3.6. shmangja e konfliktit të interesit.

## Neni 8
## Planifikimi për mbështetje financiare për persona juridik - OJQ

1. Komuna e Vushtrrisë (drejtoritë përkatëse), si ofrues i mbështetjes financiare:
   1.1. planifikon mbështetje financiare në kuadër të buxhetit vjetor;

1.2. përgatit pjesën e planit vjetor të mbështetjes financiare për personat juridikë - OJQ-të më së largu tridhjetë (30) ditë pas miratimit të buxhetit vjetor të Republikës së Kosovës.

2. Plani vjetor i mbështetjes financiare për personat juridikë - OJQ-të përmban:
   2.1. informatën për organizatën buxhetore;"
   2.2. shumën e mbështetjes buxhetore për vitin fiskal;
   2.3. fushat në të cilat do të ofrohet mbështetja financiare për personat juridikë — OJQ-të;
   2.4. objektivat e mbështetjes financiare;
   2.5. numrin e përafërt të organizatave që do të përfitojnë;
   2.6. kohën e hapjes të thirrjes për aplikim, dhe
   2.7. kohën e përafërt të fillimit të zbatimit të projekteve/programeve përfituese.

3. Komuna e Vushtrrisë (drejtoritë përkatëse), si ofrues i mbështetjes financiare duhet:
   3.1. të publikojë në ueb faqen e vetë zyrtare, pjesën e planit vjetor të mbështetjes financiare për personat juridikë - OJQ-të, më së largu pas dyzet e pesë (45) ditëve pas miratimit të buxhetit të Republikës së Kosovës;
   3.2. të themelojë komisionin vlerësues, i cili do të merret me vlerësimin e aplikimeve sipas thirrjes publike, dhe të bëjë përzgjedhjen e përfituesve;
   3.3. të themelojë Komisionin e ankesave, i cili do të merret me trajtimin e ankesave eventuale të aplikantëve;
   3.4. të emërojë zyrtarin përgjegjës apo të themelojë ekip të veçantë për secilën kontratë të lidhur me persona juridikë - OJQ-të përfituese, me qëllim të monitorimit të zbatimit të projektit/programit si dhe vlerësimit të përmbushjes së objektivave dhe arritjes së rezultateve të parapara;
   3.5. të sigurojë përkrahjen e nevojshme për komisionin vlerësues, komisionin e ankesave dhe zyrtarin apo ekipin për monitorimin e zbatimit të kontratës, duke siguruar burimet e nevojshme financiare dhe administrative për zbatimin e suksesshëm të thirrjes publike dhe për monitorimin dhe vlerësimin e mbështetjes financiare.

**Neni 9**
**Kushtet specifike**

1. Në mënyrë që aplikacioni të konsiderohet i kompletuar, aplikuesi duhet t'i plotëson kushtet specifike konform nenit 11 të Rregullores MF — Nr — 04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve.

**Neni 10**
**Kriteret dhe procedurat e thirrjes publike dhe aplikimit**

1.Kriteret dhe procedurat e thirrjes publike, aplikimit, si dhe vlerësimit të aplikacioneve duhet të janë konform neneve 12, 13, 14, 15, 16, 17 dhe 18 të Rregullores së Ministrisë së Financave -Nr. -04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve.

**Neni 11**
**Shpallja e thirrjes publike për subvencione të personave juridik - OJQ**

1.Drejtoria përkatëse i zhvillon procedurat për shpallje të thirrjes publike, pas nxjerrjes së vendimit nga kryetari i komunës në të cilin përcaktohet lartësia e shumes së mjeteve financiare që do të ndahen përmes thirrjes publike për vitin fiskal, në harmoni me dispozitat e kësaj rregulloreje.

2. Në Thirrje publike shënohet data e hapjes dhe mbylljes së thirrjes, dokumentet e nevojshme të kandidatëve për aplikim si dhe çështje tjera konform dispozitave të Rregullores së MF - Nr. - 04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve.

**Neni 12**
**Subvencionimi nga fusha e rinisë, kulturës dhe sportit**

1. Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sporte ndanë subvencione për persona fizikë të jashtëm dhe persona juridikë-OJQ për projekte-ide me karakter. profesional, promovues, stimulues, tradicional, inovativ, kritik, praktik, ku përfshihen:
  1.1. aktivitetet kulturore;
  1.2. aktivitetet rinore, dhe
  1.3. aktivitetet sportive.

**Neni 13**
**Dokumentacioni për parashtrimin e kërkesave**

1. Dokumentet të cilat duhet të dorëzohen gjatë parashtrimit të kërkesave për ndarje të subvencioneve janë:
  1.1. projekt-propozimi;
  1.2. formulari;
  1.3. dokumenti identifikues;
  1.4. certifikata e vendbanimit (për persona fizikë);
  1.5. certifikata e regjistrimit (për persona juridikë);
  1.6. dëshmi për pagesën e taksave komunale;
  1.7. dëshmi për pagesën e tatimit në pronë;
  1.8. dëshmi se nuk ka obligime ndaj ATK-së (për persona juridikë), dhe
  1.9. konfirmimin nga banka për xhirollogarinë e parashtruesit të kërkesës.

**Neni 14**
**Kriteret për kualifikim**

1. Kritere për kualifikim për mbështetje financiare në vlerën mbi pesëqind (500) € për personat juridik-OJQ janë:
  1.1. të jetë i regjistruar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi për lirinë e asociimit në organizatën joqeveritare në Republikën e Kosovës, apo në shtetin ku është e koncentruar diaspora;

1.2. të jenë të pajisura me numër fiskal sipas kërkesave të legjislacionit tatimor të Republikës së Kosovës, përkatësisht dokumentacionit ekuivalent sipas legjislacionit të shtetit përkatës për OJQ-në e huaj;
1.3. të kenë të kryer të gjitha detyrimet nga mbështetja financiare paraprake, nëse kanë përfituar nga burimet publike të financimit;
1.4. të mos kenë pranuar mjete tjera nga burime tjera të financimit për të njëjtat aktivitete, dhe;
1.5. të mos ekzistojë ndonjë konflikt interesi në mes të aplikuesit, përkatësisht përfaqësuesve/udhëheqësit të aplikuesit dhe organizatës buxhetore apo institucionit publik, siç parashihet me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës.

2. Parashtruesit e kërkesave për subvencione në cilësinë e personave juridikë që aplikojnë në vlerën deri në pesëqind (500) € duhet t'i plotësojnë kriteret e përmendura në nën-paragrafët e paragrafit 1 të këtij neni.

## Neni 15
## Rastet specifike për zgjedhjen e përfituesve

1. Gjatë ndarjes së subvencioneve, në kushte të barabarta, iu jepet përparësi rasteve specifike në vijim:"
projektet që kanë siguruar bashkëfinancim nga palët e treta sipas vlerës;
1.1. projektet të cilat mund të gjenerojnë të hyra financiare për kërkuesin e subvencionit, në funksion të sigurimit të qëndrueshmërisë së projektit për periudhën e ardhshme;
1.2. parashtruesve të kërkesave që nuk kanë fituar më parë subvencione nga komuna dhe gjatë vitit të njëjtë fiskal nuk kanë qenë përfitues i një subvencioni për kulturë, rini, sport të ndarë nga pushteti qendror ose nga ndonjë donator tjetër.

## Neni 16
## Komisionet vlerësuese

1. Komuna e Vushtrrisë, si ofrues i mbështetjes financiare që ka shpallur thirrje publike për mbështetje financiare në vlerë mbi pesëqind (500) €, themelon komisionin vlerësues, i përbërë nga anëtarët që kanë përvojë dhe integritet, me mandat për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve."

## Neni 17
## Komisioni për ndarje të subvencioneve për kulturë, rini dhe sport

1. Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport (DKRS) formon Komisionin vlerësues tre (3) anëtarësh, me mandat dy (2) vjeçar për ndarje të mjeteve financiare për persona juridikë - OJQ-të në vlerë deri në pesëqind (500) e, si dhe personave fizikë për realizimin e aktiviteteve të ndryshime kulturore, rinore dhe sportive në vlerë deri në gjashtëqind (600) €.

**Neni 18**
**Komisioni për ndarje të subvencioneve për shëndetësi dhe mirëqenie sociale**

1. Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale (DSHPS) formon komisionin vlerësues tre (3) anëtarësh, me mandat dy (2) vjeçar për ndarje të mjeteve financiare për persona fizikë deri në treqind (300) € si ndihmë momentale për shërim, furnizim me gjëra ushqimore, banim, lëndë djegëse, pagesë të energjisë elektrike dhe nevoja tjera sociale.

**Neni 19**
**Komisioni për ndarje të subvencioneve përmes shpalljeve publike**

1. Kryetari i komunës nxjerr vendim për themelimin e komisionit pesë (5) anëtarësh me mandat dy vjeçar, për vlerësim dhe ndarje të subvencioneve përmes thirrjes publike.

2. Përbërja e komisionit është si vijon:
   2.1. një (1) anëtar nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport;
   2.2. dy (2) anëtarë nga grupi i ekspertëve të jashtëm, njëri nga të cilët duhet të jetë përfaqësues i OJQ-ve, të cilët do të zgjidhen përmes një thirrjeje publike, të cilën do ta bëjë ofruesi i mbështetjes financiare;
   2.3. dy (2) anëtarë nga institucione (Drejtoria për Buxhet dhe Finance) që ofron mbështetje financiare, njëri nga të cilët duhet të jetë nga njësia përkatëse për buxhet dhe financa.

3. Përveç anëtarëve të rregullt të komisionit vlerësues, kryetari i komunës emron me vendim edhe një (1) anëtar rezervë, i cili do të zëvendësojë në rast nevoje njërin nga anëtarët anëtarin e komisionit.

4. Komisioni vlerësues themelohet gjatë kohës sa thirrja publike është e hapur dhe emrat e anëtarëve të Komisionit vlerësues bëhen publik brenda shtatë (7) ditëve pas themelimit të komisionit.

5. Komisioni vlerësues në mbledhjen e tij të parë miraton rregullat e punës, përmes të cilave do të udhëhiqet puna në komision dhe këto rregulla bëhen publike brenda shtatë (7) ditëve pas miratimit.

6. Anëtarët e komisionit vlerësues nuk mund të jenë të emëruarit politik.

7. Me vendim të veçantë të kryetarit të komunës do të përcaktohet mënyra dhe shuma e kompensimit për dy (2) anëtarë e Komisionit vlerësues nga grupi i ekspertëve të jashtëm.

8. Kërkesat për ndarjen e subvencioneve nga nenet 11,12, përkatësisht komisioni vlerësues i DSHPS-së, gjegjësisht DKRS-së, të cilët ia rekomandojnë Kryetarit të Komunës rastet e përzgjedhura për përfitim financiar.

9. Përbërjen e Komisionin vlerësues të DSHPS-së dhe DKRS-së drejtorët e drejtorive përkatëse ia propozojnë për aprovim Kryetarit të Komunës."

10. Drejtori i DSHPS-së përmes komisionit vlerësues propozon mjete financiare në vlerë deri treqind (300)€ shërim, furnizim me gjëra ushqimore, banim, lëndë djegëse, pagesë të energjisë elektrike dhe nevoja tjera sociale.

11. Për ndarjen e shumave mbi treqind (300)€ deri në dymijë (2.000)€, pas shqyrtimit, Komisioni vlerësues i DSHPS-së i rekomandon për aprovim Kryetarit të Komunës.

12. Drejtoresha i/e DKRS-së propozon mjete financiare për aktiviteteve të ndryshme kulturore, rinore dhe sportive në vlerë deri në treqind (300) € pas shqyrtimit të kërkesave dhe rekomandimit nga Komisioni vlerësues i DKRS-së.

13. Për ndarjen e shumave mbi treqind (300) € deri në gjashtëqind (600) € për personat fizikë (të jashtëm), pas shqyrtimit nga Komisioni vlerësues i DKRS-së i rekomandohen për aprovim Kryetarit të Komunës.

**Neni 20**
**Komisioni i Ankesave**

1. Kryetari i komunës nxjerrë vendim për emërimin e:
   1.1. komisionit të ankesave tre anëtarësh, me mandat dy vjeçar, për shqyrtimin e ankesave;
   1.2. një anëtari rezervë që do të zëvendësonte njërin nga anëtarët e komisionit të ankesave.

2. Anëtarët e emëruar të komisionit të ankesave janë nga radhët e zyrtarëve të administratës së komunës (me përvojë), nga të cilët një jurist, një zyrtar nga Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport, dhe i treti nda Drejtoria e Financave.

3 Komisioni është autoritet vendimmarrës, përfundimtarë i çështjes, ndërsa vendimet i merr me shumicën e votave të anëtarëve.

**Neni 21**
**Afatet dhe procedurat e paraqitjes dhe shqyrtimit të ankesave**

1. Kundër vendimit të Komisionit vlerësues, aplikantët mund të ushtrojnë ankesë në Komisionin e ankesave, st në vijim:
   1.1. ankesë ndaj vendimit për diskualifikim për shkak të mospërmbushjes së kritereve formale gjatë vlerësimit të aplikacionit në aspektin procedural, dhe;
   1.2. ankesë ndaj vendimit për ofrimin apo mos ofrimin e mbështetjes financiare.

2. Ankesat i drejtohen komisionit të ankesave brenda pesë (5) ditët nga dita e publikimit të vendimit.

3. Komisioni i ankesave vendos mbi ankesën brenda pesë (5) ditësh nga dita e pranimit të saj.

4. Komisioni i ankesave nxjerr vendim për të pranuar ose refuzuar ankesën.

5.Vendimi i Komisionit të ankesave është vendim përfundimtar në procedurën administrative.

6. Vendimi duhet t'i dërgohet parashtruesit të ankesës dhe komisionit vlerësues.

7. Komisioni i ankesave mban procesverbal për gjithë procesin e trajtimit të ankesave dhe vendimmarrjes.

**Neni 22**
**Kontrata me përfituesin dhe metodologjia e monitorimit dhe raportimit**

1. Mënyra e hartimit të kontratës me përfituesin dhe metodologjia e monitorimit dhe raportimit duhet të bëhen konform neneve 22 dhe 23 të Rregullores të Ministrisë së Financav - Nr. - 04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve.

**Neni 23**
**Subvencionimi për pagesën e qirave në raste të rënda sociale (familjeve të pa strehë) dhe përfituesit e të drejtës për pagesën e qirasë**

1. Kryetari i Komunës i propozon Kuvendit të Komunës planifikimin buxhetor për pagesën e qirave për familjet në nevojë përmes aprovimit vjetor të buxhetit.

2. Komuna ka të drejtën e pagesës së qirave për familjet apo individët e Komunës së Vushtirisë që nuk e kanë të zgjidhur çështjen e banimit për shkak të gjendjes së rëndë ekonomike.

3. Numri i familjeve përfituese nga kjo kategori përcaktohet në pajtim me ndarjen buxhetore sipas paragrafit 1 të këtij neni.
4. Të drejtën e subvencionimit e kanë banorët rezident të Komunës së Vushtrrisë, të pa strehë.

5. Qiraja e subvencionuar nga buxheti i komunës nuk mund të kalojë shumën prej dyqind (200) €, për një (1) muaj."

**Neni 24**
**Kriteret për përcaktimin e radhës së përparësisë për subvencionimin e qirasë të familjeve në nevojë**

1. Kriteret për përcaktimin e radhës së përparësisë për sigurimin e banimit për personat (rastet) e paraqitura janë:
  1.1. statusi i banimit;

1.2. lartësia e të ardhurave;
1.3. gjendja shëndetësore;
1.4. invaliditeti, dhe
1.5. struktura e familjes.

## Neni 25
## Përparësitë për zgjedhjen e përfituesve

1. Përparësi në përzgjedhjen e përfituesve për subvencionim të qirasë kanë:
   1.1. familjet me shumë fëmijë;
   1.2. familjet që në përbërjen e tyre kanë persona me nevoja të veçanta;
   1.3. familjet kur kryefamiljari është grua — mbajtëse e familjes;
   1.4. bashkëshorti ose bashkëshortja e shkurorëzuar, që nuk ka në përkujdesje fëmijë, dhe;
   1.5. fëmijët me statusin e jetimit.

## Neni 26
## Afati për pagesën e qirasë së banimit

1. Pas aprovimit të propozimeve nga Kryetari i komunës, drejtori i DSHPS-së lidh kontratë me pronarin e banimit ku përfitues është familja apo individi që i plotëson kriteret sipas kësaj rregulloreje.

2. Pagesa e qirasë së banimit nuk mund të bëhet më tepër se për pesë (5) vite. Përjashtim nga ky rregull kanë rastet që pas afatit prej pesë (5) viteve, komisioni vlerëson se duhet të vazhdohet qiraja edhe për dy (2) vite tjera.

3. Kontrata lidhet në afat një (1) vjeçar me mundësi të vazhdimit konform afatit të paraparë në paragrafin 2 të këtij neni.

4. DSHPS-ja njofton përfituesin e subvencionit dhe qiradhënësin e qirasë së banimit së paku gjashtëdhjetë (60) ditë para përfundimit të afatit të kontratës së fundit për herën e pestë) se komuna nuk do të vazhdojë t'i paguajë qiranë e banimit dhe nuk do të lidhë kontratë të re të banimit.

## Neni 27
## Rastet e ndërprerjes së subvencionit të qira (shkëputja e kontratës së qirasë)"

1. Palës përfituese të subvencionimit të qirasë, i ndërpritet e drejta për pagesë (shkëputja e kontratës së qirasë) kur:
   1.1. qiramarrësi ka bërë deklarim të rrejshëm për të ardhurat;
   1.2. qiramarrësi ka përfituar një banesë tjetër dhe nuk e ka njoftuar organin kompetent të komunës;
   1.3. qiramarrësi ia lëshon banesën me qira palës së tretë;
   1.4. qiramarrësit i përmirësohet gjendja ekonomike, të cilin fakt e vlerëson në baza vjetore Komisioni Vlerësues i DSHPS-së;
   1.5. qiramarrësit i punësohet njëri nga anëtarët e familjes me pagë mbi minimale, dhe;

1.6. qiramarrësi i kalon pesë (5) vite nga momenti i lidhjes së kontratës, dhe komisioni nuk ka dilemë vlerësim pozitivë për vazhdimin e kontratës.

**Neni 28**
**Bashkëfinancimet**

1. Komuna mund të lidhë marrëveshje bashkëfinancimi me institucione qendrore, organizata dhe mekanizma tjerë vendorë dhe ndërkombëtarë (donatorë), përfshirë edhe persona fizikë për realizim të projekteve me interes publik për qytetarë (familje dhe individ) të Komunës së Vushtrrisë, të cilët janë në gjendje të rëndë ekonomike.

2. Kryetari i komunës vendos lidhur me marrëveshjet për bashkëfinancim për projektet në të cilat komuna merr pjesë deri në 49 % të vlerës së përgjithshme të projektit.

3. Kuvendi i komunës vendos lidhur me bashkëfinancimin për projektet në të cilat komuna merr pjesë 50 % e më tepër të vlerës së përgjithshme të projektit.

4. Kushtet dhe kriteret për përcaktimin e përfituesve të projekteve të tilla do të caktohen në marrëveshjen në mes të donatorit dhe Kryetarit të Komunës.

**Neni 29**
**Zbatimi dhe mbikëqyrja**

1. Për zbatimin e kësaj rregulloreje obligohen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport dhe njësitë tjera buxhetore të cilave me vendim të kuvendit iu ndahen mjete buxhetore nga fondi për transfere dhe subvencione.

**Neni 30**
**Dispozita shfuqizuese**

1. Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje, shfuqizohet Rregullorja KKV Nr. 01/2018, prot. Nr. 144/18 datë 31.05.2018 për Përcaktimin e Kritereve të Ndarjes së Mjeteve Financiare nga Fondi për Transfere dhe Subvencione Personave Juridik – OJQ dhe Ndihmë Momentale Personave Fizik.

2. Në rast se ka mospërputhje në mes të dispozitave të kësaj rregulloreje dhe Rregullores MF Nr. 04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ- ve, vlejnë dispozitat e kësaj të fundit.

**Neni 31**
**Hyrja në fuqi**

1.Kjo rregullore hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Melihate Basholli-Latifi
Kryesuese e Kuvendit

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Sheshi "Ahmet Krasniqi" nr. 10, Tel.038/200 42402, E-mail: ferit.idrizi@rks-gov.net

| | |
|---|---|
| PËR/ZA/TO: | KPF dhe Kuvendin e Komunës |
| CC | |
| PROPOZUES | |
| NGA/OD/FROM: | Ferit Idrizi<br>Kryetar i Komunës |
| | Draft - Rregullore |

---

Të nderuar/a anëtar/e të KPF dhe kuvendit,

Të bashkëngjitur keni Draft Rregulloren për Ndarjen e Bursave për Nxënës/Student dhe Shpërblimeve për Nxënës/Student të Komunës së Vushtrrisë.

Draft Rregullorja ju dërgohet për shqyrtim dhe miratim.

Me respekt,

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI
KUVENDI I KOMUNËS

# RREGULLORE
# PËR NDARJEN E BURSAVE PËR NXËNËS/STUDENTË, DHE SHPËRBLIMEVE PËR NXËNËS/STUDENT TË KOMUNËS SË VUSHTRRISË"

Vushtrri, Shkurt 2023

Bazuar në nenin 12, paragrafi 2 pika 'c", në lidhje me nenin 1.7 pika "s" të Ligjit Nr.03/1-40 për Vetëqeverisje Lokale, dhe nenit 19 paragrafi 1 pika 1.3 të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më _________ 2023 miraton këtë:

# RREGULLORE
# PËR NDARJEN E BURSAVE PËR NXËNËS, STUDENTË, DHE SHPËRBLIMEVE PËR NXËNËS, STUDENT TË KOMUNËS SË VUSHTRRISË

## DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

### Neni 1
### Qëllimi

1. Me këtë rregullore themelohet baza juridike për ndarjen e bursave dhe shpërblimeve për nxënës dhe studentë, banorë të Komunës së Vushtrrisë.

### Neni 2
### Fushëveprimi

1. Kjo rregullore përcakton raportet juridike të ndarjes së bursave dhe shpërblimeve në mes të nxënësve, studentëve të komunës së Vushtrrisë.

### Neni 3
### Përkufizimet

Përkufizimet në këtë rregullore kanë këtë kuptim:
1. Bursë- është pagesë pa kthim e parave që jepet për të mbështetur arsimimin e nxënësve dhe studentëve në bazë të arritjeve të tyre mësimore dhe akademike.

2. Shpërblim- është pagesë pa kthim e parave që jepet nxënësit dhe studentit i cili ka arritur rezultate të larta në fushën e dijës, shkencës, gara komunale, regjionale dhe ndërkombëtare.

3. Nxënës- një person i cili i ndjek mësimet e institucione arsimore të arsimit para-universitar ( fillor, i mesëm i ultë, i mesëm i lartë).

4. Student- është një person i cili studion në një institucion të arsimit të lartë, kolegj apo universitet.

## Neni 4
## Bursat

1. Bursa u jepen nxënësve të arsimit para universitar për një vit shkollor, si dhe studentëve për një vit akademik të studimeve.

2. Përfitues të bursave janë nxënësit, si dhe studentët e nivelit bachelor, mastar dhe PhD, banorë të Komunës së Vushtrrisë, që studiojnë brenda dhe jashtë vendit.

3. Bursa mund të përfitojnë vetëm studentët që nuk janë përfitues të bursës apo pagës nga institucione tjera që financohen nga buxheti i Kosovës.

4. Drejtoria përkatëse i propozon Kryetarit të Komunës numrin bursave për nxënës/studentë, shumën e parave për një bursë, profilet arsimore dhe fushat e studimit për të cilat ndahen bursat, sipas planifikimit buxhetor.

5. Për fillimin e vitit shkollor/akademik të dhënies së bursës, vendosë drejtoria perkatëse, por jo më vonë se në vitin e dytë shkollor apo të studimeve.

## Neni 5
## Shpallja e konkursit për bursa

Drejtoria përkatëse i zhvillon procedurat për shpallje të konkursit për bursa, pas nxjerrjes së vendimit nga kryetari i komunës, në harmoni dispozitat e kësaj rregulloreje.

## Neni 6
## Kriteret vlerësuese për ndarje të bursave

1. Kriter për vlerësim të ndarjes së bursave merret nota mesatare, me përparësi nga nota më e lartë.

2. Në kushte të njëjta të notës mesatare, përparësi u jepet nxënësve dhe studentëve me gjendje të rëndë sociale që janë:

   2.1. fëmijë të dëshmorëve;
   2.2. fëmijë të martirëve;
   2.3. fëmijë të invalidëve;
   2.4. fëmijë të veteranëve;
   2.5. fëmijë të ish të burgosurve politik;
   2.6. fëmijë të familjeve me asistencë sociale.

## Neni 7
## Dokumentet e nevojshme për konkurrim

1. Dokumente të nevojshme që kërkohen për të garuar për bursë janë:

1.1. dëshmia e regjistrimit të klasës/vitit të studimeve me certifikatën e provimeve;
1.2. dëshmia se është banor i Komunës së Vushtrrisë;
1.3. dëshmia se nuk merr bursë apo pagë nga buxheti i Kosovës;
1.4. dëshmia se është fëmijë i dëshmorit, martirit, invalidit të Luftës të UÇK-së, veteranit të Luftës së UÇK-së, ish të burgosurit politik, dhe se është nga familja me gjendje të rëndë ekonomike-sociale.

**Neni 8**
**Komisioni për ndarjen e bursave**

1. Kryetari i Komunës nxjerrë vendim për emërimin e komisionit 3 anëtarësh për ndarje të bursave.

2. Kryetari dhe një anëtar i komisionit duhet të jenë zyrtarë nga Drejtoria Komunale e Arsimit, ndërsa anëtari i tretë një jurist me përvoje nga administrata e komunës.

**Neni 9**
**Detyrat e komisionit**

1. Komisioni mblidhet me ftesën e kryetarit të komisionit, më së largu 5 ditë nga mbyllja e konkursit.

2. Kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e kërkuara sipas konkursit, eliminohen nga gara.

3. Përzgjedhja e kandidatëve bëhet sipas dispozitave të kësaj rregulloreje.

4. Pas përfundimit të përzgjedhjes, jo më larg se 5 ditë nga dita e mbledhjes, komisioni i publikon rezultatet në tabelën e publikimeve, në web- faqen të Komunës.

**Neni 10**
**Komisioni i ankesave**

1. Kryetari i komunës nxjerrë vendim për emërimin e komisionit ad-hoc tre anëtarësh me mandat një vjeçar (për vitin shkollor/akademik) për shqyrtimin e ankesave, i cili vendim publikohet të web-page të Komunës dhe në tabelë të shpalljeve.

2. Anëtarët e emëruar të komisionit janë nga radhët e zyrtarëve të administratës së komunës (me përvojë), nga të cilët një jurist, një zyrtar nga Drejtoria Komunale e Arsimit, dhe i treti po ashtu nga administrata.

3.Anëtarë të komisionit të ankesave, nuk mund të jenë anëtarët e komisionit që kanë marrë pjesë në ndarjen e bursave.

4. Komisioni është autoritet vendimmarrës, përfundimtarë i çështjes, ndërsa vendimet i merr me shumicën e votave të anëtarëve.

5. Vendimet në emër të komisionit i nënshkruan kryetari i komisionit në katër fleta origjinale, të cilat iu dërgohen nga një; kryetarit të komunës, komisionit për ndarje të bursave, palës që është ankuar dhe arkivit të komunës.

**Neni 11**
**Procedurat e ankesave**

1. Afati për ankesa është 8 ditë nga dita e shpalljes së rezultateve për përfitues të bursave.

2. Çdo kandidat i pa kënaqur me rezultatin e komisionit për ndarje të bursave, gëzon të drejtën e ankesës pranë komisionit të ankesave, sipas pikës 1 të këtij neni.

3. Pas kalimit të afatit për ankesa, Drejtori i Arsimit i nënshkruan kontratën me ta.

**Neni 12**
**Obligimet kontraktuare**

1. Kontrata nuk e obligon komunën t'i punësojë përfituesit e bursave pas mbarimit të shkollimit-studimeve të tyre.

2. kontrata nuk obligon përfituesit e bursave t'i kthejnë paratë Komunës së Vushtrrisë.

3. Kontrata obligon përfituesit e bursave t'i përgjigjen DKA-së, sa herë që DKA-ja kërkon dokumente që përcjellin nivelin, vijueshmërinë dhe cilësinë e mësimeve-studimeve.

**Neni 13**
**Shpërblimet**

1. Përfitues të shpërblimeve janë: nxënësit të cilët arrijnë rezultate të larta në fushën e dijës, teste të arritshmërisë, test të maturës, si dhe gara të ndryshme që i organizon Drejtoria Komunale e Arsimit.

2. Nxënësit dhe studentët të cilët arrijnë rezultate në gara regjionale dhe ndërkombëtar

**Neni 14**
**Shpërblimet e nxënësve dhe studentëve**

1. Shpërblime u jepen nxënësve të cilët tregojnë rezultate të larta në mësime, teste të arritshmërisë, maturës, gara komunale dhe ndërkombëtare, si dhe studentëve të cilët tregojnë rezultate në gara ndërkombëtare.

2. Drejtoria Komunale e Arsimit, cakton lëndët garuese, klasat, kohën dhe vendin e mbajtjes së garave, si dhe ekipin komunal të mësimdhënësve, i cili i përgatit dhe i udhëheq garat komunale.

3. Nxënësi i cili në gara individuale si dhe në ekip zë njërin nga tri vendet e para (vendi i parë, vendi i dytë dhe vendi i tretë) Për tri vendet e para (vendi i parë, vendi i dytë dhe vendi i tretë), nderohet me mirënjohje, dhe shpërblim me një shumë motivuese të parave që e cakton Kryetari i Komunës.

4. Nxënësi me arritje të larta në mësime në nivel komune, (nxënësi më i suksesshëm në komunë) nderohet me mirënjohje, si dhe shpërblehet me një shumë motivuese të parave që i cakton Kryetari i komunës, ose me disa ditë pushim në bregdet / turizëm malorë.

5. Drejtoria Komunale e Arsimit siguron transportin, ushqimin dhe pijet për nxënësit dhe mësimdhënësit të cilët marrin pjesë në gara.

**Neni 15**
**Garat e shkathtësive**

1. Garat komunale të shkathtësive në sport, muzikë, art dhe fusha të tjera mund të organizohen nga Komuna sipas planit të punës të Drejtorisë Komunale të Arsimit.

2. Shpërblimet për gara të shkathtësive janë si në nenin 14 pika 3 dhe 4. të kësaj rregulloreje.

**Neni 16**
**Dispozitat kalimtare dhe shfuqizuese**

1. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje shfuqizohet Rregullorja për Ndarjen e Bursave dhe Shpërblimeve për Nxënës të Komunës së Vushtrrisë, 01 Nr. 95/20, datë 28.05.2020.

**Neni 17**
**Hyrja në fuqi**

1. Kjo rregullore hyn në fuqi pesëmbëdhjete (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal. si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Melihate Basholli-Latifi
Kryesuese e Kuvendit

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPŠTINA VUČITRN
Nr./Br. 112/23
Nr. i lig. / Br. al
Data / Datum 06.02.2023
VUSHTRRI - VUČITRN

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Sheshi "Ahmet Krasniqi" nr. 10. Tel.038/200 42402. E-mail: ferit.idrizi@rks-gov.net

| | |
|---|---|
| PËR/ZA/TO: | KPF dhe Kuvendin e Komunës |
| CC | |
| NGA/OD/FROM: | Ferit Idrizi,<br>Kryetar i Komunës |
| TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT: | Draft Rregullore |

---

Të nderuar/a anëtar/e të KPF dhe kuvendit,

Të bashkëngjitur keni Draft Rregulloren për Fillimin dhe Mbarimin e Orarit të Punës së Veprimtarive Afariste – Bizneseve në Komunën e Vushtrrisë.

Draft Rregullorja ju dërgohet për shqyrtim dhe miratim.

Me respekt,

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI
KUVENDI I KOMUNËS

**DRAFT - RREGULLORE**

**PËR FILLIMIN DHE MBARIMIN E ORARIT TË PUNËS TË VEPRIMTARIVE AFARISTE – BIZNESEVE NË KOMUNËN E VUSHTRRISË**

Vushtrri, Shkurt, 2023

Në bazë të nenit 1 2, paragrafi 12.2, shkronja (c) dhe nenit 40 paragrafi 40.3 të Ligjit Nr,03/L-40 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 40 të Ligjit Nr.2004/ 18 për Tregtinë e Brendshme, dhe nenin dispozitave të nenit 19, paragrafi 1, pika 1.3 të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më ________ 2022 miratoi këtë:

# DRAFT RREGULLORE PËR FILLIMIN DHE MBARIMIN E ORARIT TË PUNËS TË VEPRIMTARIVE AFARISTE - BIZNESEVE NË KOMUNËN E VUSHTRRISË

## Neni 1
## Qëllimi

1. Me këtë rregullore themelohet baza juridike për rregullimin e orarit të punës për veprimtaritë afariste biznesore në territorin e Komunës së Vushtrrisë.

## Neni 2
## Fushëveprimi

Veprimtaritë afariste - bizneset në pajtim me nenin 1 të kësaj rregulloreje, janë të obliguara t'i përmbahen orarit të punës, të përcaktuar me këtë rregullore.

## Neni 3
## Orari i punës

1. Orari i punës nënkupton periudhën kohore të fillimit dhe mbarimit të punës.
2. Orari për fillimin dhe mbarimin e punës, i përcaktuar me këtë rregullore, duhet të vendoset në hyrje apo në vend të dukshëm të objektit në të cilin kryhet veprimtaria afariste – biznesi dhe duhet saktësuar fillimi dhe mbarimi i orarit të punës, dhe ditët që nuk punohet.

3. Orari i punës përcaktohet në bazë të dy periudhave, në atë verore dhe dimërore, në këto intervale kohore:
3.1 Periudha verore fillon më 1 prill dhe zgjat deri më 31 tetor të vitit kalendarik;
3.2 Periudha dimërore fillon më 1 nëntor dhe zgjat deri me 31 mars të vitit kalendarik.

## Neni 4
## Orari i punës për dyqane zejtare dhe veprimtari të ngjashme

4.1. Furrat e bukës dhe pastiqeritë:
4.1.1 Periudha verore prej orës 06:00 – 23:00;
4.1.2 Periudha dimërore prej orës 07:00 – 22:00.
4.1.3 Ditëve të diela do të punojnë deri në ora 12:00.

4.2 Furrat e bukës gjatë muajit të Ramazanit mund të punojnë pa ndërprerë 24 orë.

4.3. Autoserviset, autolarjet dhe vullkanizerët:

4.3.1 Periudha verore prej orës 08:00 – 19:00;
4.3.2 Periudha dimërore prej orës 09:00 – 18:00.

4.4. Rrobaqepësit, këpucëtarët, serviserët dhe orëtarët:
4.4.1 Periudha verore prej orës 08:00 – 20:00;
4.4.2 Periudha dimërore prej orës 08:00 – 18:00.

4.5 Sallonet e ondulimit:
4.5.1 Periudha verore prej orës 06:00 – 20:00;
4.5.2. Periudha dimërore prej orës 08:00 – 19:00

4.6. Frizerët:
4.6.1 Periudha verore prej orës 08:00 – 20:00;
4.6.2 Periudha dimërore prej orës 08:00 – 19:00

4.7. Salduesit, teneqepunuesit, farkëtarët dhe dyqanet tjera zejtare:
4.7.1 Periudha verore prej orës 08:00 – 19:00;
4.7.2 Periudha dimërore prej orës 08:00 – 18:00.

4.8. Ditën e vikendit (e diel) dhe ditët e festave zyrtare, dyqanet zejtare nuk do të punojnë, në përjashtim të veprimtarive zejtare neni 4, paragrafi 4.5. që do të caktojnë një ditë pushimi brenda javës - ditëve të diela ose të martave.

**Neni 5**
**Orari i punës i qendrave tregtare, marketeve, dyqaneve tregtare ushqimore, pijeve, duhanit si dhe tregtia e çdo veprimtarie tjetër të artikujve joushqimor**

5.1. Qendrat tregtare, marketet, dyqanet tregtare ushqimore, të pijeve dhe duhanit:
5.1.1 Në periudhën verore prej orës 07:00 – 22:00;
5.1.2 Në periudhën dimërore prej orës 08:00 – 21:00.

5.2. Tregtia e veprimtarive të artikujve joushqimor:
5.2.1 Periudha verore prej orës 08:00 - 22:00;
5.2.2 Periudha dimërore prej orës 08:00 - 21:00.

5.3. Autosallonet dhe autopjesët e automjeteve të përdorura:
5.3.1 Periudha verore prej orës 08:00 - 20:00;
5.3.2 Periudha dimërore prej orës 08:00 - 18:00.

5.4. Ditën e vikendit (e diel) dhe festave zyrtare bizneset nga neni 5, nuk punojnë.

**Neni 6**
**Orari i punës i depove**

6.1. Depot e të gjitha llojeve të veprimtarive afariste:
6.1.1 Periudha verore prej orës 08:00 - 18:00;

6.1.2 Periudha dimërore prej orës 08:00 - 17:00.

6.2. Ditën e vikendit (e diel) dhe ditëve të festave zyrtare, bizneset nga neni 6, nuk punojnë.

**Neni 7**
**Akomodimi, shërbimet ushqimore dhe të pijeve**

7.1 Restaurantet, veprimtaritë shërbyese të pijeve, qebaptoret, gjellëtoret, fast food, veprimtaritë lëvizëse të ushqimit dhe veprimtaritë e ngjashme:
7.1.1 Në periudhën verore prej orës 07:00 - 00:00;
7.1.2 Në periudhën dimërore prej orës 07:00 - 23:00.

7.2. Akomodimi në hotele dhe motele është i njëjtë në të dy sezonat 24 orë - (non stop).

7.3. Diskotekat dhe klubet e natës:
7.3.1 Në periudhën verore prej orës 22:00 - 04:00;
7.3.2 Në periudhën dimërore prej orës 21:00 - 03:00.

7.4 Veprimtaritë afariste — bizneset që organizojnë muzikë live, evente të ndryshme dhe ahengje familjare, mund të punojnë më gjatë se orari i punës, por jo më shumë se ora 03:00 e mëngjesit.

7.5. Veprimtaritë afariste nga paragrafi 7.4 i këtij neni duhet kërkojnë leje të veçantë (24 orë më herët) për orare më të gjatë të punës (deri në ora 03.00 e mëngjesit) të cilën e lëshon Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillini Rural. Ppër vazhdimin e orarit të punës duhet paguar taksë shtesë tridhjetë (30.00) € për orë.

**Neni 8**

**Orari i punës për aktivitete sportive dhe rekreative, lojërat zbavitëse, internet-kafetë**

8.1 Stadiumet, palestrat sportive dhe objektet tjera rekreative, për të dy sezonat 08:00 - 00:00.

8.2. Lojërat zbavitëse dhe internet-kafetë:
8.2.1 Në periudhën verore prej orës 07:00 - 00:00;
8.2.2 Në periudhën dimërore prej orës 08:00 - 23:00.

8.3 Qendra trajnimi për aftësim praktik dhe teorik me armë për të dy sezonat 08:00 - 00:00.

**Neni 9**
**Orari i punës për qendrat e thirrjeve "Call Center"**

Bizneset që ushtrojnë veprimtari "Call Center" dhe veprimtari të ngjashme, orari i punës do të përshtatet me orarin e punës sipas orës së shteteve, të cilat kanë tjetër matje kohore.

**Neni 10**
**Orari i punës për tregje**

10.1 Tregjet e qytetit dhe tregjet e lokaliteteve:
10.1.1 Në periudhën verore prej orës 07:00 — 19:00;
10.1.2 Në periudhën dimërore prej orës 08:00 — 18:00.

10.2. Ditën e vikendit ( e diel) dhe ditëve të festave zyrtare, bizneset nga nenin 10, paragrafi 10.1, nuk punojnë.

10.3. Tregu i kafshëve punon vetëm ditën e premte, prej orës 07:00 - 15:00.

**Neni 11**
**Orari i punës për pikat e shitjes së karburanteve**

11.1. Pikat e shitjes së karburanteve punojnë për të dy sezonat 24 orë – non stop.

11.2 Restorantet dhe marketet e vogla deri 50 m2, si dhe veprimtaritë tjera afariste të cilat janë të ngjitura me pika të shitjes të karburanteve, përjashtimisht autolarjeve mund të punojnë për të dy sezonat 24 orë – NON – STOP.

**Neni 12**
**Orari i punës për barnatore, ordinanca dhe klinika private**

12.1. Barnatoret, ordinancat dhe klinikat private, punojnë për të dy sezonat prej orës 07:00 - 22:00, me përjashtim të ditëve te diela.

12.2. Barnatoret do të punojnë në harmoni me planin për kujdestari, të hartuar në bashkëpunim me Drejtorinë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale;
12.2.1. Barnatoret kujdestare punojnë gjatë ditëve të punës 22:00 deri në ora 07:00;
12.2.2 Barnatoret kujdestare gjatë ditëve të diela punojnë prej orës 07 :00 - 22:00;
12.2.3 Barnatoret kujdestare gjatë ditëve të diela pas orës 22:00 punojnë sipas orarit të përcaktuar në paragrafin 12.2.2.

**Neni 13**
**Orari i punës për ndërtimtari përfshirë renovimet e jashtme, të brendshme dhe infrastrukturën tokësore dhe nëntokësore**

13.1 Ndërtimtaria përfshirë renovimet e jashtme dhe të brendshme dhe infrastrukturën tokësore dhe nëntokësore:
13.1.1 Në periudhën verore prej orës 08:00 – 18 :00;
13.1.2 Në periudhën dimërore prej orës 08:00 – 17:00.

13.2 Ditën e vikendit (e diel) dhe ditëve të festave zyrtare, veprimtaritë nga neni 13, nuk punojnë.

**Neni 14**
**Orari i punës për barnatoret bujqësore, dyqanet me produkte bujqësore dhe ordinancat veterinare**

14.1 Barnatoret bujqësore, dyqanet me produkte bujqësore dhe ordinancat veterinare:
14.1.1 Në periudhën verore prej orës 08:00 – 19 :00;
14.1.2 Në periudhën dimërore prej orës 08:00 – 18:00.

14.2 Ditën e vikendit (e diel) dhe ditëve të festave zyrtare, veprimtaritë nga neni 14, nuk punojnë.

**Neni 15**
**Orari e punës për miniera dhe gurore**

15.1 Minierat dhe guroret:
15.1.1 Në periudhën verore prej orës 08:00 – 18 :00;
15.1.2 Në periudhën dimërore prej orës 08:00 – 16:00.

15.2 Ditën e vikendit (e diel) dhe ditëve të festave zyrtare, veprimtaritë nga neni 15, nuk punojnë.

**Neni 16**
**Orari i punës i veprimtarive financiare dhe të sigurimit**

16.1 Veprimtaritë financiare dhe të sigurimit:
16.1.1 Në periudhën verore prej orës 08:00 – 17 :00;
16.1.2 Në periudhën dimërore prej orës 08:00 – 16:00.

16.2 Ditët e vikendit (e shtunë dhe e diel) dhe ditëve të festave zyrtare, veprimtaritë nga neni 16, nuk punojnë.

**Neni 17**
**Orari i punës i veprimtarive të patundshmërisë**

17.1 Veprimtaritë e patundshmërisë:
17.1.1 Në periudhën verore prej orës 08:00 – 18 :00;
17.1.2 Në periudhën dimërore prej orës 08:00 – 17:00.

17.2 Ditën e vikendit (e diel) dhe ditëve të festave zyrtare, veprimtaritë nga neni 17, nuk punojnë.

**Neni 18**
**Orari i punës i veprimtarive profesionale, shkencore dhe teknike**

18.1 Veprimtaritë profesionale, shkencore dhe teknike:

18.1.1 Në periudhën verore prej orës 08:00 – 18 :00;
18.1.2 Në periudhën dimërore prej orës 08:00 – 17:00.

18.2 Ditën e vikendit (e diel) dhe ditëve të festave zyrtare, veprimtaritë nga neni 18, nuk punojnë.

**Neni 19**
**Orari i punës për shërbimet administrative dhe mbështetëse**

19.1 Shërbime administrative dhe mbështetëse:
19.1.1 Në periudhën verore prej orës 08:00 – 00 :00;
19.1.2 Në periudhën dimërore prej orës 08:00 – 23:00.

**Neni 20**
**Orari i punës i veprimtarive arsimore dhe edukimit joformal**

20.1. Veprimtaritë arsimore dhe edukimit joformal:
20.1.1 Në periudhën verore prej orës 07:00 – 21:00;
20.1.2 Në periudhën dimërorë prej orës 07:00 – 20:00.

20.2 Ditën e vikendit (e diel) dhe ditëve të festave zyrtare, veprimtaritë nga neni 19, nuk punojnë.

**Neni 21**

**Orari i punës për biznese përpunuese dhe prodhuese**

**21.1 Bizneset përpunuese dhe prodhuese**
**21.1.1** Në periudhën verore prej orës 08:00-20:00
21.1.2 Në periudhën dimërore prej orës 08:00-19:00
21.2 Bizneset përpunuese dhe prodhuese mund të punojnë 24 orë pa ndërpre nëse në ato biznese nuk mund të ndalet procesi i përpunimit dhe prodhimit.
21.3 Bizneset nga paragrafi 21.1 ditën e diel nuk do të punojnë përveç bizneseve nga paragrafi 21.2.

**Neni 22**
**Pezullimi i përkohshëm i dispozitave të kësaj rregulloreje**

Në rrethana të caktuara sipas vlerësimit të Kryetarit të komunës dhe rekomandimit nga faktorë tjerë institucionalë dhe qytetar, Kryetari i komunës mund të pezullojë përkohësisht zbatimin e dispozitave të caktuara të kësaj rregulloreje dhe përcaktoj me vendim orarin e përkohshëm brenda vitit kalendarik për veprimtari të caktuara biznesore.

## Neni 23
## Dispozitat ndëshkuese

Të gjitha veprimtaritë afariste - bizneset do të gjobiten nga 300.00 -1,000.00 €, në qoftë se veprojnë në kundërshtim me dispozitat e kësaj rregulloreje.

## Neni 24
## Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare

24.1 Për zbatimin e kësaj rregulloreje do të kujdeset: Drejtoria për Inspektime - inspektorati i tregut, Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, policia e Kosovës.

24.2 Të gjitha veprimtaritë afariste - bizneset janë të obliguara që të harmonizojnë orarin e punës me dispozitat e kësaj rregulloreje, në afatin prej tridhjetë (30) ditëve, nga dita e hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje.

24.3 Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, shfuqizohet Rregullorja KKV-Nr. 06/2020 datë 30.7.2020 për Fillimin dhe Mbarimin e Orarit të Punës të Veprimtarive Afariste - Bizneseve në Komunën e Vushtrrisë.

## Neni 25
## Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Melihate Basholli Latifi
Kryesuese e Kuvendit

**REPUBLIKA E KOSOVËS** **KOMUNA VUSHTRRI**

| | |
|---|---|
| **DATË/A:** | 6/2/2023 |
| **PËR/ZA/TO:** | KPF dhe Kuvendin Komunal |
| **PËRMES** | Ferit Idrizi, Kryetar i Komunës ____________ |
| **NGA:** | Abit Abiti, ZKF ____________ |
| **TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:** | Raport periodik. |

Bazuar në Nenin 15 të Rregullores së Punës për Zbatimin e Auditimit dhe Planeve të Veprimit Komuna e Vushtrrisë e ka hartuar Raportin për planin e veprimit dhe e ka dërguar në Zyrën Kombëtare të Auditimit, të njëjtin raport sipas Nenit të cekur më lartë e prezanton para Kuvendit.

Me respekt.

Shtojcë Raportet:

*Republika e Kosovës*
*Republika Kosovo*
*Republic of Kosovo*

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPŠTINA VUČITRN
02 Nr. / Br 1230/22
Nr. i fq. / Br. st
Data: / Datum 28.09.2022
VUSHTRRI - VUČITRN

*Komuna e Vushtrrisë*
*Opština Vučitrn*
*Municipality of Vushtrri*

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Nga: z. Ferit Idrizi, Kryetar i komunës së Vushtrrisë

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E VUSHTRRISË
OPŠTINA VUČITRN
REPUBLIKA KOSOVA

**RAPORT PERIODIK PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE**

**të dhëna në Raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit**

| Nr. | Komponenta e auditimit (kapitulli) | Gjetja | Rekomandimi | Veprimet e ndërmarrura dhe rezultatet konkrete në lidhje me zbatimin e rekomandimit | Statusi i rekomandimit (i zbatuar, pjesërisht i zbatuar ose i pa zbatuar) | Sfida e hasura në zbatimin e rekomandimit |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1. | **Çështja A1 - Shpalosje jo e saktë e vlerës së llogarive të arkëtueshme në PFV** | Sipas Rregullores së MF Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore, neni 16, citon që OB që mbledhin të hyra, janë të detyruara të mbajnë regjistra të të hyrave të mbledhura dhe shumat e faturuara e të pa arkëtuara. Të arkëtueshmet shpalosen në raportin vjetor financiar në tabelën përkatëse sipas llojit të hyrave.<br>• Bazuar në PFV dhe shënimeve për të arkëtueshmet kemi identifikuar se:<br>• Saldot e Ll.A për taksën për inkasimin e mbeturinave është nënvlerësuar për 158,692€; dhe<br>• Saldot e Ll.A nga shfrytëzimi i pronës publike janë nënvlerësuar për 40,598€.<br>Kjo ka ndodh pasi që zyrtarët përgjegjës për menaxhimin e Ll.A nga taksa | Kryetari duhet të sigurojë se zyrtarët përgjegjës mbajnë evidenca të sakta për Llogaritë e Arkëtueshme në mënyrë që prezantimi i tyre në Pasqyra Financiare Vjetore të jetë i saktë dhe i drejtë. | Nuk janë evidentuar veprime të ndërmarra gjatë kësaj periudhe. | I pa zbatuar | Menaxhimi i pronave komunale është bartur nga Drejtoria e Urbanizmit në Drejtorinë e Kadastrit ndërsa evidenca përkatësisht regjistri i pronave ka mbetur i pakompletuar.<br>Për kiosqet në pronësi të komunës është punuar një regjister excel, mirëpo është i pa kompletuar duke qenë se nuk përfshinë tokën, hapësirën publike etj në pronësi të komunës. Duke pasu një regjistër të plotë komuna do të ketë po |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | për inkasimin e mbeturinave, i kanë paraqit në PFV lirimet nga taksa për raste sociale të cilat i kanë zbrit nga sistemi manualisht, përderisa në sistemin që menaxhohet nga komuna, faturimi është evident. Kjo ka shkaktuar mospërputhje mes PFV dhe shënimeve të Komunës. Si dhe mosvendosja e mekanizmave adekuate për harmonizimin e regjistrave nga drejtoritë përkatëse me ZKF-në. | | | | ashtu vlerën e faturimit, pagesat, the borxhet e akumuluara.<br><br>E njëjta si më lartë kërkohet të ndërmerret për cështjen e mbledhjes së mbeturinave në Drejtorinë e Shërbimeve Publike.<br><br>Veprimi me prioritet: Të krijohet një grup në përbërie të drejtorive përkatëse që të krijojnë regjistrin e nevojshëm deri Dhjetor 2022. |
| 2. | Çështja A2 - Keqklasifikimi shpenzimeve | Ligji Nr. 07/L-041 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021, si dhe plani kontabël definojnë qartë se shpenzimet duhet të ndodhin nga kategoritë adekuate ekonomike. Gjithashtu UA Nr. 19/2009 për planin kontabël, neni 8.1 dhe 8.3 kanë përcaktuar qëllimin dhe strukturën e planit | Kryetari duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet që shpenzimet të planifikohen në ndarjet/kategoritë adekuate të buxhetit (apo të ridestinohen mjetet kur është e nevojshme dhe e mundshme), dhe që pagesa e regjistrimi i shpenzimeve të bëhet në mënyrë të drejtë dhe saktë | Janë ndërmarrë disa veprime:<br><br>Nga fillimi i vitit 2022 shpenzimet e varrimit janë duke u paguar prej kategorisë së subvencioneve (jo më nga mallrat dhe shërbimit)<br><br>Është anuluar pagesa për 5 laptopa për zyren e buxhetit në vlerë prej 4000 euro duke qenë se është vlerësuar si | Pjesërisht i zbatuar, ka gjetur zbatueshmëri në raste specifike, ndërsa duhet të aplikohet në vazhdimësi.<br><br>**Dëshmi pagesa e anuluar.** | Mbeten paqartësi dhe sfida në zbatimin e UA 08/2005, 04/2019 dhe 06/2019 të lidhura me klasifikimin ekonomik të shpenzimeve dhe shpenzimet që lidhen me projektet kapitale. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | kontabël, si dhe klasifikimin ekonomik të shpenzimeve të cilat duhen të bëhen sipas kodeve dhe kategorive të caktuara ekonomike. Në katër mostrat e testuara nga kategoria e Investimeve Kapitale në vlerë 94,601€, kemi identifikuar se janë keqklasifikuar shpenzimet për këtë kategori. Këto shpenzime janë paguar nga kategoria e Investimeve Kapitale, përderisa janë pajisje nën 1,000€ që i takojnë kategorisë Mallra dhe Shërbime. Në pesë mostrat tjera të testuara nga kategoria e Mallrave dhe Shërbimeve në vlerë 53,640€, kemi identifikuar se shpenzimet që janë paguar nga kategoria e Mallrave dhe Shërbime, për shpenzime të varrimit për qytetarët në bazë të Memorandumit të Mirëkuptimit, i takojnë kategorisë Subvencione dhe Transfere. Keqklasifikimi ka ndodh për shkak të planifikimit jo adekuat të shpenzimeve sipas kodeve ekonomike. | sipas kodeve ekonomike adekuate. | investim kapital, ndërsa ka qenë e planifikuar në mallra dhe shërbime. | | Mbeten sfida në zbatueshmërinë e rekomandimit, sidomos në pjesën e planifikimit të buxhetit, sipas kërkesave buxhetore që pranohen në Drejtorinë e Financave nga njësitë kërkuese, që jo cdo herë janë klasifikime të sakta. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | |
| 3. | **Çështja A3 - Mos-vazhdimi i sigurisë së ekzekutimit konform periudhës së zbatimit të kontratës** | Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik, neni 30 përcakton:<br>"Siguria e ekzekutimit është paraparë të mbështetë përmbushjen e kontratës. Shuma e sigurimit të ekzekutimit do të jetë e barabartë me të paktën 10% të vlerës së kontratës. Sigurimi i ekzekutimit do të mbetet valid për një periudhë prej tridhjetë (30) ditë pas kompletimit të kontratës". Po të njëjtin obligim ligjor komuna e kishte përfshirë edhe te kushtet e veçanta të kontratave.<br>Në tre mostra të identifikuara të vonesave në kryerjen e punimeve, zyrtarët përgjegjës, përkatësisht zyra e prokurimit nuk kishte kërkuar vazhdimin e sigurimit të ekzekutimit të kontratës, përkundër që siguria e ekzekutimit kishte skaduar akoma pa përfundu projekti:<br>• "Kontrata në vlerë 49,737.80€, për rregullimin e oborreve dhe hapësirave të QMF-së-Vushtrri, e datës 17.06.2021: | Kryetari duhet të sigurojë përmes zyrtarëve përgjegjës, se sigurimi i ekzekutimit duhet të ketë vlefshmëri në raport me periudhën e përmbushjes së kontratës ashtu siç parashihet me Rregullat dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurimin Publik. | Veprimet e ndërmarra:<br><br>Prokurimi: Gjatë fazës së dorëzimit të kontratës tek menaxheri i kontratës, i përkujtohet menaxherit se duhet ta përcjellë validitetin e sigurisë së ekzekutimit duke ia dërguar edhe kopjen e polises se sigurisë së ekzekutimit gjë që nuk ka ndodhur në të kaluaren.<br><br>Në rastet specfike që kanë shërbyer si mostra të auditorit janë ndërmarrë këto veprime:<br><br>Projekti i rregullimit të hapësirave dhe oborrit të QMF-së - është shkëputur kontrata me OE.<br><br>Projekti Renovimi i stadiumit të hendbollit "Musa Abazi" si dhe projekti projekti për rregullimin e hapësirës publike-<br>Një ecje në histori e datës janë rishikuar dhe janë në | Pjesërisht i zbatuar<br><br>Vendim mbi emresimin ne detyre | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | • "Kontrata në vlerë 113,606€, për renovimin e stadiumit të hendbollit Musa Abazi- Vushtrri e datës 23.07.2021": dhe<br>• "Kontrata në vlerë 139,929.70€, për rregullimin e hapësirës publike- Një ecje në histori e datës 10.06.2021".<br>Një situatë e tillë kishte ndodhë si pasojë që zyra e prokurimit si dhe menaxherët e kontratave kishin neglizhuar rëndësinë e sigurisë së ekzekutimit. | | pritje të aprovimit të punëve të pa parapara (Garancioni i ekzekutimit është vazhduar për të dyja.)<br><br>Garancionet e ekzekutimit janë vazhduar edhe për dy kontrata të tjera për të cilat është zgjatur ekzekutimi i punëve.<br><br>**Dëshmitë: garancionet, shkëputja e kontratës etj.** | | |
| 4. | **Çështja A4 - Angazhimi i punonjësve pa procedura për shërbime të veçanta** | Ligji për zyrtarët publik nr. 06/L-114, nenit 84 - përcakton se marrëveshjet për shërbime të veçanta, lidhen sipas legjislacionit përkatës të prokurimit publik. Sipas paragrafit 4 të ndryshim plotësimit të rregullave për prokurim të shërbimeve të veçanta (konsulent/kontraktorët individual) këto rregulla aplikohen vetëm për prokurimin e shërbimeve të veçanta të cilat nuk mund të sigurohen përmes procedurave të rekrutimit. | Kryetari duhet të sigurojë se janë ndjekur të gjitha procedurat dhe hapat e prokurimit në angazhimin e kontraktorëve individual për shërbime të veçanta duke u kujdesur që personeli i angazhuar do të jetë në gjendje të përmbush detyrat e kërkuara. Po ashtu, menaxhmenti duhet të përkujdeset që angazhimet për pozitat e rregullta të zhvillohen përmes procesit të rregullt të rekrutimit. | Veprimet e ndërmarra:<br><br>Për 2022 ka pasur vetëm një punonjës të pranuar për shërbime të vecanta, ndërsa pranimi është bërë sipas procedurave të prokurimit. | I zbatuar | Mbetet sfidë që kjo të aplikohet në mënyrë të vazhdueshme |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Komuna në vitin 2021 kishte angazhuar 141 persona me marrëveshje për shërbime të veçanta për periudhën nga tetori deri në dhjetor 2021.Bazuar në shënimet e Thesarit, për shërbime të veçanta janë paguar në vlerë të përafërt 150,071€. Ne kemi testuar tre mostra dhe kemi identifikuar se komuna nuk kishte zhvilluar procedura të prokurimit publik për angazhimin e tyre. Kontratat e nënshkruara mes komunës dhe të angazhuarve kryesisht ishin për pozita të rregullta të punës (jo specifike) si për infermier, zyrtar për leje ndërtimore, për mirëqenie sociale etj. Ky staf ishte angazhuar pasi që kishte mangësi në sistemin për aplikimin e procedurave të përcaktuara ligjore për punësimin e stafit për pozita të rregullta të aprovuara me planin e personelit, si dhe për shkak të mungesës së stafit gjatë pandemisë, për plotësimin e shërbimeve komunale. | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | |
| 5. | **Çështja A5 - Mos pagesa e faturave brenda afatit 30-ditë** | Me nenin 39 të LMFPP, kërkohet që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagim për mallrat dhe shërbimet e realizuara të paguhet brenda 30 ditëve kalendarike pas pranimit të faturës.<br>Nga pesë mostrat e testuara (fatura) një nga këto nuk ishte paguar brenda afatit ligjor prej 30 ditësh.<br>Vlera e faturave të cilat nuk janë paguar brenda 30 ditëve në PFV është 90,358€.<br>Shkaku i mos pagesave me kohë janë kontrollet e dobëta në menaxhimin e borxheve dhe menaxhimin e buxhetit. | Kryetari duhet të forcojë kontrollet e brendshme dhe të sigurojë që të gjitha obligimet të paguhen në afatin ligjor prej 30 ditësh. | Veprimet e ndërmarra:<br><br>1. Është reduktuar numri i faturave të paguara me vonesë, përtej afatit 30 ditor në të dyjat kategoritë e shpenzimeve, investimet kapitale dhe mallrat dhë shërbimet.<br><br>Evidentohen ulje nga muaji në muaj si në vijim:<br><br>**Në Shtator 2022** janë raportuar në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve **5,705€** obligime të papaguara<br><br>**Në gusht 2022** janë raportuar obligime në të njëjtën kategori në vlerë **8,532€.**<br><br>**Në korrik 2022** –nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve obligimet e raportuara ishin **13,062€.**<br><br>2. Planifikohet një ri-organizim i proceseve të punës përbrenda komunës, përkatësisht Drejtorisë së Financave sa i përket | Pjesërisht i zbatuar | Është proces në vazhdimësi, priten përmirësime tutje sidomos me ri-organizimin e punëve sipas pikës 2. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | pranimit/protokolimit të faturave me qëllim që të minimizohen mundësitë e vonesës së pranimit të faturave, nga drejtoritë e tjera, në drejtori të financave ku edhe procesohen pagesat. | | |
| 6. | **Çështja A6 - Përzgjedhja e Operatorit Ekonomik të papërgjegjshëm** | Bazuar në LPP, neni 59.4, përcakton se autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Dosja e tenderit e datës 16.07.2021 për zgjerimin e rrjetit të ndriçimit publik, me numër prokurimi VU644-21-4632-5-2-1 tek pjesa Kapaciteti teknik dhe professional, kërkohet, një Inxhinier i diplomuar i elektroteknikës apo master, 3 vite përvojë pune pas diplomimit (drejtimi Tension i Ulët). Në procedurat e tenderit për zgjerimin e rrjetit të ndriçimit publik, kontratë e nënshkruar me datë 30.09.2021 me vlerë 94,121€, OE që ka fituar tenderin nuk ka dëshmi se ka ndonjë inxhinjer të elektroteknikës të drejtimit tensioni i ulët. | Kryetari duhet të sigurojë kontrolle në procesin e vlerësimit të ofertave, në mënyrë që përzgjedhja e fituesve të bëhet vetëm pasi të jenë plotësuar kërkesat e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. | Veprimet e ndërmarra:<br><br>Zyra e prokurimit ka shtuar masat e kontrollit, para nënshkrimit të raportit të vlerësimit edhe një herë kontrollohen te gjitha ofertat nga zyrtari përgjegjës i lendes dhe nga ZPP-ja. | Pjesërisht i zbatuar | Në proces mbetet të shihet për këtë vit |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Bazuar në këtë, ne kemi vërejtur se nuk janë përmbushur kërkesat e parashtruara në njoftimin për kontratë dhe në dosje të tenderit, për të cilat komisioni i vlerësimit të ofertave kishte vlerësuar si të përgjegjshëm duke rekomanduar nënshkrimin e kontratës.<br>Kjo ka ndodh si rezultat i kontrolleve të brendshme jo efikase në procesin e vlerësimit të tenderëve konform kritereve të përcaktuara në dosje të tenderit dhe në njoftimin për kontratë. | | | | |
| 7. | **Çështja A7 - Pranimi i shërbimeve para krijimit të urdhërblerjes** | Rregulla financiare nr. 01/2013- Shpenzimi i parave publike, neni 22- procedurat e përgjithshme për procedimin e pagesave, përcakton hapat për procedimin e pagesave, ku fillimisht bëhet kërkesa për blerje, lëshohet urdhërblerja, bëhet pranimi i mallit/shërbimit, pastaj Operatori Ekonomik sjell faturën për pagesë.<br>Në tre pagesa për mallra dhe shërbime në vlerë 37,908€, kemi identifikuar se paraprakisht është pranuar fatura pastaj është krijuar urdhërblerja.[4]<br>Kjo ka ndodhur si rezultat i mos funksionimit të mirë të kontrollit të brendshëm. | Kryetari duhet të sigurojë përmes personave përgjegjës që të ndjekin hapat për procedimin e pagesave të përcaktuara me rregullën financiare për shpenzimin e parave publike. | Veprimet e ndërmarra:<br><br>Drejtoria e Shërbimeve Publike, aty ku janë evdidentuar mostrat e auditorit, nuk ka pranuar shërbime/mallra konform rregullës financiare 01/2013.<br><br>Drejtoria e Financave konfirmon se nuk ka bërë pagesa deri në Shtator 2022, pa përfillje të procedurave. | Pjesërisht i zbatuar | Mbetet të shihet nëse do të vazhdojë deri në përmbyllje të vitit të aplikohet rregulla 01/2013. |

***Zyra e Kryetarit të Komunës***
*Tel.+383 (0) 38 42 402; Mob.+383 (0) 44 509 633; e-mail: ferit.idrizi@rks-gov.net*
*Adresa: Ndërtesa e Komunës së Vushtrrisë, P.n. 42000, Komuna e Vushtrrisë, Republika e Kosovës*

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 8. | Çështja A8 - Shërbimet e pranuara jo në pajtueshmëri me marrëveshjen | Në marrëveshjen numër 542/21 me vlerë mujore 45,850€ të datës 17.05.2021 për kryerjen e shërbimeve komunale në komunën e Vushtrrisë, në pikën 2, mirëmbajtja – pastrimi i objekteve të institucioneve publike të komunës është e përcaktuar, që nga kjo vlerë të paguhen për pastrimin e objekteve për 21,350€ dhe sigurimin fizik të objekteve për 24,500€.<br>Për kryerjen e shërbimeve komunale në Komunën e Vushtrrisë janë identifikuar pagesa më tepër se marrëveshja në vlerë 5,368€. Këto gabime janë identifikuar:<br>• Në tre pagesat në vlerë 49,518€ të datës 30.08.2021, për mirëmbajtjen e pastrimit dhe sigurimin fizik të objekteve, komisioni mbikëqyrës ka pranuar më tepër shërbime në vlerë 3,668€ për një muaj; dhe<br>• Në pagesën në vlerë 15,403€ të datës 16.12.2021, janë paguar shpenzime jo në përputhje me marrëveshjen për ujitjen e drunjëve dekorativ është paguar më tepër për 1,700€[5] se sa ishte e paraparë në marrëveshje. | Kryetari duhet të sigurojë forcimin e kontrollit të brendshëm që të gjitha pagesat të bëhen në pajtueshmëri me kontratën. | Veprimet e ndërmarra:<br><br>Në dy rastet specifike që lidhen me ndërmarrjen "Përparimi" janë adresuar rekomandimet. Marrëveshja e komunës me ndërmarrjen ka përfshirë cështjen e TVSH-së, ndërsa në pagesat vijuese është zbritur shuma e paguar më tepër për ndërmarrjen, më qëllim që buxheti i komunës të mos dëmtohet dhe të barazohen llogaritë. | I zbatuar | Mbetet sfidë forcimi i kontrolleve të brendshme edhe për pjesën tjetër të vitit 2022 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Mungesa e sisitemit të kontrolleve ka rezultuar që të bëhen pagesa jo sipas çmimeve dhe shërbimeve të përcaktuara me marrëveshje. | | | | |
| 9. | **Çështja B1 - Dobësi në procesin e veprimtarive inspektuese të pronave** | Sipas ligjit Nr.06/L-005-"Për pronën e Paluajtshme", neni 15 "Inspektimi" pika 2, përcakton se "Veprimtaritë inspektuese kryhen çdo vit për të paktën njëzet përqind (20%) të të gjitha objekteve brenda territorit të Komunës". Komuna për vitin 2021 nuk ka arrit të kryej inspektimin e 20% të pronave të regjistruara, ku prej 23,526 të pronave, gjatë vitit 2021 ka inspektuar vetëm 969 prej tyre, apo 4.11%. Shkaku për këtë ka qenë pandemia globale, si dhe vështirësive në organizimin e aktiviteteve dhe stafit. | Kryetari duhet të sigurojë mekanizma efektiv për inspektimin e kuotës së përcaktuar prej 20% të objekteve siç kërkohet me ligjin e ri, si dhe të rrisë kontrollin e menaxhimit të punëve në teren. | Veprimet e ndërmarra:<br><br>Deri më 16 shtator 22 janë inspektuar 2740 objekte të tatueshme (667 objekte të reja), më shumë se 10% nga numri i përgjithshëm.<br><br>Sipas planit të sektorit të tatimit në pronë inspektimet do të vazhdojnë deri në Dhjetor 2022, dhe deri atëherë llogaritet të inspektohen rreth 4800 objekte për t'u përllogaritur për faturimin 2023.<br><br>Për hapin I, të përcaktuar me plan të veprimit, objektivi është përmbushur, mbetet të shihet periudha vijuese. Faktorë risku në përmbushjen e mëtutjeshme mbetet sa do të zgjasë greva e punëtorëve të administratës përkatësisht anketuesit që do të vazhdojnë inspektimet në terren. | Pjesërisht i zbatuar | |
| 10. | **Çështja B2 - Mangësi në menaxhimin e të dhënave nga tatimi në pronë** | Ligji Nr.06/L-005 Për tatimin në Pronën e Paluajtshme, neni 11 përcakton | Kryetari duhet të sigurojë kontrolle shtesë në departamentin e tatimit në | Veprimet e ndërmarra | Pjesërisht i zbatuar | |



*Tel.+383 (0) 38 42 402; Mob.+383 (0) 44 509 633; e-mail: ferit.idrizi@rks-gov.net*
*Adresa: Ndërtesa e Komunës së Vushtrrisë, P.n. 42000, Komuna e Vushtrrisë, Republika e Kosovës*

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | se zbritja për vendbanimin parësor, "Personi fizik, i cili vendos deri më 30 nëntor të vitit, para vitit tatimor se njësia e objektit shërben si vendbanim parësor dhe e deklaron këtë në komunë apo gjatë fazës së inspektimit, i lejohet zbritja prej pesëmbëdhjetë mijë (15,000)€ nga vlera e vlerësuar e njësisë së objektit".<br>Nga testimi i katër mostrave, në dy prej tyre kemi Identifikuar se është bërë nën-faturim në vlerë prej 90€[6], për arsye se Komuna i ka lejuar zbritjet për vendbanimin parësor në të gjitha pronat që i kanë poseduar;<br>Nga testimi i katër mostrave, në dy prej tyre kemi identifikuar se është bërë mbi-faturim në vlerë prej 45€[6], sepse nuk ju ka bërë tatimpaguesit zbritja adekuate e vendbanimit parësor të një prone (objekti).Kjo ka ndodhur si shkak i kontrolleve të dobëta në këtë fushë lidhur me përditësimin e informacionit të tatimpaguesve në sistem. | pronë, në mënyrë që të dhënat në sistemin ProTax të jenë të harmonizuara me rregulloren e tatimit në pronën e paluajtshme të Komunës dhe me ligjin, dhe të gjitha rastet e tilla të korrigjohen. | 1.Në faqen zyrtare të Komunës dhe rrjetet sociale (FB), në hyrje të objektit komunal dhe të gjitha zyrat pritëse është nxjerrë një ftesë permës së cilës është kërkuar që qytetarët të vinë të lajmërojnë vendbanimin primar. E njëjta gjë është komunikuar, gjatë punëve me palë prej nga pastaj janë bërë ndryshime në protax aty ku është aplikuar. Ndryshimet në sistem që janë inicuar si rezultat i inspektimeve janë të vogla pasi që në shumë raste kur ato kryhen banorët nuk gjenden në shtëpi.<br><br>Ndonëse përmes veprimeve më lartë shtë arritur një rezultat, megjthatë planifikohet që kjo të mund të korrektohet edhe përmes një mekanizmi tjetër si është nxjerrja e listes së tatimpaguesve që kanë përfituar më shumë se njëherë nga zbritja e aplikueshme për banimin primar me qëllim që të jetë më i targetuar përmirësimi i të dhënave. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 11 | **Çështja A9 - Mangësi në raportim të implementimit të projektit të subvencionuar** | Bazuar në memorandumin e mirëkuptimit ndërmjet organizatës ndërkombëtare humanitare Arbeiter-Samariter-Bund Deutschland e V (ASB), pika A, përcakton se projekti do të zgjasë deri me 31 dhjetor 2021. Poashtu pika D përcakton se ASB obligohet që në fund të projektit të përgatisë një raport me të dhënat e përfituesve si dhe një pasqyrë financiare, ku paraqiten shpenzimet e kontributit komunal. Rregullorja 04/2017-mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, neni 24, pika 2, përcakton se "Ofruesit e mbështetjes financiare kanë për detyrë të bëjnë monitorimin e rregullt dhe të drejtpërdrejtë të mbështetjes financiare publike për OJQ-të, me qëllim që ajo të jetë në linjë me kërkesat e Rregullores, dhe të arrijë qëllimin për të cilin është ofruar mbështetja financiare publike". Në projektin për "Mbështetje të integruar Socio-ekonomike për familjet shumë të prekura" me vlerë 12,000€, i cili duhej të përfundonte me 31.12.2021, nuk kishte raportim sipas | Kryetari duhet të sigurojë që zyrtari përgjegjës për monitorim dhe zbatim të projekteve të subvencionuara, zbaton të gjitha procedurat e kontrollit, për raportimin e tyre që të arrijnë të arsyetojnë shpenzimet sipas memorandumit, dhe monitorimeve apo raportimeve sipas kërkësës së rregullores përkatëse. | Veprimet e ndërmarra:<br><br>Arsimi: Shpërndajnë bursa, nuk aplikohet raportimi te rasti i bursistëve.<br><br>Kulturë: Tri thirrje publike nga komuna, në sektorin e kulturës, rinisë dhe sportit për financim të klubeve, sportit, shoqatave rinore, organizatat kulturore, dhe sipas vendimeve nr.32604/22 dt 23.06.22; nr.636/22 të dt. 23.05.22; nr.33123/22 të dt. 27.06.22; nr.32605/22 të dt.23.06.22; janë ndarë mjetet.<br><br>Të gjithë përfituesit dorëzojnë raport narrativ dhe financiar në fund të vitit, ndryshe penalizohen dhe nuk mund të jenë përfitues të fondeve komunale mëtutje.<br><br>Shëndetësi: Në sektorin e shëndetësisë janë ndarë subvencione në kuadër të drejtorisë së shëndetësisë dhe përkujdesjes sociale në bazë të vendimit nr. 35158/22 të dt. 07/07/22. Pranohen raporte. | Pjesërisht i zbatuar | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | memorandumit, pika D, ku përcakton se ASB obligohet që në fund të projektit të përgatisë një raport me të dhënat e përfituesve si dhe një pasqyrë financiare, ku paraqiten shpenzimet e kontributit komunal. Në projektin për "Për përkrahje financiare për klubin e futbollit Vushtrria", me vlerë 45,000€, e aprovuar me vendimin e kuvendit komunal, për këtë shpenzim komuna nuk kishte përcaktuar monitorimin e rregullt dhe të drejtpërdrejtë të mbështetjes financiare publike, ku si pasojë e kësaj nuk kishte raporte kthyese. Kjo situatë ka ndodhur për shkak të neglizhencës nga ana e zyrtarëve përgjegjës të komunës. | | | | |
| 12 | **Çështja A10 - Mungesa e planit vjetor të mbështetjes financiare të OJQ-ve** | Rregullorja 04/2017-mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, neni 6, ofruesit e mbështetjes financiare përgatisin pjesën e planit vjetor të mbështetjes financiare për OJQ-të më së largu 30 ditë pas miratimit të buxhetit vjetor të Republikës së Kosovës. Komuna edhe pse me Buxhet të Kosovës ka parapa që gjatë vitit 2021 të ofrojë mbështetje financiare për projektet dhe programet e OJQ-ve, | Kryetari duhet të sigurojë se personat përgjegës përgatitin Planin Vjetor për Mbështetje Financiare për OJQ-të dhe të sigurojë se i njëjti përmban të gjitha kërkesat e përcaktuara me rregullore për Mbështetje Financiare. | Veprimet e ndërmarra:<br><br>Komuna nuk ka të përgatitur plan gjithpërfshirës sipas rregullores 04/2017 për të gjitha drejtoritë që ndajnë subvencione, mirëpo drejtoritë individuale e kanë planin e tyre të ndarjes së fondeve kryesisht përmes thirrjeve publike. | I pa zbatuar | |



*Tel.+383 (0) 38 42 402; Mob.+383 (0) 44 509 633; e-mail: ferit.idrizi@rks-gov.net*
*Adresa: Ndërtesa e Komunës së Vushtrrisë, P.n. 42000, Komuna e Vushtrrisë, Republika e Kosovës*

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | megjithatë nuk ka përmbushur kërkesën ligjore për përgatitjen e Planit Vjetor për mbështetje financiare të OJQ-ve. Mungesa e llogaridhënies në nivelin e duhur nga menaxhmeti për menaxhimin e mirefilltë të subvencioneve ka ndikuar në mospërgatitjen e planit vjetor për mbështetje financiare. | | | | |
| 13 | **Çështja B3 - Mangësi në procesin e vlerësimit të aplikacioneve për subvencion** | Rregullorja 04/2017-mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, neni 4, përcakton se duhet të bëhet trajtimi i barabartë dhe mos diskriminimi i aplikuesve si dhe gjithëpërfshirja gjinore e përfituesve. Thirrja për aplikim e datës 07.05.2021 për furnizim me pajisje për bletë, pika II përcakton numrin maximal prej 80 pikëve. Përzgjedhja e përfituesve të subvencioneve të datës 02.08.2021, kishte rezultuar me parregullsi në trajtmin e përzgjedhjes së aplikuesve. Kemi identifikuar se në dy raste[7], komisioni i vlerësimit ka shpallur fitues aplikantët përkundër që nuk kishin plotësuar kriteret për tatimin në pronë. Në anën tjetër përkundër që aplikanti kishte plotësuar kriteret, nuk ishte në listën e përfituesve. | Kryetari duhet të sigurojë përmes zyrtarëve përgjegjës që procesi I vlerësimit të aplikuesve për subvencione të jetë i saktë dhe i drejtë bazuar në dëshmitë për kriteret. | Veprimet e ndërmarra:<br><br>Është bërë ndryshim i rregullores për subvencionimin e bujqve dhe e njëjta është aprovu dhe miratu nga MAPL në 2022.<br><br>Ndryshimet në rregullore kanë përfshirë ndryshimin edhe të kritereve për përfituesit, duke qenë se rregullorja ka pasur mangësi të cilat kanë ndikuar punën në trajtimin e aplikuesve.<br><br>Është lehtësuar forma e përzgjedhjes së përfituesve. | I zbatuar | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Për më tepër, pikët e vendosura në listën e përfituesve nuk ishin të harmonizuara me pikët në vlerësimin e aplikacioneve. Kjo ka ndodh si rezultat i mungesës së kontrolleve adekuate nga zyrtarët përgjegjës gjatë vlerësimit të aplikuesve. | | | | |
| 14 | **Çështja A11 - Pagesa e TVSH-së jo në pajtim me kontratën** | Kontrata e datës 10.06.2021 për rregullimin e hapësirës publike, bashkfinancim me UN-Habitat, neni 2.4 i kontratës potencon se UN-Habitat përjashtohet nga TVSH, ku me rastin e faturimit fatura të jetë me TVSH por pagesa të bëhet pa TVSH. Në pagesën për ndërtimin e rrugëve me bashkfinancim në situacionin e dytë në vlerë 57,142€, është identifikuar se pjesa e shpenzimit nga fondi 60 -UN Habitat në vlerë 14,775€ ishte paguar komplet, përkundër që TVSH-ja në vlerë 2,253€ nuk do duhej të paguhej. Kjo ka ndodhur për arsye të mbikëqyrjes së pamjaftueshme nga zyrtarët përgjegjës, gjatë ekzekutimit të pagesave. | Kryetari duhet të sigurojë përmes personave përgjegjës vendosjen e kontrolleve shtesë gjatë procedurave të pagesave për të siguruar se pagesat ekzekutohen në pajtim me kushtet e kontratës. | Veprimet e ndërmarra:<br><br>Në pagesën e radhës, fatura e datës 24.03.22 edhe pse ishte me TVSH, në vlerë 24,434.26 është paguar në përputhje me nenin 2.4 të kontratës nr.297/21, duke adresuar kështu vërejtjen e auditorit. | I zbatuar | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | |
| 15 | **Çështja A12 - Mangësi në shpenzimin e Investimit përmes përmbaruesit privat** | Regulla financiare 01/2013, neni 38-Pagesat e vendimeve përmbaruese të gjykatave, neni 1.1, përcakton se kur një gjykatë nxjerr urdhër ose vendim me të cilin kërkohet nga një autoritet publik që të paguajë çfarëdo lloji të kompensimit monetar ndaj një personi dhe urdhri ose vendimi nuk i nënshtrohet të drejtës së ankesës nga autoriteti publik ose autoriteti publik nuk e ka ushtruar këtë të drejtë me kohë, gjykata menjëherë i dërgon një kopje të urdhrit ose vendimit Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Financave. Poashtu sipas nenit 41- Pagimi i faturave dhe kërkesave për pagesë, pika 1. Organizata buxhetore duhet që çdo faturë të vlefshme për pagimin e mallrave dhe shërbimeve të pranuara ta paguaj brenda 30 ditësh kalendarike nga data e pranimit të faturës.<br>Në propozimin për përmbarim të datës 03.08.2021 nga përmbaruesi privat, | Kryetari duhet të sigurojë që zyra ligjore në kordinim me drejtoritë të analizojnë shkresat nga përmbaruesi, aty ku ka dëshmi për prapësim të veprojë me kohë.<br>Përgjigja | Nuk janë ndëmarrë veprime | I pa zbatuar | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | për punët e pranuara nga komuna në vlerë 50,220€ të datës 11.05.2021, komuna nuk kishte ushtruar ankesë, përkundër që fatura nuk kishte dëshmi se është pranuar në komunë për pagesë. Me datë 08.09.2021 përmbaruesi kishte dhënë urdhër për transfer të mjeteve në Ministrinë e Financave, ku shpenzimi kryesor plus shpenzimet përmbarimore kanë arritë në vlerë 53.007€. Komuna vetëm për shpenzime përmbarimore ka paguar 2,787€.<br>Kjo ka ndodh pasi që fillimisht fatura e OE nuk ishte pranuar në komunë. Për shkak të neglizhencës nga zyrtarët përgjegjës, zyra ligjore nuk kishte ushtruar ankesë për mos ekzekutimin e pagesës. | | | | |
| 16 | **Çështja B4 - Mungesa e projektit ekzekutues** | Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik neni 20.10, përcakton që specifikat teknike për kontratën e punës, duhet të përfshijnë një projekt ekzekutues si pjesë substanciale të veten. Ndërsa pika 13 "Autoriteti kontraktues është përgjegjës për hartimin e projektit ekzekutues dhe i cili në mënyrë mandatore duhet ti | Kryetari duhet të sigurojë se për të gjitha aktivitetet e prokurimit që kanë të bëjnë me punë, të mos iniciohen procedurat pa u siguruar specifika të qarta sipas projektit ekzekutues të cilat do të ndikonin në eliminimin e vonesave dhe të kostove shtesë. | Veprimet e ndërmarra:<br><br>Nuk ka ende OE të prokuruar për hartimin e projekteve. | I pa zbatuar | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | bashkëngjitet specifikave teknike të cilat janë pjesë e dosjes së tenderit". Asnjë Autoriteti Kontraktues nuk i lejohet që të lëshojë dokumentacionin e tenderit pa bashkangjitur përshkrimin e hollësishëm të projektit.<br>Kemi identifikuar se në pesë (5) mostra të testuara për kontrata pune, komuna nuk kishte hartuar projektin ekzekutues, por i kishte zhvilluar procedurat e prokurimit duke përgatitur vetëm paramasën dhe parallogarinë. Mungesa e projekteve ekzekutuese kryesisht ishte te: "Rregullimi i hapësirës publike Një Ecje në Histori"; "Rregullimi i shtratit të lumit Sitnica&Vushtrri"; "Zgjerimi i rrjetit të ndriçimit publik në qytet dhe 13 fshatra-Lot 1"; "Rehabilitimi i zhveshtoreve në terenin në fushën e sportit"; "Asfaltimi i rrugëve lokale në 14 fshatra-Lot 2".<br>Kjo ka ndodh pasi që kontrata për hartimin e projekteve që ka pas komuna, ishte përmbushur me 25.02.2020. Deri tani komuna nuk ka lidhur kontratë të re për shkak të ankesave të njëpasnjëshme nga OE. | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | |
| 17 | **Çështja B5 - Vonesa në realizimin e kontratave** | Rregulla dhe Udhëzuesi Operativ të Prokurimit Publik, pikat 61.6, 61.19 dhe 61.20 përcaktojnë se: "Menaxherët e kontratës janë përgjegjës për menaxhimin e kontratës dhe duhet të sigurojnë se OE kryen kontratën në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuara në kontratë. Secila kontratë publike ka të përcaktuar afatin kohor të implementimit.<br>Nga pagesat e testuara kemi evidentuar vonesa deri në 6 muaj në realizimin e shtatë (7) kontratave, të cilat është dashur të përfundonin në vitin 2020/2021. Vonesat kanë të bëjnë me projektet për:<br>• Rehabilitimin e zhveshtores në terenin në fushën e sportit Dobërllukë (29,842€), e datës 16.08.2021;<br>• Asfaltimin e rrugëve në 12 fshatra (346,619.70€), e datës 03.09.2019;<br>• Renovimin e shkollës Eqrem Qabej (26.084€), duhej të fillonte me 09.08.2020; | Kryetari duhet të sigurojë që mos të fillohen projektet pa u siguruar çështjet pronësore, hartimit të specifikave adekuate të projekteve dhe se menaxherët e kontratave për çdo raport të punëve të sqarojnë arsyet e vonesave. Po ashtu, për vonesat e pa arsyetuara, të aplikohen penalet e parapara me kontratë. | Veprimet e ndërmarra:<br><br>Janë rishikuar një pjesë e kontratave aktive në komunë.<br><br>**Rregullimi i oborrit dhe hapësirës QMF/Vushtrri – është shkëputur kontrata.**<br><br>Për dy projektet e tjera: Renovimi i stadiumit të hendbollit "Musa Abazi" dhe rregullimi i hapësirës publike - Një ecje në histori, janë në pritje të aprovimit të punëve të pa parapara me kontratë, ndërsa për të dyja është zgjatur afati i garancionit të ekzekutimit. | Pjesërisht i zbatuar | Të shikohen kontratat tjera sa i përket realizimit dhe garancionit. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | • Rregullimin e oborrit dhe hapësirës QMF-Vushtrri (49,737.80€), e datës 17.06.2021;<br>• Renovimin e stadiumit të hendbollit Musa Abazi-Vushtrri (113,606€), e datës 23.07.2021;<br>• Rregullimin e hapësirës publike-Një ecje në histori (139,929.70€), e datës 10.06.2021;<br>• Pajisje mjekësore (25,000), e datës 11.03.2021.<br>Duhet theksuar se në asnjërin prej këtyre rasteve nuk kishte kërkesë/aprovim për zgjatjen e afatit për realizimin e kontratave, siç përcaktohet në nenin 18 të dosjes standarde të tenderit. Po ashtu, nuk kishte aplikim të penaleve. Shkaqet e vonesave kryesisht ishin për shkak të menaxhimit jo adekuat të komunës lidhur me problemet pronësore, specifikave të punëve, pa përgjegjshmërisë së OE, kushteve atmosferike etj. Ndërsa, mos formalizimi i vonesave ishte për shkak të neglizhencës së menaxherëve të kontratave lidhur me kërkesat ligjore. | | | | |
| 18 | **Çështja B6 - Mangësi në regjistrin kontabël të pasurive** | Rregullorja 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare, neni 6.3, përcakton se pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK, ndërsa | Kryetari duhet të sigurojë se të gjitha pasuritë e komunës janë identifikuar dhe regjistruar saktë në regjistrat përkatës të pasurive komunale, me qëllim | Veprimet e ndërmarra<br><br>Është caktuar lokacioni për ndërtimin e depos së pranimit të mallit konform standardeve . | Pjesërisht i zbatuar | Sfidë mbetet zgjedhja e personit përgjegjës për pranim të mallit në depo, dhe |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohet në sistemin e-pasuria.<br>Regjistri i e-pasurive nën 1,000€ është nënvlerësuar për 324,531€. Ky nënvlerësim ka reflektuar nga pasuritë e paregjistruara nga viti 2020 në vlerë për 46,512€ si dhe pasuritë jo kapitale të blera në vitin 2021 në vlerë 278,019€, të cilat nuk ishin ishin regjistruar në regjistrin e pasurive jo financiare.<br>Po ashtu blerja e pajisjeve të teknologjisë informative në vlerë €72,409€, ishte regjistruar si pasuri kapitale regjistrin SIMFK, duke mbivlerësuar pasurinë mbi 1,000€. Ndërsa këto pajisje do duhej të regjistroheshin në regjistrin e-pasuria.<br>Sistemi për regjistrimin dhe menaxhimin e pasurive jo kapitale "e-pasuria" nuk ishte aplikuar gjatë vitit 2020 dhe 2021, si rezultat i mosfunksionimit të sistemit e-pasuria.<br>Megjithatë komuna nuk mban regjistra të brendshëm për evidentimin e pasurisë nën 1,000€. Prandaj vlera e pasurive jo kapitale të shpalosura në PFV-të prej 449,769€ dhe stoqet 1,123€ nuk japin siguri në raportim. | të ruajtjes nga humbja apo keqpërdorimit të tyre. | Blerja e pajisjeve të teknologjisë informative në vlerë €72,409€ që ishte regjistruar në SIMFK, është duke u regjistruar pjesë - pjesë në e-pasuria, varësisht nga kërkesat e shkollave për t'u pajisur me pajisje të teknologjisë informative.<br><br>Varësisht kësaj më lartë, do të anulohet edhe regjistrimi në SIMFK prej €72,409€.<br><br>Paralelisht mne ndërtimin e depos, të zgjedhet një deposit, përgjegjës për pranimin e mallit, që të vendos barkodet dhe të ngarkojë mallin për njësitë kërkuese dhe të bashkangjitë CPO-në. | | ecuria e punimeve për ndërtim të depos |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Dobësitë e identifikuara lidhur me mosregjistrimin e pasurisë jo-kapitale, janë si pasojë e mungesës së zyrtarit përgjegjës për regjistrimin e pasurive jo-kapitale si dhe problemeve të shfaqura me sistemin e-pasuria. Ndërsa mbivlerësimi i pasurive në regjistrin e SIMFK-së ka rrjedh si gabim teknik. | | | | |
| 19 | **Çështja B7 - Mangësi në procesin e inventarizimit dhe vlerësimit të pasurive jo financiare** | Rregullorja 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare, neni 19.4.3 përcakton se çdo fundvit duhet të bëhet krahasimi i gjendjes së inventarizuar me gjendjen e regjistrave të pasurive jo financiare. Ndërsa kërkesave të Rregullores 02/2013. Komuna kishte kryer vetëm një pjesë të inventarizimit të pasurive jo financiare, rrjedhimisht nuk ishte bërë krahasimi i gjendjes së inventarizuar me gjendjen në regjistrat e pasurive jo financiare para datës së përgatitjes së PFV-ve. Po ashtu, komuna nuk kishte formuar komisonin për vlerësimin e pasurive jo financiare. Mangësitë janë vërejtur po ashtu në ekzaminimin fizik të Pajisjeve mjekësore në vlerë 25,000€, të pranuara me 27.04.2021, të cilat nuk ishin në funksion. Pajisjet e pranuara janë paisje electrolyte analyzer në vlerë | Kryetari duhet te sigurojë se procesi i inventarizimit dhe vlerësimit të pasurive do të kryhet sipas kërkesave të Rregullores 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare në organizatat buxhetore. Të bëhen planifikime adekuate për furnizim të paisjeve si dhe paraprakisht të vlerësohen kapacietet ekzistuese me qëllim të vënies në funksion të të gjitha paisjeve të blera, ashtu që të arsyetohet vlera për para për furinizimet e bëra. | Veprimet e ndërmarra:<br><br>Është bërë krahasimi i gjendjes faktike dhe raportit të komisionit ndërsa ndryshimet e evidentuara kanë qenë minore, sipas raportit të gjeneruar në këtë çështje. | I Zbatuar | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 9,500€, e cila gjindet në laborator si dhe ventilator transportues dhe inhalator professional në vlerë 15,500€ që ishin në depo, përderisa asnjëra prej tyre nuk ishin vënë në shërbim.<br>Magësitë në procesin e inventarizimit dhe vleresimit të pasurive, kryesisht ishin për shkak të neglizhencës së zbatimit të procedurave për menaxhimin e pasurive jo financiare si dhe mungesës së udhëzuesve të brendshëm lidhur me procesin e inventarizimit dhe vlerësimit të pasurive.<br>neni 21 i po kësaj rregulloreje ka përcaktuar kërkesat për vlerësimin e pasurive jo financiare.<br>Procesi i inventarizimit të pasurive jo financiare nuk ishte përfunduar sipas | | | | |
| 20 | **Çështja B8 - Dobësi në menaxhimin e llogarive të arkëtueshme** | Sipas Rregullores së MF Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore, neni 16, citon që OB që mbledhin të hyra, janë të detyruara të mbajnë regjistra të të hyrave të mbledhura dhe shumat e faturuara e të pa arkëtuara.<br>Të arkëtueshmet shpalosen në raportin vjetor | Kryetari, duhet të sigurojë efikasitet më të lartë në arkëtimin e llogarive të arkëtueshme. Hartimi dhe aplikimi i programeve dhe procedurave të qarta për mënyrën e menaxhimit, regjistrimit dhe arkëtimit të tyre, do të ishin disa nga masat që mund të sjellin përmirësime. | Veprimet e ndërmarra:<br><br>Janë dërguar vërejtje e para dhe të fundit të shpërndara për tatimpaguesit me borxhe<br><br>Gjatë vitit 2022, janë dërguar 153 letër kujtesa, ndërsa prej tyre, 137 vërejtje.<br>Komuna ka arritur të nënshkruaj 57 kontrata/marrëveshje me | Sa i përket tatimit në pronë pjesërisht është zbatuar, në të arkëtueshmet e tjera nuk është zbatuar. | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | financiar në tabelën përkatëse sipas llojit të hyrave.<br>Rritja e të arkëtueshmeve ndaj komunës, në fund të vitit 2021 ishte 535,399€ ose 12% më tepër se në vitin 2020.<br>Sfida kryesore mbetet në inkasimin e tatimit në pronë, e cila është rritur për 7% ne vitin 2021, në krahasim me vitin 2020 dhe të hyrat në inkasimin e mbeturinave, borxhet e të cilave janë rritur prej 31 % në vitin 2021, krahasuar me vitin paraprak[8].<br>Ndonëse niveli i arkëtimit ishte edhe si rezultat i ndikimit të pandemisë.<br>Përkundër rekomandimit nga vitit i kaluar, komuna nuk ka ndërmarrë veprime konkrete apo të krijoj mekanizma përkatës për arkëtimin e llogarive të arkëtueshme. | | tatimpaguesit për pagesa me këste të borxheve. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | |
| 21 | **Çështja B9 - Mos kompletimi i NjAB** | Neni 5.1.1 i Rregullores 01/2019 për themelimin e Njësisë së Auditimit të Brendshëm përcakton që çdo subjekt i sektorit publik me buxhet mbi shtatë (7) milion euro duhet të ketë së paku tre auditorë.<br>Komuna ka të themeluar NJAB i cili përbëhet nga 2 auditorë, drejtori i auditimit dhe auditori, përderisa sipas ligjit të buxhetit duhet të ketë së paku 3 auditorë.<br>Për shkak të pengesave me sistemin e ri për rekrutimin e personelit për vitin 2021 komuna nuk ka mund ta rekrutojë pozitën Auditor i Brendshëm,<br>Për vitin 2022 kjo pozitë është planifikuar me buxhetin dhe me plan të personelit, mirëpo deri sa ishim në auditim, nuk është zhvilluar ndonjë procedurë e rekrutimit. | Kryetari duhet të sigurojë që sa më parë të zhvilloj procedurat për auditor, për plotësimin me staf të mjaftueshëm, bazuar në rregulloren për themelimin e Njësisë për Auditmin e Brendshëm. | Veprimet e ndermarra:<br>Në 2022 janë të buxhetuara 3 pozita për NJAB, mirëpo nuk është kryer punësimi.<br>Salla e intervistimeve nuk është e gatshme ende për rekrutime. | E pa zbatuar | |

Hartimi i **Planit të Veprimit për Zbatimin e Rekomandimeve** (PVZR) është përgatitur konform afatit të parapare sipas Zyrës Kombëtare të Auditimit. Ky PVZR është trajtuar në mbledhjen e Këshillit të Drejtorëve me datë _22.09.2022 dhe pastaj është dërguar në Zyrën Kombëtare të Auditimit.

– Me datën _01/07/22, Raporti i Auditimit për Komunën e Vushtrrisë për vitin financiar të përfunduar më 31 dhjetor 2021, i publikuar nga Zyra Kombëtare e Auditimit, është prezentuar në seancën e korrikut 2022 të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë.

- Po ashtu edhe Plani i Veprimit për Zbatimin e Rekomandimeve të dhëna në Raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit është prezentuar në seancën e 02 Shtatorit 2022, pika 7 e rendit të ditës të seancës të rregullt të Kuvendit të Komunës.
- Deri në fund të muajit shkurt 2023, do të diskutoj në Asamblenë Komunale për progresin lidhur me zbatimin e Planit të Veprimit për rekomandimet e auditimit, para se PVF-të të vitit 2022 të jenë dorëzuar në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve.

Përditësimi i të dhënave në Raportin Periodik për zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga Zyra Kombëtare e Auditimit është kryer nga z. Abit Abiti, Kryesues i Grupit Punues për zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Vushtrri,

Ferit Idrizi, Kryetar i komunës

Datë 27.09.2022

**_Zyra e Kryetarit të Komunës_**
*Tel.+383 (0) 38 42 402; Mob.+383 (0) 44 509 633; e-mail: ferit.idrizi@rks-gov.net*
*Adresa: Ndërtesa e Komunës së Vushtrrisë, P.n. 42000, Komuna e Vushtrrisë, Republika e Kosovës*

REPUBLIKA E KOSOVËS | KOMUNA VUSHTRRI

## Drejtoria e Shëndetësisë dhe Përkujdesjes Sociale

| | |
|---|---|
| DATË/A: | 03.02.2023 |
| PËR/ZA/TO: | KK VUSHTRRI |
| CC: | |
| NGA/OD/FROM: | Drejtori i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Përkujdesjes Sociale<br>Dr. Nexhmedin Rashica |
| TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT: | Informatë për shërbimet shëndetësore për vitin 2022 në Komunën e Vushtrrisë |

Drejtoria e Shëndetësisë dhe Përkujdesjes Sociale dhe menaxhmenti i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare, bazuar në Strategjinë Sektoriale të KPSH në Vushtrri dhe në zbatueshmëri me planin e veprimit janë të përkushtuar maksimalisht që të ofrojnë shërbime shëndetësore cilësore, ku përfshihen ato promovuese, parandaluese, diagonstikuese, trajtuese dhe paliative, duke përfshirë në procesin e përkujdesjes shëndetësore të gjitha komunitetet që jetojnë në komunën e Vushtrrisë.

Përkujdesja shëndetësore organizohet duke u bazuar në nevojat dhe kërkesat e popullatës, me synim përimirësimin e vazhdueshëm të ofrimit të shërbimeve shëndetësore.

Organizimi i KPSH bazohet në Ligjin për Shëndetësi, aktet nën ligjore të Ministrisë së Shëndetësisë, Statutin e Komunës dhe Statutin e QKMF-së. Me ligjin për vetqeverisjen lokale përgjegjësia për organizimin dhe kompetencat në KPSH i takojnë nivelit lokal të qeverisjes.

QKMF-ja është përgjegjëse për organizimin, implementimin e konceptit të Mjekësisë Familjare si dhe sigurimin e vazhdimësisë të përkujdesjes shëndetësore për popullatën me objektivë kryesorë, përmirësimin e shëndetit të popullatës, duke ju ofruar shërbime të qasëshme, gjithëpërfshirëse si dhe shërbime të cilësisë së lartë.

**QKMF është e organizuar në dy departamente si :**

Departamentin e Mjekësisë Familjare;
Departamentin e Administratës dhe Personelit;
Barnatorja Qendrore;

**Në kuadër të QKMF-së funksionojn edhe njësitë funksionale të ndara në sektore:**

Sektori i Mjekësisë Familjare

Sektori i Shëndetit publik

Njësia e SISH

Njësia e Vaksinimit dhe Imunizimit

Sektori i Shëndetit Oral Preventiv,

Sektori i Urgjencës

Sektori i Diagnostikës.

Në vazhdim do të paraqiten në mënyrë tabelare të gjitha shërbimet shëndetësore të ofruara në secilin sektor veç e veç.

*Tab.1 Vizitat mjekësore dhe shërbimet shëndetësore të ofruara në QKMF, QMF dhe AMF:*

| Nr. | Emri i shërbimit | Totali | M | F | Shërbim | Referime | Malinje | Kronike | Të vizituar me kartele |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | QKMF | 70604 | 33700 | 36904 | 216918 | 9391 | 39 | 3896 | 470 |
| 2 | Urgjenca | 32356 | 14834 | 17522 | 177833 | 4130 | 120 | 5729 | 0 |
| 3 | Laboratori | 15333 | 6054 | 9279 | 150531 | 0 | | 0 | 0 |
| 4 | Stomatologjia | 9442 | 4267 | 5175 | 49805 | 265 | 0 | 0 | 1149 |
| 5 | RTG | 5525 | 2555 | 2970 | 14993 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 6 | RTG e dhëmbit | 31 | 14 | 17 | 45 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 7 | Vaksinimi | 4622 | 2517 | 2105 | 18404 | 0 | 0 | 0 | 4622 |
| 8 | QMF-1 | 57743 | 26875 | 30868 | 162479 | 8350 | 28 | 3432 | 631 |
| 9 | QMF-2 | 5516 | 2456 | 3060 | 40901 | 274 | 3 | 370 | 255 |
| 10 | QMF-3 | 7253 | 3384 | 3869 | 47798 | 25 | 0 | 637 | 84 |
| 11 | QMF-AMF | 20834 | 8973 | 11776 | 183110 | 9546 | 45 | 2483 | 3108 |
| 12 | V.SHTEPIAKE | 5575 | 2682 | 2893 | 51230 | 14 | | | 4598 |
| 13 | Këshillimore AQH | 1391 | 642 | 749 | 10310 | 0 | 0 | 1301 | 405 |
| | Gjithsej | 236 225 | 108 953 | 127 272 | 1 124 357 | 31 997 | 2235 | 17 848 | 15 322 |

**Në tabelë është paraqitur periudha kohore Janar-Dhjetor 2022, numri i pacientëve dhe shërbimeve shëndetësore të ofruara në QMF dhe AMF në viset rurale**

*Tab. 2 Rrjetet e QMF dhe AMF, vizitat dhe shërbimet mjekësore gjatë 12 muajve të vitit 2022*

| | Janar -Dhjetor 2022 | Totali | M | F | Shërbime tjera | Referimet | S.Malinje | S.Kronike | Vizita me kartele |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| QMF dhe AMF | *QMF Lumadh* | 6556 | 2840 | 3716 | 26745 | 571 | 2 | 662 | 755 |
| | *QMF Smrekonice* | 2479 | 1110 | 1369 | 12420 | 1240 | 1 | 258 | 220 |
| | *QMF Pantine* | 2679 | 1121 | 1558 | 9503 | 795 | 38 | 388 | 1070 |
| | *QMF Druar* | 1401 | 620 | 781 | 3405 | 584 | 0 | 28 | 12 |
| | *QMF Novolan* | 649 | 269 | 380 | 4541 | 193 | 4 | 136 | 426 |
| | *QMF Maxhunaj* | 3149 | 1247 | 1902 | 11427 | 796 | 0 | 380 | 0 |
| | *QMF Dumnice* | 539 | 182 | 357 | 3192 | 190 | 0 | 62 | 387 |
| | *AMF Samadrexhe* | 947 | 419 | 528 | 5924 | 288 | 0 | 339 | 469 |
| | *AMF Strovc* | 736 | 295 | 441 | 2241 | 183 | 0 | 136 | 4 |
| | *AMF Pasome* | 630 | 277 | 353 | 3135 | 7 | 0 | 18 | 185 |
| | *AMF Oshlan* | 178 | 90 | 88 | 1898 | 55 | 0 | 23 | 107 |
| | *AMF Beçiq* | 355 | 206 | 149 | 1369 | 73 | 0 | 8 | 0 |
| | *Amf Dubovc* | 243 | 175 | 68 | 925 | 28 | 0 | 7 | 0 |
| | *AMF Ceceli* | 293 | 122 | 171 | 2491 | 29 | 0 | 38 | 0 |
| | *Gjithsej:* | **20834** | **8973** | **11861** | **89216** | **5032** | **45** | **2483** | **3635** |

***Sektori i Shëndetit Publik***

***Është përgjegjës për imunizim dhe vaksinim dhe për Sistemin Informativ Shëndetësor, ky sektor përcjell gjendjen epidemiologjike në bazë të raporteve kthyese nga IRSHP dhe bashkë me ta vepron në rast se kërkohet apo dyshohet në ndonjë epidemi. Gjithashtu për çdo vit organizon vizita sistematike të nxënësve së bashku me ekipet e mjekësisë familjare dhe të gjeturat dhe rekomandimet i raporton në QKMF dhe DSHPS.***

- ***Sëmundjet ngjitëse sipas IKSHPK Mitrovicë***

1. **Numri i rasteve te sëmundjeve ngjitëse sipas komunës së Vushtrrisë, tab.2**

| Sëmundjet ngjitëse | Totali | Sëmundjet ngjitëse | Totali |
|---|---|---|---|
| Pneumoni | 28 | Hepatit acut viral A | 0 |
| SARI | 1 | Hepatit acut viral B | 2 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| Diarea akute | 685 | Hepatit chronica | 1 |
| Variçella | 57 | Dushim ne Parotit epidemik | 1 |
| Dyshim ne Influecen ILI | 173 | Rastet e reja TBC | 29 |
| Intoxicatio alimentaris | 0 | Erizipella | 0 |
| Meningitis acuta | 2 | Uroplasma ureliticum | 1 |
| Meningitis serosa | 0 | Condilloma anogenitalis | 1 |
| Meningitis purolenta | 0 | Gonorrhoea | 0 |
| Meningoencephalitis acuta | 2 | Brucellozis | 1 |
| Meningoencephalitis purolenta | 2 | Herpes zooster | 3 |
| TBC-Meningoencephalitis | 0 | Ictus ixodes | 1 |
| COVID-19 | 3064 | Vullnus morsum viperi | 0 |

- **COVID-19**

***Bazuar në raportin e IRSHP*** *në Mitrovicë, komuna e Vushtrrisë ka pasur të infektuar / raportuara 3064 raste të infektuara me visursin Covid -19, kurse prej tyre zyrtarisht janë të konfirmuara 4 raste të vdekjes.*

*Në vitin 2022 janë vaksinuar me dozë të parë 840 pacient, me dozë të dytë 1253 pacient dhe me dozë të tretë janë vaksinuar 3300 pacient, dozë të katër 20 pacient, në total janë dhënë 5413 vaksina kundër virusit COVID-19.*

*Në total duke u bazuar në vitin 2021 dhe 2022 janë të vaksinuar me dozë të parë 36431 qytetar, me dozë të dytë janë vaksinuar 33405 qytetar, dozë të tretë 3300 qytetar dhe doza e katër 20 qytetar, në total janë dhënë 73156 doza të vaksina kundër Covid-19.*

- ***Sektori i Vaksnimit dhe imunizimit :***
- ***Vaksnimi i rregullt tek fëmijët dhe të moshuarit:***
- Shërbimi i vaksinimit gjatë kësaj periudhe ka qenë i furnizuar me vaksina mjaftueshëm dhe është kryer në bazë të planit në qytet si dhe në fshatra.
- Në dymbdhjetë mujor janë vaksinuar 4622 fëmijë me vaksina të regullta, dhe janë dhënë 14819 shërbime.
- Nxënësit e klasëve të para , kanë qenë të planifikuar 988 nxenes.
- Janë vaksinuar - 906 nxënës
- Të pa vaksinar - 82 nxënës

- Në nxënësit e klasëve të- VI- kanë qenë të planifikuar 950 nxënës.
- Janë vaksinuar – 901 nxenes.
- Të pa vaksinar - 49 nxënës
-
- MATURANTAT- Të planifikuar janë 765 nxënës.
- Të vaksinuar 612 maturanta.
- 153 kanë refuzuar vaksinimin
- *Po ashtu si çdo vit për shkak të mbrojtjes së popullatës me rrezikshmëri më të lart shëndetësore janë dhënë 2577 doza të vaksinave të gripit sezonal.*
- ***Vaksinimi në Vushtrri është ndër më të mirët në Kosovë dhe arrin përqindje prej 95.0 %, në realizim të planit, e që është një bazë e mirë për preventivën e sëmundjeve që më herët kanë qenë të pranishme në Kosovë e rajon.***

- ***Në vitin 2022 kemi kryer vizitat sistematike për nxënësë nëpër shkolla:***
- ***Pasqyra e përfshirjes së nxënësve në vizita sistematike:***

| Pasqyra e përfshirjes së nxënësve në vizita sistematike | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | Nxënës të planifikuar | | Munguar | | Vizita të realizuara | |
| SHFMU | Nr.nxënësve | % | Nr.nxënësve | % | Nr.nxënësve | % |
| **Klasa I** | 861 | 100 | 52 | 6% | 809 | 94% |
| **Klasa V** | 727 | 100 | 28 | 4% | 699 | 96% |
| **Klasa IX** | 981 | 100 | 33 | 3% | 948 | 97% |
| Gjithësej | 2569 | 100 | 113 | 4 | 2456 | 96% |

**Të gjeturat sipas kritereve të caktuara në përqindje:**

| Përshkrimi | Me veçori patologjike | Pa veçori patologjike | Mungojn | Referimet |
|---|---|---|---|---|
| Koka dhe qafa | 3% | 97% | | |
| Kafazi i krahrorit | 3% | 97% | | |
| Boshti kurrizor | 7% | 93% | | |
| Qëndrimi I trupit | 2% | 98% | | |
| Mushkëritë | 1% | 99% | | |
| Zemra | 1% | 99% | | |
| Ekstemitett | 3% | 97% | | |
| Të pamurit | 29% | 71% | | |
| Mbajn syza | 5% | 95% | | |
| Të dëgjuarit | 2% | 98% | | |
| Lëkura dhe mukoza | 4% | 96% | | |
| Statusi psikik | 1.4% | 98.% | | |
| Referimet e mjekut familjar | | | | 23% |
| Higjiena orale | 36.5% | 63% | 0.5% | |
| Karriesu u dhëmbëve | 44% | 55% | 1% | |
| Referimet e stomatologut | | | | 23% |

*Njësia e SISH-it,*

***QKMF në Vushtrri është duke funksionuar me sistemin e ri i cili është me versionin e fundit. Ministria e Shëndetësisë ka bërë shtrirjen e rrjetit për të gjitha QMF dhe AMF, po ashtu ka pajisur KPSH me pajisje komjuterike dhe pajsije tjera të TI, është duke u punuar në vazhdimësi për implementimin e të gjitha qendrave dhe shpresojmi që gjatë vitit 2023 të funksionalizohet SISH-I në të gjitha instuticionet e KPSH. Gjatë këtij viti në SISH është punuar me vizita sistematike ku janë deponuar në databazë 2456 fletëza dhe është përgatit raporti për klasat e I, V dhe IX.***

***Gjatë vitit 2022 është raportuar për morbiditetin, sëmundjet malinje dhe kronike, vizitat mjekësor edhe për vaksinim COVID-19.***

Sektori i Shëndetit Oral Preventiv

*Në sektorin e shëndetit oral preventiv janë vizituar gjithsejtë 9442 pacient dhe ka dhënë 49805 shërbime. Këtu përfshihet këshilla mjekësore, nxjerrja e dhëmbëve, shërimi, bllombimi dhe pastrimi i gurëzve në dhëmbë. Punohet nga ora 07$^h$ deri në ora 20$^h$ në QKMF dhe në QMF1, ndërsa dy herë në javë në QMF2 dhe QMF3 nga ora 07$^h$ deri ne ora 14 $^h$, QMF Lumadh dhe QMF Pantinë. Kujdestaria mbahet në QMF-1 në ditën e shtunë nga ora 07$^h$ deri ne ora 19$^h$.*

**Shërbimet në sektorin e shëndetit oral preventive:**

**Shërbimet për nxjerrjen e dhëmbit**: Caktimi i diagnozës, dhënia e anestezionit, eks. Dhëmbit, tamponade e alveolës, këshilla për pacientin.

**Shërmbimet për vizita:** caktimi i diagnozës, aplikim local me udhëzim për rtg dhe terapia e përgjithshme.

**Shërbimet për shërimin e karriesit:** caktimi i diagnozës, dhënia e anestezionit, preparimi i kavitetit, vendosja e shtresës ( me ose pa kalcimol), vendosja e bllombës dhe polirimi dhe korigjimi I pikave kontaktuese.

**Shërbimet te pulpitet e dhëmbëve:** caktimi i diagnozës, dhënia e anestezionit, preparimi i kavitetit deri në hyrje të kanaleve, eksterpimi i pulpës, mbushja e kanalit dhe vendosja e bllombës.

**Shërmbimet te gjakëderdhja pas nxerrjes së dhëmbit**: caktimi i diagnozës, dhënia e anestezionit, kiretazha e alveolës, vendosja e hemostatikut dhe tamponade e alveolës.

**Trajntimi I gingiviteve**: largimi I pigmenteve të buta dhe të forta me kavitron dhe past me brush.

***Bazuar në statistikat sipas regjistrit të popullësise të vitit 2011 në ASK komuna e Vushtrrise ka gjithësej 69870 banor, KPSH në Vushtrri ka gjithësejt 9 stomatolog, sipas U/A 6000 banor për një stomatolog, andaj nevoja është për rritjen e numrit të stomatologëve, duke ja shtuar dhe hapjen e shërbimit stomatologjikë ne Pantinë dhe Lumadh.***

*Shërbimi i Urgjencës*

***- Gjatë vitit 2022 ka pas gjithsejtë 32356 pacient janë dhanë 177833 shërbime shëndetësore. Në Urgjencë shërbimet janë 24h dhe punohet cdo ditë të javës. Në këtë shërbim janë të angazhuar katër ekipe që punojnë me ndërrime 12 orësh, janë të angazhuar 5 mjek dhe 17 infermier, këtu kryhen vizita mjekësore dhe shumë shërbime tjera që dalin nga këto vizita. Urgjenca transporton pacientet nga vendi i ngjarjes deri në Emergjencën e Spitalit Sheikh Zayed në Vushtrri e nëse kërkohet ndihmë nga Emergjenca e spitalit, transportoen pacientët sipas nevojë në SHSKUK Prishtinë. Në disa raste ofrojn vizita dhe shërbime shëndetësore edhe në shtëpi, kur gjendja e pacientit është e rënd, po ashtu në kuadër te departamentit të mjekësisë familjare kemi angazhuar ekipin e urgjencës me ndihmë të ekipeve të mjekësisë familajre të cilët kanë dhënë edhe shërbime mjekësore në shtëpi tek pacientët të infektuar nga virusi Covid-19.***

***Rastet e konfirmuara të vdekjes sipas tabelës gjithësej, meshkuj, femra dhe mosha mesatare e vdekjeve:***

| Muaji | Gjithësej | Meshkuj | Mosha mesatare meshkuj | Femra | Musha mesatare femra | Mosha mesaare e vdekjeve ne total |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Janar** | 26 | 11 | 67.36 | 15 | 75.66 | 71.51 |
| **Shkurt** | 15 | 8 | 73.62 | 7 | 75.28 | 74.45 |
| **Mars** | 16 | 13 | 78.61 | 3 | 81 | 79.8 |
| **Prill** | 14 | 5 | 79.8 | 9 | 80.66 | 80.23 |
| **Maj** | 15 | 9 | 68.5 | 6 | 84.83 | 76.66 |
| **Qershor** | 12 | 6 | 65.6 | 6 | 70 | 67.8 |
| **Korrik** | 13 | 8 | 76.5 | 5 | 81.2 | 78.85 |
| **Gusht** | 10 | 6 | 74.6 | 4 | 78 | 76.3 |
| **Shtator** | 18 | 7 | 75.3 | 11 | 69.6 | 72.4 |
| **Tetor** | 15 | 11 | 71.54 | 4 | 78.5 | 75.2 |
| **Nëntor** | 19 | 14 | 70.92 | 5 | 75.4 | 73.16 |
| **Dhjetor** | 14 | 6 | 76.16 | 8 | 78.75 | 77.45 |
| **Totali** | **187** | **104** | **73.2** | **83** | **77.4** | **75.3** |

***Sa i përket kohës së konfirmimit të vdekjeve, ju paraqesim në formë tabelare krahasimet:***

| Vitet | Mosha mesatare e vdekjeve |
|---|---|
| **2019** | **72.14** |
| **2020** | **75.04** |
| **2021** | **73.49** |
| **2022** | **75.3** |

## Sektori diagnostikues

Laboratori se bashku me Rëntgenin bëjnë pjesë në sektorin e diagnostikës.

Gjatë periudhës Janar-Dhjetor të vitit 2022 në Laborator ka pas gjithsejtë ***15333*** pacient dhe janë dhënë ***150531*** shërbime te ndryshme, është hapur laboratori në Lumadh në bashkëfinancim me AQH të cilët kanë dhënë donacion me pajisje mjekësore për laborator por për shkak gjendjes e cila u përkeqësua nga virusi dhe në mugnesë të stafit laboratorit, përkohësisht nuk është funksional.

Laboratori ka kemi pasur vonesa në furnizuar mirë me reagensë, për të cilat kemi raportuar në DSHPS dhe Drejtorinë e Prokurimit.

Po ashtu gjatë kësaj periudhe me buxhet të komunës jemi furnizuar me material per kryerjen e analizave: IGG dhe IGM, D-Dimer dhe teste rapide dhe në vazhdimësi ka filluar nga Ministria e Shëndetësisë furnizimi me teste rapide të shpejta.

Rëntgeni nga Janari deri në Dhjetor ka pas gjithsejtë ***5525*** pacient dhe janë dhënë ***14993*** shërbime, vlen të ceket se të gjithë ata që kanë kërkuar shërbim ne Radiologji edhe e kanë marrë atë shërbim, material për punë kanë pas mjaftueshëm filma të Rëntgenit si dhe CD.

Punon nga ora 07 $^{h}$ deri 13$^{h}$ çdo ditë pune.

Në Rëntgenin e dhëmbit gjithsejtë ka pas 31 pacient dhe janë dhënë 45 shërbime.

## Barnatorja Qendrore

**Ka për detyrë të bënë planifikimin, organizimin, ruajtjen e zingjirit të frohtë dhe liferimin e produkteve medicinale nëpër QMF dhe AMF.**

Furnizim me material shpenzues medicinal, barëra, insulina nga lista esenciale e MSH për periudhën kohore janar – dhjetor 2022 është realizuar **291,218.87 €uro.**

Per shkak te mungesave gjatë furnizimit me barna dhe material shpenzues nga Ministria e Shendetësisë, QKMF ka qenë e detyruar të bëjë blerjet e tyre nga buxheti i komunës së Vushtrrisë të ndarë për blerjet e produkteve medicinale dhe material shpenzues, permes korniz konrates me furnizuesin “MEDPLUS ShPK”:

| Nr. | Vlera e blerjesë € |
|---|---|
| 1 | 23,498.60 |
| **Gjithsej** | **23,498.60** |

***Në tabelën e mëposhtme keni të bashkangjitur përqindjen e furnizimeve nga M.Sh. me barna dhe material shpenzues për periudhën kohore janar – dhjetor 2022, nga lista esenciale:***

| Nr. | Muaji | Barnat | Material shpenzues |
|---|---|---|---|
| 1 | Janar | 55.81% | 86.36% |
| 2 | Shkurt | 54.65% | 72.72% |
| 3 | Mars | 56.32% | 73.91% |
| 4 | Prill | 53.48% | 78.26% |
| 5 | Maj | 39.08% | 72.72% |
| 6 | Qershor | 27.90% | 86.36% |
| 7 | Korrik | 33.33% | 83.33% |
| 8 | Gusht | 30.15% | 83.33% |
| 9 | Shtator | 39.68% | 83.33% |
| 10 | Tetor | 36.50% | 88.88% |
| 11 | Nentor | 33.33% | 88.88% |
| 12 | Dhjetor | 31.74% | 84.21% |
| | **Mesatarja vjetore** | **41.00%** | **81.86%** |

Depoja Qendrore Farmaceutike gjatë vitit 2022 ka bërë shperndarjen e barnave dhe materialit shpenzues në gjithsej 18 QMF dhe AMF të komunës së Vushtrrisë, ne interval te caktuara kohore, QMF dhe AMF për çdo muaj, ndërsa QKMF dhe QMF-1 në intervale 2 javore.

***Raporti i bombolave të oksigjenit medicinal Janar – dhjetor 2022***

| Nr. | Pershkrimi | Dhënia | Sasia | Totali |
|---|---|---|---|---|
| **1** | Bombola oksigjeni medicinal 8.5 kg | Pacient | 84 | 84 |
| **2** | Bombola oksigjeni medicinal 8.5 kg | Insitucionet/QKMF/QMF/AMF | 43 | 43 |
| **3** | Dhenia e aparatit koncentrator | Pacientë | 2 | 2 |
| Totali | | | 129 | 129 |

*ZHVP- Zhvillimi i Vazhdueshëm Profesional*

*Bazuar në raportin e ZHVP-së lidhur me aktivitetet e ndërmaruara ka bërë bashkëpunim me QZHMF në Prishtinë dhe QTMF në Mitrovicë duke realizuar planprogramin gjatë vitit 2022,*

*Koordinatori i Cilësisë së bashku me Kryeinfermieren e QKMF dhe trajneret e Mjekësisë familjare ka bërë një Audit klinik dhe një Rishqyrtim kolegjial, po ashtu në pjesën e dytë të vitit 2022.*

***ZHVP- Zhvillimi i Vazhdueshëm Profesional për mjekët dhe infermier, është komponent me rëndësi të veçantë për institucionin e QKMF-së. Në QKMF mbahen takime të rregullta me mjek dhe infermier të cilat organizohen përmes përgjegjëses për ZHVP. Gjatë vitit mbahen takime profesionale për profesionistet mjekësor për çdo muaj, 10 ligjërata , këto ligjërata nuk mbahen vetëm në muajin korrik dhe gusht. Zakonisht janë mbajt ligjërata me tema qe kanë qenë të përzgjedhura nga këshilli profesional i QKMF-së dhe nga ky vit janë të certifikuara nga OMK.***

***ZHVP për infermier gjithashtu mbanë ligjërata të përmuajshme për infermier dhe ligjërata në komunitet me theks të veçantë në edukim dhe promovim shëndetësor. Ligjëratat në komunitet mbahen zakonisht ne viset rurale në objektet e qendrave shëndetësore apo në shkolla fillore, ligjërata mbahen edhe për adoleshentët në shkollat e mesme . Gjithashtu ZHVP se bashku me koordinatorin e cilësisë dhe qendrën trajnuese për infermier (QEV) i shënon ditët e caktuara botërore për sëmundje të ndryshme, me aktivitete jashtë institucionit dhe në bashkëpunim me punëtore tjerë shëndetësor në QKMF.***

**Tabela 3. Aktivitet e organizuara nga ZHVP-infermieri në QKMF**

| Nr | Tema | Ligjëruesi-ja | Nr.Pjesmarresve | Data |
|---|---|---|---|---|
| 1. | Rreziqet shendetsore qe I sjelle mungesa e Vitamined D | Sala Kovaçi | 23<br>20 | 11.02.2022<br>18.02.2022 |
| 2. | Etika dhe vlerat ne infermieri | Blerona Mehana Haradinaj | 21<br>24 | 09.03.2022<br>25.03.2022 |
| 3. | Hormonet e gjendrres Tiroide | Fatjona Gerxhaliu | 26<br>14<br>13 | 13.04.2022<br>20.04.2022<br>27.04.2022 |
| 4. | Java e imunizimit | Gjevrije Kuqi | 16 | 11.05.2022 |
| 5. | Radioterapia | Sami ramiqi | 24 | 08.06.2022<br>15.06.2022 |

**Tabela 4.Aktivitetet e ZHVP-infermieri në komunitet**

Bazuar në kërkesën e Drejtorit të DSHPS në Komunën e Vushtrrisë, dhe me autorizimin e Drejtori të QKMF-së ''Dr.Safet Idrizi'' Vushtrri është formuar ekipi mjekësor nga QKMF për kontrolla sistematike për higjienën në shkollë fillore Lumadh.

Me dt.07.03.2022 me autorizimin e drejtorit të QKMF, ekipi i larpërmendur ka kryer kontrollat sistematike në shkollën fillore në Lumadh.

**Vizita** : vizitat janë kryer nga specialistet e mjekësisë familjare dhe infermier të QKMF, ku për qëllim ka pasur vizitat për skabies dhe pedikulozë.

Në formë tabelare ju paraqesim numrin e përgjithshëm të vizituarve, sipas grupmoshave.

| Nr | Tema | Nxenese | Kl | Nr I nxeneseve |
|---|---|---|---|---|
| 1. | Vizita per skabies dhe pedikulozë grup mosha 1-5 vjeç | 6 | Parashkollor | 6 |
| 2. | Vizita per skabies dhe pedikulozë, grupmosha 6-9 vjeç | 5+13+12+10+2 | KL I, KL II, KL III, KL IV. | 42 |
| 3 | Vizita per skabies dhe pedikulozë, grupmosha 10-14 vjeç | 7+14+10+13+20+15+9 | KL IV, KL V, KL VI, KL.VII, KL.VIII, KL.IX | 88 |
| **Totali i nxënësve** | | | | **136** |

**Në formë tabelare ju paraqesim vizitat jashtë objekteve shëndetësore**

| Nr | Tema | Ligjëruesi-ja | Vendi | Muaji |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Palpimi i gjirit | Inf.Fatmire Krasniqi Inf.Adlije ShaqiriKurti dhe Inf.Zana Mulaku | Kalaja e Vushtrris | 15.03.2022 |
| 2 | Dita Botërore e Diabetit | Inf.fatmire Krasniqi Inf.Adlije Shaqiri Kurti Inf..Merita | Shesh,Adem Jashari | 14.11.2022 |
| 3 | Dita botrore e HIV/ | Inf.Zana Mulaku Inf.Adlije Shaqiri-Kurti | Shkola SHU1 dhe ShkollaSHU2 | 01.12.2022 |
| 4 | Shendeti Oral | Inf.Drita Halili Naime Merovci | Shkolla Naim Freasheri | 55 nr.pjesmarres |
| 5 | Parandalimi I TBC | Fllanza Uka Mikushnica | Shkolla Ali Kelmendi | 26 |
| 6 | Dita Botrore e Shendetit | Drita Halili | Shesh | 14 |
| 7 | Obeziteti,rreziku dhe pasojat | Aferdita Uka | Shkolla Adem Voca Pasome | 33 |

*QEV- Qendra e Edukimit të Vazhdueshëm*

***QEV- Qendra e Edukimit të Vazhdueshëm profesional ka një aktivitet të caktuara nga M.SH. dhe QEV në Prishtinë që merret me organizimin e kursit të ngritjes profesionale i cili është tre javor dhe ka tri module dhe secili modul ka nga 5 tema ku trajnohen infermieret për të qenë gjithmonë të përgatitur për sfidat e reja që na presin. Në këtë kurs duhet te përfshihen të gjithë infermierët që punojnë në QKMF.***

***Trajneret në kuadër të QKMF në Vushtrri kanë pregatitur planprogramin për vitin 2022 i cili është akredituar nga Komisioni për Edukim të Vazhdueshëm Infermieror OIK.***

***Gjatë vitit 2022 janë organizuar trajnime në 7 grupe me 6 pjesëmarrës per shkak te gjendjes te pandemise ka qene numri I kufizuar , këto trajnime kanë zgjatur 3 javë për secilin grup, përqindja e arritshmërisë së kandidatëve në total është 89.93 %.***

***Ju paraqeim në formë tabelare, llojin e trajnimit, ligjeruesin dhe numrin e pjesëmarrësve për secilin grup.***

***Tema: Roli I KPSH dhe kujdesi infermierore, Komunikimi,Edukimi Shendetesore-Mjetet e edukimit shendetesore,Etika ne Infermieri,dhe parandalimi i semundjeve***

**Agjenda:** trajnim tre ditor nga ora 10-14h (E martë,e mërkurë,e enjte)

| Nr | Tema : | Ligjruese | Koha | Nr.pjesmarresve |
|---|---|---|---|---|
| 1 | **Moduli I parë**<br>1.Roli I KPSH dhe kujdesi infermieror<br>2.Komunikimi<br>3.Edukimi shëndetësor-mjetet e edukimit shëndetësor<br>4.Etika në infermieri<br>5.Parandalimi i sëmundjeve | Inf.Fatmire Krasniqi<br>Inf,Zana Mulaku | E mart<br>10-14h | 42 |
| 2 | **Moduli I dytë**<br>**1.**Kujdesi antenatal,perinatal dhe postnatal<br>2.Ç,është Pediatria?<br>3.Rritja dhe zhvillimi normal I fëmiut<br>4.Të ushqyerit e foshnjes dhe fëmiut<br>5Adoleshenca dhe puberteti | Inf.Fatmire Krasniqi<br>Inf,Zana Mulaku | 11-14h | 42 |
| 3 | **Moduli I tret** | Inf.Fatmire Krasniqi | 12-14h | |

| | 1.Ndihma e pare dhe kujdesi infermieror<br>2.Frakturat dhe lëndimet<br>3.Menagjimi I dhimbjes<br>4.Helmimet dhe kujdesi infermieror | Inf,Zana Mulaku | | 42 |
|---|---|---|---|---|

**Për të gjithë kandidatët janë të certifikuara nga OIK me nga 30 pikë akredituese.**

**Përveç trajnimeve të larpërmendura trajneret e mjekësisë familjare në koordinim me drejtorinë e QKMF-së kanë vazhduar pa ndëprerë për ngritjen profesionale të infermierëve pasi që kemi qene në periduhën e virusit COVID -19 dhe ju paraqesim trajnim shtesë të planifikuara dhe realizuara gjatë vitit 2022, në kuadër të QKMF-së**

**Këshillimorja për Edukim dhe Motivim Shëndetësor**

**Këshillimorja për Edukim dhe Motivim Shëndetësor, për sëmundje kronike jo infektive me theks Hipertensionin , Diabetin dhe Astma është fryt i bashkëpunimit me donator Zvicran për kujdes të qasshëm dhe cilësor (AQH).**

**Vizita mjekësore si dhe të matjes së tensionit, glikemisë dhe asthms, furnizimi me broshura për edukim dhe preventivë për këto sëmundje, dhënia e librezave për pacient ku përshkruhet edhe terapia që e merr pacienti, regjistrimi i matjeve të tensionit dhe glikemisë për përcjellje te gjendjes shëndetësore. Po ashtu është bërë trajnimi i stafit shëndetësor mjek dhe infermier për edukim shëndetësor motivues, kemi përfituar trajnime të shumta si për stafin menaxherial, profesionistet shëndetësor . Numri i pacientëve nga janar deri në dhjetor 2022 këshillimore për sëmundje kronike, në KPSH si QKMF, QMF-1 QMF-2, QMF-3, QMF dhe AMF 7 fshatra janë këshilluar pacient me sëmundje kronike Diabet, Hipertesion dhe Asthma.**

**Tabela 5. Të dhëna për hipertensionin, diabetin dhe asthmen 2022;**

| Pacienta me Diabet | Pac.me hipertension | Pac.me faktot rreziku | Pac.me Diabet dhe HTA | Pac.Asthme |
|---|---|---|---|---|
| **262** | **50** | **22** | **1052** | **4** |

| Nr.Paceinta Janar -dhjetor | Femra | Meshkuj | Sherbime |
|---|---|---|---|
| **1390** | **739** | **651** | **5958** |

**BASHKËPUNIMI ME ORGANIZATËN JOQEVERITARE UNICEF DHE AMC**

Gjatë vitit 2022 DSHPS dhe QKMF kanë arritur që të vazhdojnë bashkëpunimin e shkëlqyeshëm me donator për realizimin e projekteve me bashkëfinancim.

Në koordinim dhe bashkëpunim të MSH, UNICEF-in dhe AMC-ën vazhdohet të implementohet programi i vizitave shtëpiake për gra shtatëzëna dhe fëmijë deri në moshën 3 vjeçare

Në bashkëpunim me UNICEF-in dhe AMC-në kemi vazhduar projektin për vizitat shtëpiake për nëna dhe fëmijë deri në moshën 3 vjeçare.

- Si rezultat i përmbushjes së planprogramit QKMF është shpërblyer me një veturë për kryerjen e vizitave në teren, me laptop, tensiometer, thermometer, pulsoksimeter, peshore digjitale për shtatzëna, peshore digjitale për fëmijë etj

***Gjatë vitit 2018 e deri ne vitin 2022 në bashkëpunim me UNICEF-in dhe AMC-ën janë trajnuar 8 mjekë, 41 infermierë dhe 1 edukatore për përkujdesjen dhe këshillimin, të cilat kanë dhënë kontribut të veçantë për gratë shtatëzëna dhe për fëmijët për rritjen dhe zhvillimin e fëmijëve deri në moshen 3 vjeçare.***

***Nga përkrahja e vazhdueshme është mundësuar furnizimi me këto mjete për punë:***

1. Furnizimi me uniforma dhe çanta për mbajtjen e terapisë për staf;
1. Furnizimi me peshore digjitale për fëmijë dhe për të rritur
2. Furnizimi me pajisje pulsoksimetër, tensiometër, glukometër
3. Furnizimi me mbushje të telefonisë mobile, dhe
4. Furnizimi me një veturë.

***Shërbimi vizitat shtëpiake për gra shtatzëna, lehona dhe fëmijët deri ne moshën 3 vjeçe***

***Tabela 6.Numri i vizitave shtëpiake në komunën e Vushtrrisë në vitin 2022:***

| Komuna VUSHTRRI | Jan ar | Shk urt | Mar s | Prill | Ma j | Qe rsh or | Ko rri k | Gu sht | Sht ato r | Tet or | Në nto r | Dhj etor | Tota l |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|

| | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Numri i vizitave për fëmijët 0-3 vjeç | 317 | 423 | 457 | 371 | 414 | 261 | 394 | 353 | 421 | 468 | 616 | 329 | **4824** |
| Numri i vizitave për shtatzëna | 60 | 66 | 83 | 49 | 64 | 41 | 80 | 67 | 66 | 68 | 58 | 49 | **751** |
| Numri total i vizitave. | **377** | **489** | **540** | **420** | **478** | **302** | **474** | **420** | **487** | **536** | **674** | **378** | **5575** |

***Ofrimi i shërbimeve mjekësore për vizitat shtëpiake sipas marrëveshjes së Komunës së Vushtrrisë dhe Islamic Relief Worldwide me seli në Prishtinë.***

- Bazuar në marrëveshjen mes Komunës së Vushtrrisë dhe IRW Kosova, unë jam angazhuar si organ mbikqyrës nga muaji maj 2022, andaj sipas marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Islamic Relief Worldwide-Zyra në Kosovë dhe Komuna Vushtrri , në kuadër të realizimit të projektit me dt.26.07.2022 paraqes raportin tetor mujor:

- **Projekti është realizuar sipas Objektivave të shtojcës B të marrëveshjes për ofrimin dhe dhënien e shërbimeve mjekësore si :**

  - Gratë shtatzëna dhe lehonat;
  - Mosha e tretë mbi moshën 65 vjeçare;
  - Personat me aftësi të ndryshme;
  - Personat me sëmundje kronike;
  - Personat me sëmundje malinje;

- Në kuadër të implementimit të projektit vlera e investuar nga donatori është 110,00.00 e ose 53 %, kurse buxheti komunal në participim me kontribut financiar prej 98,746.00 €uro ose 41.18%.
- Projekti sa i përket financave realizohet dhe menaxhohet nga IRW me seli në Kosovë.

- **Për ofrimin e shërbimeve mjekësore janë furnizuar sipas kërkesës:**

2. Furnizimi me barëra dhe material shpenzues mjekësore;
3. Furnizimi me Uniforma dhe çanta për mbajtjen e terapisë për staf;
4. Furnizimi me karburant për vetura, servisimi dhe mirëmbajtja e veturave;
5. Furnizimi me mbushje të telefonisë mobile;

**Në tabelë është paraqitur ofrimi i shërbimeve shëndetësore në kujdesin shtëpiak IRW-Komuna Vushtrri**

| Nr. | Raport 12 mujor 2022 | Numri total i vizitave | Meshkuj | Femra | Numri I vizitave të pacientëve mbi 65 vjeç | Numri i vizitave lehonave | Numri I vizitave të fëmijëve deri 3 vjeç | Totali i Shërbimeve |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Janar 2022 | 1252 | 551 | 701 | 571 | 44 | 234 | 3219 |
| 2 | Shkurt 2022 | 1265 | 568 | 697 | 559 | 62 | 358 | 3851 |
| 3 | Mars 2022 | 1528 | 634 | 894 | 650 | 83 | 457 | 3423 |
| 4 | Prill 2022 | 1267 | 588 | 679 | 536 | 49 | 331 | 3090 |
| 5 | Maj 2022 | 1181 | 611 | 570 | 639 | 29 | 228 | 2953 |
| 6 | Qershor 2022 | 1528 | 876 | 1109 | 865 | 41 | 261 | 3796 |
| 7 | Korrik 2022 | 3846 | 1689 | 2157 | 1195 | 80 | 394 | 8770 |
| 8 | Gusht 2022 | 4085 | 1728 | 2353 | 687 | 22 | 298 | 11442 |
| 9 | Shtator 2022 | 3358 | 1285 | 2073 | 706 | 66 | 414 | 6830 |
| 10 | Tetor 2022 | 2863 | 1086 | 1777 | 724 | 38 | 214 | 10160 |
| 11 | Nëntor 2022 | 2401 | 951 | 1450 | 813 | 20 | 123 | 11191 |
| 12 | Dhjetor 2022 | 2304 | 937 | 1367 | 873 | 37 | 230 | 4458 |
| | **Gjithsejt** | **26878** | **11504** | **15827** | **8818** | **571** | **3542** | **73183** |

**Organizimi i punës:**

Qytetarët e komunës së Vushtrrisë në nevojë për dhënien dhe ofrimin e shërbimeve mjekësore përveç vizitave mjekësore, janë dhënë shërbime të ndryshme si dhe janë aplikuar terapitë e nevojshme nga projekti sipas listës esenciale të Ministrisë së Shëndetësisë.
Nga muaji janar 2022 projekti konkretisht realizohet me përpikëri sipas marrëveshjes ku kemi 6 ekipe mjekësore të përbërë nga 1 mjek dhe 2 infermier. Puna për ofrimin e shërbimeve mjekësore ditore është kryer sipas këtijë plani dy ekipe mjekësore ( 2 mjek dhe 4 infermier), njëri ekip i cili e organizon punën për dhënien e shërbimeve mjekësore në vise urbane, kurse tjetri në vise rurale, me dy automjete, terapinë dhe materialin e nevojshëm për ofrimin e shërbimeve mjekësore, si këshillimin (pacientët me sëmundje kronike, pacientët me

sëmundje malinje, shtatëzënat dhe lehonat etj.), vizitat mjekësore, marrjen e anamnezës, matjen e tensionit, matjen e glukozës, matjen e saturimit, matjen e pulsit, matjen e temperaturës, përshkrimin e terpaisë sipas nevojës, EKG, dhënien e terapisë paranterale ( intravenoze dhe intramuskulare), kateterizimin, pastrim dhe fashim të plagës deri në shërim, referime tek nivelet tjera të kujdesit shëndetësor sipas nevojës.
Orari i punës është 7/13 orë, që do të thotë se punohet 7 ditë të javës me orar 13 orë duke përfshirë edhe vikendet, festat etj.
Tani nga muaji 19.05.2022, janë angazhuar në projekt në faza të konkursit dhe 2 teknik laborant dhe 1 asistent stomatologu sipas marrëveshjes.

- Për realizimin e projektit momentalisht janë të angazhuar këto resurse humane:

| Pozita profesionale | Numri i nëpunësve |
|---|---|
| Doktor të Mjekësisë | 7 |
| Infermier të Përgjithshëm | 14 |
| Teknik laborant | 2 |
| Asistent stomatologu | 1 |

## Përfundim

Falënderoj të gjithë stafin profesional mjekësor dhe administativ të QKMF-së që kanë dhënë kontribut të vazhdueshëm, përkundër faktit që ishin të rrezikuar nga virusi Covid-19 dhe sëmundjet tjera ngjitëse, e të cilët nuk kanë kursyer vetën në asnjë moment dhe kanë ofruar shërbimet shëndetësore.

Synimi i objektivave për dhënien e shërbimeve cilësore bazohet në planifikimin, organizimin, udhëheqjen dhe kontrollin, e ku me thenks të veçantë i kushtohet rëndësi bashkëpunimit, sepse kur jemi të unifikuar mund të arrijm atë që kemi **objektiv të përgjithshëm.**

**REPUBLIKA E KOSOVËS**
**REPUBLIKA KOSOVA**

**KOMUNA VUSHTRRI**
**OPŠTINA VUČITRN**

| | |
|---|---|
| **DATË:** | **06.02.2023** |
| **PËR:** | **KPF dhe Kuvendin e Komunës** |
| **NGA:** | **Zdravko Zdravković** ________________ **Kryesues i Komitetit për Komunitete** |
| **LËNDA:** | **Raporti vjetor i Komitetit për Komunitete për vitin 2022** |

Të nderuar,

Në shtojcë të këtij akti përcjellës gjeni të bashkëngjitur raportin vjetor të Komitetit për Komunitete për vitin 2022

Me respekt!

## RAPORTI VJETOR I KOMITETIT PËR KOMUNITETE PËR VITIN 2022

## KOMUNA VUSHTRRI

### *1. Gjendja e sigurisë*

Gjendja e përgjithshme e sigurisë gjatë vitit 2022 ka qenë përgjithësisht e mirë dhe stabile.Sipas raportimeve të përfaqësuesve të komuniteteve joshumicë dhe policisë së Kosovës, në territorin e komunës së Vushtrrisë nuk janë regjistruar incidente të mëdha ndëretnike.

### *2. Mbledhjet e komitetit për komunitete*

- Në vitin 2022, komiteti ka mbajtur gjithsej 10 mbledhje ku janë diskutuar për çështjet dhe problemet e komuniteteve në komunën tonë.

Në dy mbledhjet e para është punuar në hartimin dhe miratimin e planit vjetor të punës së komitetit për komunitete, i cili përfshinte këto tema:

-Diskutim për gjendjen ekologjike në territorin e komunës së Vushtrrisë

-Diskutim për gjendjen sociale

-Diskutim lidhur me buxhetin komunal për periudhën e ardhshme

- Diskutim për përfaqësimin e komuniteteve joshumicë në raport të rastësishëm në institucionet komunale.

- Diskutim për përdorimin e gjuhëve zyrtare në institucione si dhe për të drejtat e komuniteteve.

-Diskutim për gjendjen e kthimit të personave të zhvendosur në komunën e Vushtrrisë

- Si dhe të gjitha çështjet tjera që i përkasin te gjitha komuniteteve në komunën e Vushtrrisë.

Takimi për gjendjen  ekologjike në komunën tonë, biseduam për largimin e deponive ilegale, si dhe për një problem të madh që ishte paraqitur nga ish përfaqësuesi i KFOR-it, ku theksoi se një kohë të gjatë ka qene nje deponi e madhe në fshatin Gojbuljë ku mbeturinat e llojeve të ndryshme të materialeve ndërtimore, ku rrezikohet bllokimi i shtratit të lumit Trstena. Në këtë mënyrë lumi mund të dalë nga shtrati dhe rrezikhet fshati dhe rrethina e fshatit Gojbulë, si dhe zona e qytetit të Vushtrrisë.

Në mbledhjen e dhjetorit morri pjesë edhe Kryetari i Komunës, na u tha se në atë vend është planifikuar të  ndërtohet muri mbrojtës për të mbrojtur shtratin e lumit. Andaj apelojmë që inspekcioni të zbatojë masat për të parandaluar grumbullimin e mëtejshëm të mbeturinave .

Diskutuam edhe për gjendjen sociale të popullatës, ku zyrtarja nga Qendra për punë sociale na udhëzoi se si funksionon shërbimi dhe na sqaroi se të gjitha financat që kanë të bëjnë me Qendrën për punë sociale vijnë ekskluzivisht nga ministria kompetente.

Ne si komitet kërkuam nga qendra që, nëse është e mundur, të sigurojë punëtorë që mbajnë shënime për aplikimin për ndihmë sociale dhe t'i dërgojë punëtorët dy herë në vit në qytetet më të vogla të komunës sonë, në mënyrë që të moshuarit që janë të palëvizshëm të mos maltretohen të vijnë vetë në qytet të aplikojnë.

Për këtë kemi marrë përgjigje se është vetëm një zyrtar që e bën këtë punë dhe se nuk mund ta arrijë vetë,për këtë arsye kemi bërë propozim që nëse është e mundur të punësohet edhe një zyrtar tjetër për t'ia mundësuar këtë shërbim qytetarëve.

Gjithashtu ne propozuam që punëtori të jetë nga komuniteti joshumicë nëse është e mundur.

Në takimet në vijim është diskutuar për propozim-buxhetin për periudhën e ardhshme, ku drejtori i departamentit të administratës na sqaroi se debati për planin buxhetor zhvillohet përmes një bashkëbisedimi me vendasit, në varësi të lokalitetit që zgjedh komisioni.

Të gjithë anëtarët e komitetit si dhe të gjithë pjesëtarët e të gjitha komuniteteve patën mundësinë të marrin pjesë në debatin për hartimin e planit buxhetor në lokalitetet e tyre.

Shumica e anëtarëve të komiitetit patën mundësinë të marrin pjesë në debat dhe mund të konkludojmë se plani i investimeve kapitale, i cili kryesisht ka të bëjë me ndërtimin e rrjeteve të reja të ujësjellësit dhe kanalizimeve, si dhe ndërtimin dhe rehabilitimin e rrugëve, është shumë e kënaqshme.

Mund të themi gjithashtu se disa nga këto gjëra janë realizuar, të cilat janë përfshirë në planin e investimeve kapitale, si p.sh. rehabilitimi i rrjetit të kanalizimit në vendbanimin rom në Preluzhë. Shpresojmë që edhe investimet e tjera të përfundojnë në periudhën e ardhshme në një kohë sa më të shkurtër.

Diskutuam edhe temën për mundësinë e punësimit për komunitetet joshumicë në komunën tonë.Diskutuam gjithashtu përdorimin e gjuhëve zyrtare dhe të gjithë ramë dakord që funksionon mirë.

Në takimin e nëntorit diskutuam për gjendjen e kthimit të personave të zhvendosur nga territori i komunës sonë, ku morëm një raport gojor nga zyra për çështje të komuniteteve.

Nga zyra na thanë se janë ndërtuar shtëpi për të kthyerit, por se nuk ka kthim të të zhvendosurve.

Ne si komitet sugjeruam që duhet gjetur të paktën një vend pune për familjet që dëshirojnë të kthehen për të krijuar ekzistencen per jetesë.

Na u tha gjithashtu se jane dhënë disa projekte për hapjen e një biznesi privat të të kthyerve, por ata e kanë shitur dhe nuk kanë filluar biznes fare.

Mendojmë se kjo nuk mjafton për të krijuar kushte për jetë, por duhet të punojmë të gjithë së bashku për të ndihmuar ata njerëz që duan të kthehen të gjejnë punë si në sektorin privat ashtu edhe në atë publik.

Në të njëjtën mënyrë, zbatohen kontrolla më të rrepta kur bëhet fjalë për dhënien e projekteve për biznesin dhe se përfituesi të cilit i jepet t i lidhet kontratë që të mos ndodhë që përsëri te shitet.

Në takimin e fundit të dhjetorit, i pranishëm ishte Kryetari i Komunës së Vushtrrisë, z. Ferit

Idrizi, i cili personalisht u zotua se do t'i përkushtohet problemeve me të cilat ballafaqohen komunitetet joshumicë që ne si komitet ia kemi paraqitur .

***3. Qasja e komuniteteve joshumicë në shërbimet publike***

Komunitetet jo shumicë kishin qasje të mirë në shërbimet publike në të gjitha institucionet komunale.Komiteti për komunitete, drejtoritë komunale me shërbimet e tyre, i kushtuan vëmendje të madhe pjesëtarëve të komuniteteve, atyre që kërkuan të marrin dokumentacion personal, dokumentacion familjar apo pronësor.Gjithashtu biseduam në temën e mundësive të punësimit për komunitetet joshumicë në komunën tonë, nga kryetari morëm një premtim se të gjitha shërbimet do t'i përkushtohen sa më shumë këtij problemi dhe se të gjitha komunitetet joshumicë do të përfaqësohen në institucione proporcionalisht. Ne diskutuam gjithashtu përdorimin e gjuhëve zyrtare dhe të gjithë ramë dakord se funksionon mirë.

***4. Vizitat e Komitetit për Komunitete***

Në vitin 2022, komiteti për komunitete nuk ka pasur vizitë të organizuar tek popullata joshumicë, secili anëtar i komisionit ka vizituar anëtarët e komunitetit të tij dhe në takim ka prezantuar problemet e tyre.

Do të mundohemi të jemi më shumë ne terren në periudhën e ardhshme.

***5. KËRKESAT***

Komiteti për Komunitete gjatë vitit 2022 ka shqyrtuar të gjitha kërkesat dhe ankesat e pjesëtarëve të komuniteteve, të gjitha kërkesat do t'i dërgohen me shkrim drejtorive përkatëse për zbatimin e tyre, disa prej kërkesave janë realizuar deri më tani.

***6. Projektet për zhvillimin e komuniteteve joshumicë në komunën e Vushtrrisë***

Komiteti për Komunitete gjatë vitit 2022 ka përkrahur projekte për investime kapitale, projektet kryesisht janë të bazuara në rindërtimin dhe ndërtimin e rrugëve, si dhe në rrjetet e ujësjellësit dhe kanalizimit. Deri më tani janë realizuar disa projekte dhe presim që gjatë vitit të ardhshëm të realizohen edhe projekte të tjera.

***7. Përfundime***

Gjatë vitit 2022, Komiteti për Komunitete, gjatë takimeve të mbajtura, doli në këto konkluzione:

Është mbajtur një takim me drejtorët e drejtorive komunale ku kemi prezantuar problemet e ekologjisë, situatave sociale, punësimit etj.

Një takim me kryetarin e komunës ku morrëm një premtim për përfshirje më të madhe në zgjidhjen e çështjeve të komunitetit.

Konkluzioni për rritjen e efikasitetit të punës së komitetit për komunitete, rritjen e punës në terren.

***8. Sfidat***

Gjatë vitit 2022, Komiteti për Komunitete ka shqyrtuar dhe zbatuar të gjitha aktivitetet e planifikuara sipas planit për vitin 2022 dhe rregullave të punës së Komisionit për komunitete.

Komiteti për komunitete gjithashtu pranoi raporte nga drejtoritë komunale për çështje të

ndryshme te cilat kanë të  bëjnë me komunitetet joshumicë.

Shqyrtimi i kërkesave dhe ankesave nga Komiteti  për Komunitete zgjidhet brenda afateve ligjore.

Sfida kryesore mbetet realizimi i projekteve të investimeve kapitale, që të realizohen në kohë dhe pa vonesa në realizimin e tyre.

Rritja e efikasitetit të Komitetit për Komunitete, më shumë punë në terren dhe ndihmë në zgjidhjen e problemeve lidhur me çështjet e dakorduara.

**Zdravko Zdravković**

**Kryesues i Komitetit për Komunitete**

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

K r y e t a r i

# Informatë
# lidhur me punën e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi
# për vitin 2022

Shkurt 2023

Këshilli komunal për siguri në bashkësi i themeluar me Udhëzimin Administrativ të MPB-së dhe MAPL-së është organ këshillues për çështjet e sigurisë në bashkësi, me përfaqësim të gjerë të të gjitha komuniteteve. Ky këshill ka për qëllim rritjen e vetëdijesimit të qytetarëve lidhur me sjelljet e dhunshme në komunitet, si dhe ndërtimin e besimit në mes të policisë dhe qytetarëve, nëpërmjet ndërtimit të partneritetit dhe iniciativave të përbashkëta për zgjidhjen e problemeve të sigurisë në bashkësi.

KKSB, në kuadër të kompetencave dhe përgjegjësive të tij, bashkëpunon me Policinë e Kosovës dhe institucionet qendrore, të cilat merren me sigurinë publike, me qëllim të krijimit të një ambienti sa më të sigurt në bashkësi, si dhe ndërtimin e besimit për jetë të qetë e të sigurt të të gjitha komuniteteve në meset ku ata jetojnë.

Në vitin 2022 janë mbajtur gjithsej 6_ mbledhje, sipas Udhëzimit Administrativ. Mbledhjet në këtë këshill janë mbajtur në gjuhët zyrtare në komunë, duke qenë se përbërja e tij është shumë etnike. Mbledhjet e KKSB-së kanë qenë të hapura, ato i kanë përcjell përfaqësues të KFOR-it, OSBE-së, etj. Në këto mbledhje pjesëmarrja e anëtarëve të KKSB-së ka qenë e kënaqshme, dhe secili nga anëtarët e këshillit kanë diskutuar për çështjet dhe problemet për të cilat ka përfaqësuar në këtë këshill, si dhe ka dhënë kontributin në zgjidhjen e problemeve të caktuara. gjithashtu kemi pasur pothuajse çdoherë prezent organizatat ndërkombëtare KFOR-in, OSBE-në, UNMIK etj.

Në këto mbledhje janë shqyrtuar problemet e ndryshme që i preokupojnë qytetarët e Vushtrrisë dhe masat që duhen të merren për parandalimin dhe evitimin e tyre.

Vlen të theksohet se në aspektin e sigurisë - janë shtuar masat e sigurisë në trafik në periudha të caktuara kohore gjatë kohës kurë fëmijët shkonin në shkolle ku duhet ta kalojnë rrugën dhe gjatë sezonit veror kurë ka ekzistuar fluksi i madh i bashkatdhetarëve

Gjithashtu ka bere kontrollimin e armëmbajtjeve, ku si rezultat i këtij kontrolli janë konfiskuar një numër i armëve. Policia është angazhuar në parandalimin e gjuajtjeve me armë zjarri në ahengje të ndryshme, por fatmirësisht numri i tyre është në zvogëlim e sipër, pasi që njerëzit po vetëdijesohen.

Sipas raporteve të policisë numri më i madh i veprave penale është kundër pasurisë, pra vjedhjet dhe vjedhjet e rënda por me angazhimin e shtuar të Policisë, ky numër është dukshëm më i vogël se vitin e kaluar, por në kët vit është rritur numri i veprave penale të narkotikëve si dhe është rritur dhuna në familje.

Anëtarët e KKSB-së nga radhët e komunitetit serb, turk, rom, dhe ashkali, kanë raportuar lidhur me gjendjen e sigurisë brenda komuniteteve të cilat i kanë përfaqësuar, kanë prezentuar problemet dhe kërkesat e tyre para anëtarëve të këshillit, me të cilat është njoftuar këshilli, me ç'rast janë nxjerr rekomandime për zgjidhjen e problemeve.

punës në terren, ku janë njoftuar më për së afërmi për raportet ndëretnike në vendbanimet multi etnike.

Përveç KKSB-së, edhe Këshillat lokale për siguri në bashkësi si KLSP që përfshin fshatrat: Gojbulë dhe fshatrat Karaçë, Begaj, Sllatinë, Banjskë, Tërllabuq dhe Bashkësia lokale "Kalaja" në Vushtrri si dhe KLSP – Prelluzhë, ku përfshihen fshatrat (Gllavatin, Bivolak, Beçuk, Stroc, Zhilivodë, kanë funksionuar në mënyrë të rregullt.
Këto këshilla lokale, kanë mbajtur takime në të cilat janë shqyrtuar çështje me rëndësi dhe interes për komunitetin, si në aspektin e sigurisë ashtu edhe në përmirësimin e marrëdhënieve ndëretnike.

Ferit Idrizi

Kryetar i Komunës

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**
**Komuna e Vushtrrisë**
**Opština Vucitrn – Municipality of Vushtrri**

---

**Për: Kuvendin Komunal**

**Propozues: Kryetari i Komunës, z. Ferit Idrizi**___________

**Hartues: Drejtoria e Arsimit, drejtori z. Dardan Abazi**___________

**Lënda: Propozim – vendim për formimin e Komisionit për përzgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve në Komunën e Vushtrrisë.**

Bazuar në nenin 5 pika (d) të Ligjit për Arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës Nr.03/L-068 , nenit 35 pika 1 dhe 2 të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës Nr.04/L-032. Udhëzimit Administrativ nr.151/2020 për Detyrat, Përgjegjësitë, Procedurat dhe Kriteret e Zgjedhjes së Drejtorit dhe Zëvendësdrejtorit të Institucionit Publik Edukativo Arsimor dhe Aftësues Parauniversitar, dhe Nenit 19 pika 1.4 të Statutit të Komunës. Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më,________miraton këtë :

VENDIM
PËR EMËRIM TË KOMISIONIT PËR PËRZGJEDHJEN E DREJTORËVE DHE ZËVENDËSDREJTORËVE NË KOMUNEN E VUSHTRRISË

1. Me këtë vendim formohet Komisionit për përzgjedhje për vendet e punës: drejtor dhe zëvendësdrejtor, në shkollat fillore, të mesme të ulëta dhe të mesme të larta në Komunën e Vushtrrisë, me këtë përbërje:
    1.1. Hashim Hajrizi, zyrtar ligjor dhe personel i DKA-së
    1.2. Burim Gjaka, drejtor i SHFMU"Mustafë Shyti"Oshlan
    1.3________________, përfaqësues i MASHT-it

2. Komisioni do t'i zhvillojë të gjitha procedurat për përzgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve në Komunën e Vushtrrisë, konform Udhëzimit Administrativ nr.151/2020 për Detyrat, Përgjegjësitë, Procedurat dhe Kriteret e Zgjedhjes së Drejtorit dhe Zëvendësdrejtorit të Institucionit Publik Edukativo Arsimor dhe Aftësues Parauniversitar.

3. Komisioni i cekur si në nenin 1 të këtij vendimi ka mandat për një vit shkollor.

4. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoria Komunale e Arsimit dhe Komisioni i lartcekur.

5.Ky vendim hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Kryesuesja e Kuvendit

_______________
Melihate Basholli Latifi

# Arsyetim

Me qenë se anëtarëve të më parshëm të Komisionit për intervistimin e kandidatëve për drejtor të institucioneve edukativo-arsimore dhe aftësuese i ka skaduar mandati, Drejtoria Komunale e Arsimit kërkon nga Kuvendi Komunal që sa më parë që është e mundur të bëhet emërimi i Komisionit të ri për zgjedhjen e drejtorëve dhe zv.drejtorëve në institucionet edukativo-arsimor dhe aftësues, sipas Udhëzimit Administrativ Nr.151/2020.

Me respekt!

Dardan Abazi
Drejtori i DKA-së

**Republika e Kosovës** **Komuna e Vushtrrisë**

Për: Komitetin për Politik dhe Financa dhe Kuvendin e Komunës
Propozues: Kryetari i Komunës ________________
Hartues: Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit ________________
Çështja për shqyrtim: Propozim-Vendim për lirimin nga pagesa e taksës për shfrytëzimin e hapësirave publike si dhe kioskave nga druri për më pak se një vit

Bazuar në nenin 12, paragrafi 12.2, pika "d" lidhur me nenin 17 shkronja "a" të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 2 paragrafi 2.3 të Ligjit Nr.03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal, Ligjit Nr.05/L-100 për Ndihmën Shtetërore, nenin 19 pika 1.4 të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më ____________ 2023 , merr këtë:

**Vendim për lirimin nga pagesa e taksës për shfrytëzimin e hapësirave publike si dhe kiosqeve nga druri për më pak se një vit**

1. Me këtë vendim lirohen nga pagesa e taksës komunale, shfrytëzimi i hapësirave publike para lokaleve, të cilat ushtrojnë veprimtarinë e gastronomisë për më pak se një vit, si dhe kioskat nga druri që jepen në shfrytëzim më pak se një vit nga data 3.1.2023 deri më 22.12.2023.

2. Qëllimi i këtij vendimi është përkrahja e këtyre veprimtarive , të cilat operojnë në gjendje jo të mirë ekonomike, vlera e përgjithshme e këtyre masave përllogaritet të jetë 10000.00€, për kiosqet nga druri, ndërsa për shfrytëzimin e hapësirave publike para lokaleve të cilat ushtrojnë veprimtarinë e gastronomisë shuma përllogaritet të jetë 4300.00€, për periudhën e cekur si në pikën e parë të këtij vendimi.

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit si dhe Drejtoria për Inspektime.

4. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit në Ministrinë e Pushtetit Lokal si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të komunës së Vushtrrisë.

**Melihate Basholli**

________________

**Kryesuese e Kuvendit**

**A r s y e t i m**

Drejtoria për Urbanizem dhe Mbrojtje të Mjedisit bazuar në kërkesat e paraqitura në mënyrë verbale nga të gjithë pronaret e gastronomive të cilët kanë kërkuar nga ky organ lirimin nga pagesa e taksës komunale, të cilët shfrytzojnë hapsiren publike para lokaleve, me arsyetimin se janë duke ushtruar këtë veprimtari të gastronomisë në gjendje jo të mire ekonomike, si dhe të njeten gjendje kanë paraqitur edhe shfrytzuesit të cilet kanë marr në shfrytzim për me pak se një vit kiosqet nga druri, DUMM pas shqyrtimit të këyre kërkesave të njëpasnjëshme të parashtruara nga palët me arsyetimin e tyre të cilët prezantuan gjendjen e tyre jo të mire ekonomike, konsideron se lirimi nga pagesa do të ishte një ndihme lehtësuese e bërë nga Komuna e Vushtrrisë për këto biznese.

Andaj bazuar në të lartcekura , kërkojm nga ju aprovimin e këtij propozim vendimi si në dispozitiv.

**Drejtore e drejtorisë**

**Fortuna Krasniqi Spahiu**

**Republika e Kosovës** **Komuna e Vushtrrisë**

Për: Kuvendin e Komunës
Propozues: Kryetari i Komunës
Hartues: Zyra e Kryetarit
Tema: Propozim – vendim

Bazuar në nenin 12, paragrafi 2 shkronja "d" të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, nenitn 15 të Udhëzimit Administrativ Nr. 27/2012 MPB – 03/2012 MAPL për Këshillat Komunal për Siguri në Bashkësi, nenin 19, paragrafi 1, pika 1.4 të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më ________2023, merr këtë:

V E N D I M
PËR NDRYSHIM TË VENDIMIT

1.Me këtë vendim ndryshohet vendimi 01 Nr. 24/22 date.31.01.2022 për themelim të Këshillit Komunal për Siguri në Bashklësi, si në vijim:

1.1 Në pikën 1.14 Sedat Durmishi, përfaqësues i Komunitetit Ashkali, shkarkohet nga pozita e anëtarit të KKSB-së.

1.2 Në pikën 1.15 Brendon Shaqiri, përfaqësues i komunitetit rom, shkatkohet nga pozita e anëtarit të KKSB-së.

1.3 Në paragrafin 1, pika 1.3 Miradije Maloku, ish Drejtore e Drejtorisë për Arsim, pushon të jetë anëtare e KKSB-së.

1.4 Në pikën 1.10 Simo Çimburoviç, përfqësues i Kishës Ortodokse serbe, pushon të jetë anëtar i KKSB-së.

2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Zyra e kryetarit dhe Sekretaria e Kuvendit.

3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Melihate Basholli Latifi
Kryesuese e Kuvendit

# A r s y e t i m

Vendimi 01 Nr.24/22 datës 31.01.2022 për themelim të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi ndryshohet në bazë të nenit 15 pika 1.1 të Udhëzimit Administrativ Nr.27/2012 MPB – 03/2012 MAPL Për Këshillat Komunale Për Siguri në Bashkësi. Propozimi për ndryshim të këtij vendimi është dhënë për arsyet si në vijim:

- Sedat Durmishi, përfaqësues i komunitetit ashkali, dhe
- Brendon Shaqiri, përfaqësues i komunitetit rom, nuk kanë marrë pjesë më tepër se 3 mbledhje radhazi në KKSB.
- Miradije Maloku ka dhënë dorëheqje në pozitën e drejtores në DKA
- Simo Çimburoviç, me rastin e vdekjes së tij.

Bazuar në të cekurat më sipër, i propozohet kuvendit të komunës që ta miratoj këtë propozim vendim si në dispozitiv.

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kuvendi i Komunës

**Datë:** **16.02. 2023**

**Për: Kuvendin Komunal**

**Propozues:** për **Kryetari i Komunës, Ferit Idrizi** ____________

**Hartues:** **Drejtoria për Shërbime Publike, Benjamin Shala** ____________

**Për miratim: Propozim –Vendim për caktim të kahjeve të lëvizjes në disa rrugë të qytetit**

---

Në bazë të nenit 82 të Ligjit për procedurën administrative, nenit 79 pika (h) e Statutit të Komunës së Vushtrrisë, nenit 2.7 nën shkronja f të **Ligjit 02 Nr. 02/L-70 për Sigurinë në Komunikacion Rrugor,** Nenit 5.2 të **Ligjit nr. 2003/11 për Rrugët**, Drejtoria për Shërbime Publike, bie këtë propozim:

**V E N D I M**

**1.** Ndalohet qarkullimi i mjeteve me veprim motorik në segmentin e sheshit - rrugës „Hasan Prishtina" nga kryqëzimi me rr. „Isa Boletini" deri në kryqëzimin me rr. „Ruzhdi Hyseni".

**2.** Rruga „Xhevat Jusufi" do të jetë rrugë qorre, me dy sense të lëvizjes në shfrytëzim vetëm të banorëve të kësaj rruge.

**3.** Rruga Isa Boletini përcaktohet rrugë me një sens të lëvizjes nga kryqëzimi me sheshin - rrugën „Hasan Prishtina" në drejtim të rr. „Zenullah Begu".

**4.** Rruga Weslli Klark caktohet rrugë me një sens të lëvizjes në drejtim të rrugës rr. „Ruzhdi Hyseni".

**5.** Segmenti i parë i rr. „Ismail Qemajli" caktohet rrugë me një sens të lëvizjes në drejtim të rrugës „Haxhi Zeka".

**6.** Rruga „Ramadan Fazliu" rezervohet për parkimin e taksive individual.

**7.** Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Drejtoria e Inspektimeve e Komunës së Vushtrrisë.

**8.** Ky vendim hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**Melihate Basholli-Latifi**

____________

**Kryesuese e Kuvendit**

**A r s y e t i m**

Drejtoria për Shërbime Publike, me qëllim të eliminimit të qarkullimit të ngopur në disa rrugë të qytetit dhe me qëllim të rritjes së shkallës së sigurisë për të gjithë pjesëmarrësit në komunikacion pas një analize të hollësishme të rrjedhës aktuale të qarkullimit dhe vështirësive që janë shkaktuar si rezultat i prezencës së numrit të madh të mjeteve motorike dhe parkingjeve të Taksive vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Drejtori i Drejtorisë**

**Benjamin Shala**


Policia
Spitali
Shtepia e Kultures
Xhamia e Madhe
Komuna
Ura e Gurit
Vushtrri